

**Prof.dr.Adnan Jashari**

**ZGJIDHJA GJYQESORE DHE JASHTEGJYQESORE  
E KONTESTEVE**

**(MEDIACIONI DHE ARBITRAZHI)**

*(Ligjeratat te autorizuara)*

## I.NË PËRGJITHËSI MBI KONTESTET

Subjektet e së drejtës gati çdo ditë hynë në marrëdhënie të ndryshme juridiko-civile. Nga këto marrëdhënie, për subjektet e së drejtës, lindin autorizime të caktuara (të drejta subjektive) ose detyrime (obligime) të caktuara. E drejta subjektive është autorizim juridik për sjellje të caktuar të subjektit të së drejtës, me qëllim të mbrojtjes së interesit të tij. Përmbajta e detyrimit juridik përbëhet nga sjellja e caktuar (bërja ose mosbërja), e cila shprehet si urdhër ndaj subjektit të detyrimit, që të sillet në mënyrën e përcaktuar, për arritjen e qëllimit të caktuar.<sup>1</sup> Bartësi i të drejtës subjektive është i autorizuar që të kërkojë nga subjekti i detyrimit juridik përmbushjen e obligimit nga marrëdhënia e caktuar juridike. Në të shumtën e rasteve, bartësi i detyrimit në mënyrë vullnetare dhe spontane e përmbush obligimin e vet, e me këtë njëherit dhe realizon të drejtën subjektive të bartësit të autorizimit. Në raste të këtilla, në mënyrë spontane dhe vullnetare vjen deri tek realizimi i përmbajtjes së marrëdhënies së caktuar juridike e njëkohësisht edhe deri tek jetësimi i rendit juridiko-civil në marrëdhëniet faktike të subjekteve juridike.

Megjithatë, jo çdo herë subjektet e së drejtës sillen në pajtueshmëri me autorizimet dhe detyrimet e tyre. Në raste të caktuara, subjektet e së drejtës sillen në mënyrë të kundërt me atë që është përcaktuar me norma juridike. Kjo sjell deri tek cenimi, kontestimi apo shkelja e të drejtave subjektive, respektivisht vjen deri tek tentimi që bartësi i detyrimit të lirohet nga obligimi. Situatat e tilla bëjnë të pashmangshme nevojën që të sigurohet realizimi i dhunshëm i normave juridike, thelbin e të cilit e përbën e drejta në mbrojtje juridike të të drejtave subjektive të përcaktuara me normat juridike-materiale. E drejta në mbrojtje juridike paraqet autorizim të titullarit të së drejtës të kërkojë nga shteti që me aparatet e tij të dhunës të intervenojë me qëllim të mbrojtjes të së drejtës së tij.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drejta kontestimore", Shkup, 2009, f.1.

<sup>2</sup> Po aty, f.2.

## 1. Mënyrat e zgjidhjes së kontesteve

Mënyrat e zgjidhjes së kontesteve, e veçanërisht të kontesteve tregtare, janë të shumta dhe të llojllojshme. Vetë natyra e marrëdhënieve tregtare e cila bazohet në njërin nga parimet themelore, autonominë e vullnetit të lirë të palëve, ka sjellur deri tek ajo që të ekzistojnë numër më i madh i mënyrave të zgjidhjes së këtyre kontesteve. Kështu veçojmë: zgjidhjen e kontesteve në rrugë paqësore, me metoda diplomatike, me pajtim, zgjidhjen e kontesteve nga gjykatat e rregullta shtetërore, nga gjykatat mbishtetërore institucionale me karakter regional ose universal, zgjidhjen e kontesteve përmes organeve joshtetërore-mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve si ndërmjetësimi, conciliation, minitrial, summary jury trial, early neutral evaluation, arbitrazhi, ombudsmeni etj.<sup>3</sup>

Pikërisht këto të fundit, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi si mënyra jashtëgjyqësore-alternative për zgjidhjen e kontesteve midis palëve, përbëjnë thelbin e interesit tonë në këtë punim. Të krahasuara me mënyrën e rregullt të zgjidhjes së kontesteve, asaj gjyqësore, mënyrat jashtëgjyqësore shtjellohen në përpunimin e mëposhtëm të këtij studimi në pjesë të veçanta.

Gjatë zhvillimit të bashkësisë shoqërore, e drejta në mbrojtje juridike të të drejtave subjektive të njohura, është realizuar në forma të ndryshme. Kështu, gjatë zhvillimit më të hershëm të saj, bashkësia shoqërore është kufizuar vetëm në njohjen e të drejtave subjektive duke mos paraparë mënyrë të organizuar të mbrojtjes së këtyre të drejtave. Andaj, duke filluar që nga periudha më e hershme e zhvillimit shoqëror në skenë ka dominuar mbrojtja private e të drejtave – vetëmbrojtja. Vetëmbrojtja, e cila paraqet formën më të vjetër të mbrojtjes së të drejtave, nënkupton mbrojtjen private të të drejtave nga ana e vetë titullarit të së drejtës subjektive të shkelur apo rrezikuar. Vetë titullari i së drejtës subjektive ka vlerësuar nëse i është shkelur e drejta dhe ka ndërmarrë masa për mbrojtjen e asaj të drejte të tij.

Në fazën e mëvonshme të zhvillimit shoqëror, me intensifikim e marrëdhënieve juridike dhe rritjen e numrit të konflikteve mes subjekteve të së drejtës, bëhen përpjekje për tu gjetur zgjidhje tjera për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave. Në këtë fazë të zhvillimit, konfliktet midis tyre, palët përpiqen ti zgjidhin vetë, ose pajtohen që konflikti i tyre t'u

---

<sup>3</sup> Shimac, S. "Mirenje-Alternativni način rješavanja sporova", Zagreb, *Informator* nr. 5404, 2005, f.13.

besohet për zgjidhje personave të tretë, të cilët kanë gëzuar besimin e palëve (gjyqtarë të zgjedhur, arbitra). Por, zgjidhja e konflikteve nga ana e gjyqtarëve të zgjedhur, në këtë fazë të zhvillimit, akoma nuk paraqet mënyrë të organizuar të mbrojtjes, por vazhdon të realizohet ende si mbrojtje private e të drejtave.

Forma e organizuar e mbrojtjes së të drejtave paraqitet gradualisht me forcimin e shtetit si aparat i dhunës. Në kushte të këtilla vjen deri tek zëvendësimi i mbrojtjes private të të drejtave me mbrojtjen e organizuar shtetërore, ku shteti parasheh rregulla të veprimit për mbrojtjen e të drejtave dhe organizon mekanizmin për ofrimin e asaj mbrojtje. Në këtë mënyrë vjen deri tek krijimi i procedurës civile, si procedurë për gjykim të drejtë – si formë bashkëkohore e mbrojtjes së të drejtave.

Në sistemet juridike bashkëkohore, mbrojtja e të drejtave, si formë e rregullt, sigurohet përmes organeve të specializuara shtetërore–gjykatave, sipas rregullave dhe në procedurë paraprakisht të përcaktuar me ligj, të cilave duhet tu përmbahen si ato të cilët kërkojnë mbrojtjen e të drejtave ashtu edhe ato të cilët atë mbrojtje sigurojnë. Përmes mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, shteti siguron mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave subjektive të cilat nuk janë realizuar në mënyrë spontane nga subjektet e së drejtës. Shteti është i obliguar të siguroj mbrojtjen e të gjitha të drejtave subjektive të njohura, dhe për të gjitha subjektet.

Mbrojtja e të drejtave subjektive civile të shkelura, kontestuar apo rrezikuara, realizohet përmes metodës së veçantë të mbrojtjes juridike të të drejtave subjektive civile – procedurës civile.

## **A.ZGJIDHJA GJYQËSORE E KONTESTEVE**

### **1. Vërejtje hyrëse**

Procedura civile paraqet mënyrën e veçantë të veprimit, të përcaktur me ligj nga ana e shtetit, të gjykatave dhe organeve tjera kompetente të cilët së bashku me palët dhe pjesëmarrësit tjerë, ndërmarrin një mori veprimesh të ndërlidhura dhe pasuese, me qëllim që të hetojnë nëse ekzistojnë presupozime për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat subjektive civile për të cilat mbrojtja është kërkuar, nëse ndërkaq vërtetohet se mbrojtja është e bazuar, të përcaktohen masat për realizimin e mbrojtjes.

Procedura civile është nocion i përgjithshëm, i cili në vete përfshin më tepër metoda të veçanta për mbrojtjen juridike të të drejtave subjektive civile. Pra, procedura civile përbëhet prej më tepër procedurave të ndryshme përmes së cilave ofrohet mbrojtje juridike e ndryshme, varësisht nga lloji i shkeljes konkrete të të drejtave. Edhe pse në teori ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me ndarjen e procedurës civile, është e padyshimtë se mbrojtja e të drejtave subjektive civile realizohet në procedurë kontestimore, jokontestimore, përmbarese dhe falimentuese, si metoda të posaçme të procedurës civile, me ç'rast procedura falimentuese trajtohet si lloj i veçantë i procedurës jokontestimore, por dhe si procedurë e posaçme për përmbarrim gjeneral. Secila nga këto procedura të veçanta është e rregulluar me ligj të veçantë, me ç'rast është përcaktuar edhe objekti i tyre.

Për punimin tonë, nga aspekti krahasues, rëndësi të veçantë paraqet mbrojtja e të drejtave subjektive civile në procedurë kontestimore, andaj, në vazhdim do të trajtojmë vetëm këtë metodë të mbrojtjes së të drejtave subjektive civile.

**Procedura kontestimore** paraqet metodën e përgjithshme, të rregullt dhe themelore për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile të shkelura apo rrezikuara nga ana e organeve gjyqësore.

Me LPK, i cili paraqet burimin themelor të së drejtës procedurale kontestimore, janë paraparë rregullat e veprimit në bazë të të cilave gjykatat shqyrtojnë dhe vendosin lidhur me të drejtat dhe detyrimet themelore të njeriut dhe qytetarit, në kontestet nga marrëdhëniet personale dhe familjare të qytetarit, si dhe në kontestet nga marrëdhëniet e punës, marrëdhëniet tregtare, pasurore si dhe në marrëdhëniet e tjera juridiko-civile, nëse me ligj nuk është paraparë se për disa nga kontestet e theksuara gjykata vendos sipas rregullave të ndonjë procedure tjetër. Nga ky përcaktim ligjor i objektit të procedurës kontestimore, mund të nxjerrim disa karakteristikat themelore, dhe atë:

- procedura kontestimore është metodë e rregullt për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile të shkelura, kontestuar apo rrezikuara;
- ajo është procedurë kontestuese, në të gjykatat shqyrtojnë dhe vendosin lidhur me kontestet nga marrëdhëniet e caktuara juridiko-civile;
- procedura kontestimore bën pjesë në procedurat e konjcionit, përkatësisht procedurat e gjykimit, në të cilat vetëm përcaktohet përmbajtja e mbrojtjes juridike e cila duhet të ofrohet, përderisa vetë mbrojtja juridike realizohet në mënyrë të dhunshme në procedurë të veçantë gjyqësore – në procedurë përmbarese.

Nga ana tjetër, rol të rëndësishëm në realizimin e mbrojtjes juridike të të drejtave në procedurë kontestimore paraqesin parimet e procedurës kontestimore. Parimet janë rregulla themelore të punës, udhërrëfytes për arritjen e qëllimit të caktuar, si dhe postulate mbi të cilat mbështetet procedura kontestimore. Përmes parimeve procedurale shprehen karakteristikat themelore të procedurës si metodë e mbrojtjes së të drejtave. Gjithashtu, parimet procedurale paraqesin kahje, ide e cila shpie në formësimin e institutive procedurale, përkatësisht zbatimin e aktiviteteve procedurale.

Disa nga parimet kryesore të procedurës kontestimore janë:

**Parimi i ligjshmërisë.** Ky parim kërkon që procedura kontestimore të zbatohet duke respektuar në tërësi rregullat juridike përkatëse. Veprimet procedurale duhet të bazohen në ligj. Subjektet procedurale janë të autorizuar që të ndërmarrin vetëm ato veprime të cilat janë të parapara me ligj. Gjykata është e obliguar që të njohë normat juridike me anë të të cilave rregullohet procedura kontestimore. Parimit të ligjshmërisë i kundërpërgjigjet në veçanti parimi i ekonomisë procedurale dhe sigurisë juridike, si dhe parimi i ndalimit të reformation in peius.

**Parimi i dispozitivitetit dhe oficialitetit.** Inicimi i procedurës, mbajtja e saj në rrjedhë, zhvillimi i stadiumeve të procedurës, pushimi i procedurës, disponimi me objektin e kontestit

dhe me materialin procedural mund të varet ose nga iniciativa e palës ose nga iniciativa e gjykatës.<sup>4</sup>

Sipas sistemit të oficialitetit, iniciativa ndodhet në duart e gjykatës, ndërkaq sipas sistemit të dispozitivitetit iniciativa varet nga vullneti dhe përcaktimi i palëve.

Në procedurën kontestimore të R. së Krocisë, mbizotëron parimi i dispozitivitetit, i cili paraqet një nga parimet themelore të procedurës kontestimore, i korrigjuar me masa që shprehin parimin e oficialitetit. Psh. pala nuk është e obliguar që të inicoj procedurën kontestimore. Nëse do të vij ose jo deri tek inicimi i procedurës kontestimore varet ekskluzivisht nga vullneti i paditësit potencial. Për palën në procedurë nuk ekziston obligim për ndërmarrjen e aktiviteteve, por vetëm autorizim për ndërmarrjen e tyre. Pra, të gjitha veprimet procedurale të palëve janë shprehje e vullnetit të tyre.

Pala, nga vullneti i së cilës varet inicimi i procedurës kontestimore, është e autorizuar të përcaktoj dhe të disponoj me objektin e kontestit. Gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë vendosur në procedure dhe ajo nuk mund të refuzojë të vendos për kërkesëpadinë për të cilën është kompetente.<sup>5</sup>

Palët mundën lirisht të disponojnë me kërkesat që i kanë paraqitur gjatë rrjedhës së procedurës, përjashtimisht, nuk lejohet dispozicionet e palëve të cilat janë në kundërshtim me dispozitat imperative (*ius cogens*) dhe rregullat e moralit.<sup>6</sup>

Parimi i oficialitetit në procedurën kontestimore shihet në faktin se kur procedura kontestimore njëherë është inicuar, ajo udhëhiqet sipas detyrës zyrtare nga gjykata deri në sjelljen e vendimit përfundimtar. Pra, gjykata nuk është e autorizuar që sipas detyrës zyrtare të inicoj procedurën kontestimore (*nemo iudex sine actor; ne procedat iudex ex officio*), por ajo është e autorizuar që pas inicimit të procedurës të ndërmerr veprimet procedurale me vetë iniciativë.

**Parimi i shqyrtimit dhe hetimit.** Këto parime paraqesin metoda pune dhe japin përgjigje në pyetjen lidhur me iniciativën për mbledhjen e materialit procedural në bazë të të cilit gjykata sjell vendimin mbi kërkesëpadinë.

Nëse iniciativa i takon palëve, bëhet fjalë për parimin e shqyrtimit, ndërkaq nëse iniciativa i takon gjykatës bëhet fjalë për parimin e hetimit, i cili mbizotëron në sistemin procedural.

Sistemi procedural kroat paraqet sistem të kombinuar të këtyre dy parimeve me mbizotërim të parimit të shqyrtimit i cili korrigjohet me parimin e hetimit. Kështu gjykata do

<sup>4</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. " *E drejta procedurale civile. L.1, E drejta kontestimore*", Shkup, 2009, f. 67.

<sup>5</sup> Neni 2. i LPK.

<sup>6</sup> Neni 3., paragr. 1 dhe 3 i LPK.

të vërtetoj vetëm ato fakte të cilat i propozojnë palët, por ajo autorizohet që të vërtetojë edhe ato fakte të cilat nuk i kanë propozuar palët, nëse dyshon se palët shkojnë në drejtim të asaj që të disponojnë me kërkesat me të cilat nuk mundën të disponojnë.<sup>7</sup>

Autorizimet dhe obligimet lidhur me shqyrtimin e palëve janë të përmbajtuar në nenin 7. paragrafi 1. të LPK, ku përcaktohet se palët janë të obliguara të parashtrorjnë të gjitha faktet mbi të cilat mbështesin kërkesat e veta si dhe të propozojnë provat me të cilat vërtetohen ato fakte.

Pra, metoda e shqyrtimit dominon në lidhje me mbledhjen e materialit mbi gjendjen faktike të kontestit, përderisa metoda e hetimit mbizotëron në fushën e mbledhjes së mjeteve provuese.

**Parimi i dëgjimit të palëve.** Ky parim paraqet parimin më të vjetër të të së drejtës procedurale civile dhe nënkupton obligimin për gjykatën që secilës palë ti mundësoj që të shprehet lidhur me kërkesat dhe pretendimet e palës kundërshtarë.<sup>8</sup>

Në thelbin e vetë, parimi i dëgjimit të palëve ka të bëjë me rregullën që secilës palë duhet mundësuar që të ndërmerr të gjitha ato veprime procedurale të cilat mund ti ndërmerr edhe pala tjetër në procedurë.

Megjithatë, këtu parashtrorhet pyetja se si do të duhej të reagohej ndaj joaktivitetit të palëve në procedurë?! Lidhur me këtë pyetje, në përgjithësi janë të njohura tre zgjidhje (sisteme) të ndryshme:

- sistemi i litiskontestacionit afirmativ ose pozitiv<sup>9</sup>,
- sistemi i litiskontestacionit negativ<sup>10</sup> dhe
- sistemi i qëndrimit të papërcaktuar ndaj joaktivitetit të palëve<sup>11</sup>.

Në sistemin juridik kroat është pranuar sistemi i qëndrimit të papërcaktuar ndaj joaktivitetit të palëve, ndërsa përjashtimisht edhe sistemi i litiskontestacionit afirmativ edhe atë tek aktgjykimi për shkak të mosdhënies së përgjigjes në padi<sup>12</sup> dhe aktgjykimi për shkak të mungesës<sup>13</sup>.

**Parimi i konstatimit të së vërtetës.** Ky parim është metodë pune e gjykatës, të cilën e përdor gjatë grumbullimit të materialit procedural në bazë të të cilit, gjykata duhet të sjell

---

<sup>7</sup> Neni 7. paragr. 2 i LPK.

<sup>8</sup> Neni 5. paragr. 1 i LPK.

<sup>9</sup> Sipas të cilit pala e cila nuk deklarohet lidhur me kërkesat e kundërshtarit, me vetë sjelljen e tillë ajo pranon vërtetësinë e pretendimeve të kundërshtarit, e ndonjëherë edhe bazën e kërkesave të tij. Ky sistem është i dobishëm për shkak se i motivon palët që të jenë aktive.

<sup>10</sup> Sipas të cilit, pala e cila nuk deklarohet lidhur me kërkesat e kundërshtarit, me vetë sjelljen e tillë ajo mohon vërtetësinë e pretendimeve të kundërshtarit, ashtu që gjykata është e obliguar të vërtetoj faktet e rëndësishme.

<sup>11</sup> Sipas sistemit të qëndrimit të papërcaktuar ndaj joaktivitetit të palëve nuk mund të sillen kurrëfarë konkludimi mbi vullnetin e palëve, ashtu që gjykata është e obliguar dhe autorizuar që të vërtetoj gjendjen faktike e të sjell vendimin.

<sup>12</sup> Neni 331.b i LPK.

<sup>13</sup> Neni 332. i LPK.



vendimin e vet.<sup>14</sup> Thelbin e këtij parimi e përbën kërkesa që gjykata në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të vërtetoj gjendjen faktike që të mund drejtë të zbatojë të drejtë materiale, përkatësisht që të mund të sjell vendimin e drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata me anë të ekzaminimit të provave e provon vërtetësinë e fakteve relevante të cilat duhet ta përbëjnë bazën e vendimit gjyqësor. Për këtë qëllim, ajo shërbehet me metoda të caktuara për vlerësimin e provave, përkatësisht sisteme për zgjedhjen, ekzaminimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese, dhe atë:

- sistemi i vlerësimit të lirë të provave<sup>15</sup> dhe
- sistemi i vlerësimit legal të provave<sup>16</sup>.

Në sistemin juridik kroat vlen parimi i vlerësimit të lirë të provave. Se cilat fakte do të merren si të provuara, vendos gjykata sipas bindjes së vet, në bazë të vlerësimit të ndërgjegjshëm dhe me kujdes të çdo prove veçmas dhe të të gjitha provave së bashku, si dhe në bazë të rezultateve të procedurës në tërësi.<sup>17</sup>

**Parimi i zhvillimit të gjykimit gojarisht dhe me shkrim.** Këto parime janë parime procedurale lidhur me formën në të cilën ndërmerren veprimet procedurale në procedurë.

Parimi i zhvillimi të gjykimit gojarisht kërkon që të gjitha veprimet procedurale të ndërmerren gojarisht, ndërkaq parimi i zhvillimit të gjykimit me shkrim ju mohon rëndësinë çfarëdo veprimi në procedurë i cili nuk është ndërmarrë në mënyrë të shkruar.

Me LPK është përcaktuar se nëse për veprime të caktuara nuk është përcaktuar forma në të cilën mund të ndërmerren, veprimet e tilla mund të ndërmerren në mënyrë të shkruar jashtë seancave ose me gojë brenda seancës.<sup>18</sup> Ligji pra, në parim përcakton si dominuese mënyrën gojore të ndërmarrjes së veprimeve procedurale në seancë, ndërkaq jashtë seancës dominon parimi me shkrim.

**Parimi i pandërmjetësisë.** Ky parim paraqet metodë pune për grumbullimin dhe ekzaminimin e materialit procedural. Parimi i pandërmjetësisë kërkon që: gjykata me shqisat e veta të vërejë natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese; që gjykata para së cilës nxjerret materiali procedural të jetë po ajo gjykatë e cila do të vendos edhe për fuqinë provuese të

---

<sup>14</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 80.

<sup>15</sup> Për sistemin e vlerësimit të lirë të provave është karakteristike mungesa e rregullave ligjore mbi zgjedhjen, ekzaminimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Për të gjitha këto çështje gjykata vendos lirshëm, pa qenë e lidhur, përkatësisht, e kufizuar me rregulla të veçanta formale provuese apo me dispozicionin e palëve.

<sup>16</sup> Sipas sistemit të vlerësimit legal të provave, vetë ligji përcakton parakushtet për zgjedhjen, ekzaminimin dhe fuqinë provuese të provave. Për këtë sistem është i parëndësishëm qëndrimi i gjyqtarit, ngase paraprakisht është përcaktuar me ligj se cilat mjete provuese mund të përdoren, si dhe përcaktohet vlera e mjeteve të veçanta provuese, ashtu që gjykata është e obliguar të respektoj atë rangim të cilin e përcakton vetë ligji.

<sup>17</sup> Neni 8, i LPK.

<sup>18</sup> Neni 14, i LPK.

mjeteve provuese; që po ajo gjykatë të sjell vendimin menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit.

Në sistemin procedural kroat, si rregull e përgjithshme pranohet parimi i pandërmjetësisë, pasi gjykata vendos për kërkesëpadinë, sipas rregullit në bazë të shqyrtimit gojor, të drejtëpërdrejtë dhe publik.<sup>19</sup> Mirëpo, lejohen edhe shmangie nga kjo rregull. Kështu shmangiet manifestohen si:

- kur provat nuk ekzaminohen para këshillit gjyqësor, por nga vete kryetari i këshillit gjyqësor ose gjyqtari i lutur;
- kur gjykata nuk i përsërit provat e ekzaminuara në seancën e re për shqyrtim kryesor, por kufizohet në leximin e procesverbalit nga seanca e mëparshme;
- kur gjykata e shkallës së dytë vlerëson faktet duke u mbështetur në procesverbalet mbi provat e ekzaminuara në mënyrë të pandërmjetësueshme para gjykatës së shkallës së parë.

**Parimi i publicitetit.** Ky parim është parimi kushtetues i cili kërkon që secilit, pra, numrit të papërcatuar të personave të cilët paraprakisht nuk janë të individualizuar, tu sigurohet prezenca e papenguar në shqyrtim para gjykatës.

Realizimi i parimit të publicitetit hasën në pengesë faktike – kufizimin hapsinorë të dhomës së gjyqit. Andaj, ky parim nuk do të konsiderohet se është shkelur nëse në shqyrtim mundësohet prezenca e vetëm një numri të caktuar të personave duke pasur parasysh madhësinë e dhomës së gjyqit. Në shqyrtim kryesor marrin pjesë vetëm personat e moshës madhore, të cilëve u ndalohet mbajtja e armëve dhe veglave të rrezikshme, përveç nëse janë rrojet e personave të cilët marrin pjesë në procedurë.<sup>20</sup>

Në disa konteste publiku është i përjashtuar me ligj, ndërsa në disa konteste tjera gjykata është e autorizuar që të vlerësoj nëse janë përmbushur kushtet për përjashtimin e publikut. Kështu, me ligj është paraparë përjashtimi i publikut në marrëdhëniet statusore të personave fizik, pra në procedurat nga kontestet martesore, procedurat e atësisë dhe amësisë, si dhe në kontestet për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve dhe në kontestet për mbajtje.

Gjykata është e autorizuar që ti shmanget parimit të publicitetit kur ekzistojnë shkaqet e parapara me ligj: interesi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose private, interesi i rendit publik dhe arsytet e moralit, si dhe atëherë kur përmes masave për mbajtjen e rendit të parapara me ligj nuk do të mund të sigurohej mbajtja e papenguar e shqyrtimit.<sup>21</sup>

---

<sup>19</sup> Neni 4. i LPK.

<sup>20</sup> Neni 306. i LPK.

<sup>21</sup> Neni 307. i LPK.

Përrjashtimi i publikut nuk ka të bëjë me palët, përfaqësuesit e tyre dhe ndërhyrësit.<sup>22</sup>

Nëse në kundërshtim me ligjin publiku ka qenë i përjashtuar nga shqyrtimi kryesor, në atë rast veprimi i tillë paraqet shkelje esenciale absolute e dispozitave të procedurës kontestimore.<sup>23</sup>

**Parimi i interesit juridik.** Që të mund të kërkohet mbrojtja juridike gjyqësore është e nevojshme që të ekzistoj interesi juridik i personit që kërkon mbrojtjen e së drejtës. Interesi juridik paraqet presupozim procedural nga ekzistimi i të cilit varet lejimi i inicimit dhe shqyrtimit në procedurë kontestimore, si dhe sjellja e vendimit meritor mbi bazueshmërinë e kërkespadiës.

LPK në tre vende flet për ekzistimin e interesit juridik si parakusht për aktivitetin gjyqësor:

- interes të tillë duhet të posedoj paditësi i cili paraqet padi për konstatim,
- ndërhyrësi i cili dëshiron të ndërvenoj në kontestin i cili rrjedh mes personave tjerë dhe
- pala e cila paraqet mjetin juridik.

Interesi juridik i paditësit presupozohet.

Për ekzistimin e interesit juridik gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kur konstaton se ekziston mungesa e interesit juridik, gjykata është e obliguar që të hedh poshtë padinë, përkatesisht kërkesën tjetër.

**Parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm.** E drejta për gjykim në afat të arsyeshëm është e drejtë themelore procedurale e njeriut e garantuar me KEDNJ, të cilën e ka ratifikuar Republika e Kosovës. Sipas Konvetës, secili ka të drejtë që për konstatimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij të natyrës juridiko-civile, rastin e tij ta hetoj gjykata e themeluar me ligj, e pavarur, e paanshme, publikisht dhe në afat të arsyeshëm.<sup>24</sup> Andaj, parimi i gjykimit në afat të arsyeshëm paraqet parim themelor procedural dhe standard juridik.

Me LPK është përcaktuar detyrimi i gjykatës që të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje, në afat të arsyeshëm. Afati i arsyeshëm paraqet kohën brenda së cilës gjykata duhet të përfundoj procedurën në mënyrë meritorë, varësisht nga kontesti konkret, kompleksiteti i saj, sjellja e palëve në procedurë, etj. Pasi që do ishte e pamundur që ligjdhënësi të përcaktoj kohëzgjatjen e çdo kontesti konkret, ky parim kërkon nga gjykata dhe palët që të kujdesen që procedura të zbatohet në afat të arsyeshëm, pa zvarritje dhe keqpërdorime.

---

<sup>22</sup> Neni 308. paragr. 1 i LPK.

<sup>23</sup> Neni 354. paragr. 2 pika 10 i LPK.

<sup>24</sup> Neni 6. paragr. 1 i KEDNJ.

**Parimi i ekonomisë procedurale.** Gjykata është e obliguar që të përpiqet që të udhëheq procedurën pa zvarritje, në afat të arsyeshëm dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të pamundësoj çfarëdo keqpërdorimi të së drejtës në procedurë<sup>25</sup>.

Realizimi i tepërt i parimit të ekonomisë procedurale shpie në konflikt me kërkesën për vërtetimin e drejtë të fakteve të rëndësishme, si dhe me parimin e ligjshmërisë.

**Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim të autorizimeve procedurale.** Këtë parim e quajmë edhe si parimi i ndalimit të keqpërdorimit të së drejtave. Keqpërdorimi i të drejtave paraqet shfrytëzimin e autorizimeve juridike me qëllim që tjetrit ti shkaktohet dëm, ose me qëllim i cili është në kundërshtim me zakonet e mira dhe mirëbesimin në qarrkullim.

Kërkesa për shfrytëzimin me mirëbesim të autorizimeve procedurale manifestohet në obligimin e palëve dhe ndërhyrësve që para gjykatës të thonë të vërtetën dhe me mirëbesim të shfrytëzojnë të drejtat të cilat u njeh ligji<sup>26</sup>. Nga ana tjetër, siç theksuam dhe më lartë, ligji përcakton obligim për gjykatën që të pamundësoj çdo keqpërdorim të të drejtave që u takojnë palëve në procedurë.

**Parimi i koncentrimin të procedurës dhe unitetit të shqyrtimit kryesor.** Koncentrimi i procedurës do të thotë se palët që në seancën e parë duhet të nxjerrin të gjitha faktet dhe provat ashtu që menjëherë të vërtetohet çfarë është kontestuese e çfarë jo. Pyetjes se si mund të arrihet koncentrimi i procedurës, mund ti përgjigjemi përmes dy metodave, edhe atë:

- metodës së rradhës së rreptë ligjore dhe
- metodës së arbitraritetit ose rradhës së përshtatshme (diskrecionale).

Sipas metodës së rradhitjes së rreptë ligjore, procedura ndahet në një varg stadiumesh, ashtu që ligji përcakton se cilat veprime procedurale mund të kryhen në stadiumin e caktuar dhe sipas cilës rradhitje, ndërkaq nëse pala nuk ndërmerr veprimin në stadiumin e përcaktuar për ndërmarrjen e tij, humb të drejtën për ndërmarrjen e atij veprimi më vonë.

Sipas metodës së arbitraritetit ose rradhës së përshtatshme, e cila zbatohet në sitimin procedural kroat, me ligj përcaktohet vetëm korniza e përgjithshme, instruktive dhe rradha e shqyrtimit, duke lënë hapësirë që vetë gjykata të përcaktoj atë rradhë procedurale për të cilën mendon së është më e përshtatshme në rastin konkret.

Shqyrtimi kryesor paraqet tërësi procedurale unike, bile dhe atëherë kur mbahet në më tepër seanca. Palët, në parim, janë të autorizuar që në çfarëdo faze të shqyrtimit kryesor të ndërmarrin veprime të caktuara procedurale pa frikë se të njëjtat do të hedhen poshtë nga

---

<sup>25</sup> Neni 10. paragr. 1 i LPK.

<sup>26</sup> Neni 9. i LPK.

gjykata për shkak se janë ndërmarrë me vonesë, pastaj në seancën e re nuk është e nevojshme të përsëritet ajo që është ndërmarrë më herët por e njejta vetëm rezumohet.

## **2. Subjektet e procedurës kontestimore**

Në procedurën kontestimore, si metodë themelore për mbrojtjen e të drejtave, marrin pjesë subjekte të ndryshme, të cilët me një term të përgjithshëm i quajmë pjesëmarrës në procedurë kontestimore. Të gjithë pjesëmarrësit në procedurën kontestimore nuk janë të ranguar njësoj. Kështu, dallojmë pjesëmarrësit kryesor ose primar dhe pjesëmarrësit e tjerë ose sekondar në procedurën kontestimore.

Pjesëmarrës kryesor ose primar të procedurës kontestimore janë palët procedurale, përkatësisht paditësi, i padituri dhe gjykata. Pjesëmarrësit e tjerë ose sekondar në procedurë kontestimore janë përfaqësuesit e palëve, ndërhyrësit, dëshmitarët, ekspertët, procesmbajtësit, interpretuesit, përkthyesit, etj.

### **3.1. Gjykata**

Gjykatat janë organe shtetërore, autonome dhe të pavarura të cilat ushtrojnë pushtetin gjyqësor, përkatësisht gjykojnë dhe sjellin vendime duke u bazuar në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën. Gjykatat janë organe të përhershme të pushtetit shtetëror, që do të thotë se pushteti gjyqësor nuk mund të ushtrohet nga gjykatat e përkohshme, të krijuara ad hoc me ligj ose me akte të pushtetit ekzekutiv. Kjo nuk do të thotë se funksionin gjyqësor përveç gjykatave të përhershme nuk mund ta ushtrojnë edhe gjykatat e përkohshme, mirëpo këto të fundit paraqiten si gjykata joshtetërore, të zgjedhura (arbitrazhe), të cilat janë jashtë pushtetit gjyqësor dhe të cilave nën kushtet e parapara me ligj, palët u besojnë zgjidhjen e kontesteve juridiko civile.

#### **1. Organizimi i Gjykatave në Republikën e Kosovës**


Më Ligjin për Gjykatat në nënin 4 është percaktuar së Sistemi i i Gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga:

- Gjykatat Themelore,
- Gjykata e Apelit dhe
- Gjykata Supreme.

Degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore.

**GJYKATA SUPREME**

**GJYKATA E APELIT**



### 1.1 Gjakatat Themelore

Gjakatat themelore janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Ashtu si shihet edhe nga figura e mësipërme, ekzistojnë gjithsej shtatë (7) gjykata themelore, më degë të shpërndara në vende të ndryshme. "Në qoftë se në territorin e një komune nuk ekziston ndonjë degë, atëherë lëndët nga kjo komunë do të bien nën juridiksionin e selisë kryesore të Gjykatës Themelore"<sup>27</sup>. Nëse në territorin e një komune nuk ekziston një degë e Gjykatës Themelore, atëherë kjo komunë mundet që, me vendim të Kuvendit Komunal, të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të themelojë një degë brenda territorit të saj ose që kjo të përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Themelore apo të degës së gjykatës më të afërt gjeografikisht.

#### 1.1.2 Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore

Në kuadër të gjykatës themelore ekzistojnë këto departamente të paraqitura në tabelën në vijim :

<sup>27</sup> Ligji për gjykatat në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-199, Neni 10 i këtij ligji.

### **1.1.3 Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore**

Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj<sup>28</sup>. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

### **1.1.4 Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore**

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të parapara më Kodin penal të Kosovës si krime të rënda të tilla si :angazhimet në aktet terroriste ,duke e mos e përjashtuar edhe përfshirjen në ndihmesën, mundësimin, organizimin apo mbështetjen ndaj terrorizmit apo grupeve terroriste;veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare që përfshin por nuk kufizohet në gjenocid, krimet kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës;trafikimi i emigrantëve;rafikimi i njerëzve; rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht; pengëmarrja; etj<sup>29</sup>.

### **1.1.5 Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore**

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.Të gjitha lëndët e paraqitura pranë Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore do të gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionalë, përveç nëse me ligj nuk parashihet ndryshe<sup>30</sup>.

### **1.1.6 Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore**

Më Ligjin për gjykata të Kosovës është përcaktuar se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent për këto çështje : kontestet ndërmjet personave juridik

<sup>28</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 14 ,paragrafi (1).

<sup>29</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 15.

<sup>30</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 16.


vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste; riorganizim, falimentim dhe shuarjen e personave juridik, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe; kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, etj<sup>31</sup>.

## 2. Gjkata e Apelit

Gjkata e Apelit është gjykate e shkallës së dytë me jurisdikcion territorial në gjithë Republikën e Kosovës. Selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë. Gjykata e Apelit është kompetente të shqyrtojë:

- të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore;
- të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është lejuar me ligj dhe për konfliktin e juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore;
- të vendos për konfliktin e jurisdikcionit ndërmjet Gjykatave Themelore;
- çështjet tjera të parapara me ligj<sup>32</sup>.

Njëjtë si Gjykata Themelore, ashtu edhe Gjykata e Apelit është e organizuar në pesë departamente: Departamenti i Përgjithshëm; Departamenti për Krime të Rënda; Departamenti për Çështje Ekonomike; Departamenti për Çështje Administrative; Departamenti për të Mitur.



## 3. Gjykata Supreme

Gjykata Supreme është autoriteti gjyqësor më i lartë në Kosovë dhe vendos si gjykatë e shkallës së tretë, për ankesat që lejohen me ligj dhe për mjetet juridike të jashtëzakonshme apo çështjet e tjera siç parashihet me ligj. Gjykata Supreme përfshin kolegjin e apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së

<sup>31</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 13.( Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe)

<sup>32</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 18.



cilës janë pjesë e Gjykatës Supreme<sup>33</sup>. Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë.

### **3.1 Përbërja e Gjykatës Supreme**

Më Kushtetutën e Kosovës në nenin 103 është precaktuar se “të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë”<sup>34</sup>. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij”<sup>35</sup>. Po ashtu, më Kushtetutën e Kosovës në nenin 103 është precaktuar se edhe të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me jurisdikcionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë duhet të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

### **4 .Emërimi i Gjyqtarëve**

Sipas nenit 104 të Kushtetutës së Kosovës, Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të jurisdikcionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.

Në Ligjin për Gjykata janë precaktuar këto kualifikime të cilat duhet ti posedojnë kandidatët për tu emëruar si gjykatës, kështu :

- të jetë shtetas Kosovar
- të ketë më se paku njëzet e pesë (25) vite;
- të kenë diplomë të vlefshme universitare të juristit, të pranuar me ligjet e Kosovës;
- të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;
- ta ketë dhënë provimin për gjyqtar në pajtim me Ligjin për Institutin Gjyqësor;
- të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet moral;
- të mos jetë i dënuar për veprë penale të precaktuar me ligjin në fuqi;
- të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune juridike;

<sup>33</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-199, Neni 21.

<sup>34</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 103.

<sup>35</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 103 paragrafi 4.

- të ketë kaluar me sukses procesin e vlerësimit në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Përveç, kualifikimeve të lartpërmendura të njohura si kualifikime minimale ,Ligji për Gjykatat ka përcaktuar edhe disa kualifikime të tjera ,kështu “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore,kandidati duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore dhe së paku gjashtë (6) vite përvojë në fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën në lëmin penal;”<sup>36</sup>“që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike te Gjykatës Themelore, kandidati duhet të ketë së paku gjashte (6) vite përvojë ne fushën juridike duke përfshirë edhe përvojën ne çështjet administrative dhe ekonomike, respektivisht;”<sup>37</sup>“që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Gjykatën e Apelit, kandidati duhet të ketë së paku dhjete (10) vite përvojë si gjyqtar,<sup>38</sup> “që të ushtroj funksionin e gjyqtarit ne Gjykatën Supreme, kandidati duhet të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë si gjyqtar”.<sup>39</sup>

#### **4.1 Mandati i gjyqtarëve**

Më Kushtetutën e Kosovës në nenin 105 ,është parapare mandati fillestar trevjeçar për gjyqtarët.Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve<sup>40</sup>.

#### **4.2 Shkarkimi i gjyqtarëve**

Sipas Kushtetutës së RK neni 104 (paragrafi 4), Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave. Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

#### **4.3 Gjyqtarët porotë**

Sipas Ligjit për Gjykata të Kosovës ,për tu emëruar një kandidat si gjykatës porotë duhet plotësuar këto kualifikime :

- të jenë shtetas dhe banorë të Kosovës;

<sup>36</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 26 paragrafi 2.1.

<sup>37</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 26 paragrafi 2.2.

<sup>38</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 26 paragrafi 2.3.

<sup>39</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës . Nr. 03/L-199.Neni 26 paragrafi 2.4.

<sup>40</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 105 paragrafi (1),(2).

- të kenë më se paku njëzetepesë (25) vite;
- të kenë përfunduar me sukses trajnimin e kërkuar me ligj që të shërbej në kapacitetin e kërkuar;
- të kenë përmbushur kriteret e kërkuara nga rregulloret relevante të Këshillit Gjyqësor i Kosovës të mos jenë të dënuar për vepra penale me përjashtim të kundërvajtjeve;
- të kenë reputacion të lartë moral në shoqëri.
- Gjyqtarët porotë do të shpërblehen për shërbimet e tyre sipas një plani të kompensimi i cili përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.<sup>41</sup>

### 4.3.Kompetenca

Që të mund gjykata të veprojnë dhe vendosë në një çështje të caktuar juridike, duhet që të jëtë kompetentë për çështjen e tillë. Pra, kompetenca e gjykatës paraqet njërin nga prezumimet procedurale shumë të rëndësishme për inicimin, zhvillimin dhe përfundimin e plotëfuqishëm të procedurës, përkatësisht për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara procedurale.

Kompetenca (*competentio*), përcaktohet në mënyrë të dyfishtë: në kuptimin objektiv dhe subjektiv. Në kuptimin objektiv, kompetencë do të thotë rrethi i punëve të cilat i kryen organi i caktuar.<sup>42</sup> Në kuptimin subjektiv, kompetenca është e drejtë dhe detyrë e organit të caktuar shtetëror të veprojnë dhe të vendosë në një çështje të caktuar juridike ose të ndërmarr një veprim të caktuar procedural.<sup>43</sup>

Në kornizat e kompetencës gjyqësore, dallojmë kompetencën absolute, e cila mundëson ndarjen e kompetencës së gjykatave nga kompetenca e organeve tjera dhe kompetencën relative, me ndihmën e së cilës bëhet kufizimi i rrethit të punëve ndërmjet gjykatave të sistemit gjyqësor të vendit.

Në kornizat e kompetencës relative bëjnë pjesë: kompetenca lëndore (*competentia ratione materie*), kompetenca vendore (*competentia ratione loci*) dhe kompetenca funksionale. Kompetenca lëndore (*competentia ratione materie*) paraqet të drejtën dhe detyrimin e gjykatave të caktuara që të gjykojnë llojet e caktuara të kontesteve. Pra, me të bëhet kufizimi i rrethit të punëve ndërmjet gjykatave të llojeve të ndryshme, si dhe ndërmjet gjykatave të llojit të njejtë por të rangut të ndryshëm.<sup>44</sup> Rregullat mbi kompetencën lëndore

<sup>41</sup> Ligji për gjykatat i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-199.Neni 28.

<sup>42</sup> Triva, S., Belajec, V., dhe Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 1989, f.197.

<sup>43</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 110.

<sup>44</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 258.

përcaktohen me dispozita të veçanta ligjore me të cilat përcaktohet themelimi, funksionimi dhe organizimi i punëve të gjykatave.

Kompetenca vendore (*competentia ratione loci*) përcakton se cila gjykatë me kompetencë lëndore është kompetente të veprojë dhe vendos në rastin konkret.

Kompetenca funksionale është lloj specifik i kompetencës lëndore, e cila përcaktohet sipas funksioneve të cilat duhet të kryhen në një çështje të caktuar juridike dhe tregon se si është realizuar ndarja e punëve ndërmjet gjykatave të rangut të ndryshëm, si edhe ndërmjet përbërjeve të ndryshme të gjykatës së njëjtë.<sup>45</sup>

Kompetenca e gjykatës në procedurë kontestimore përcaktohet me ligj, përkatësisht ligji është ai i cili parasheh rregullat për përcaktimin e kompetencës së gjykatës. Ndërkaq, varësisht se në ç'mënyrë ligji përcakton kompetencën e gjykatës, dallojmë: forum legale, forum iudiciale, forum conventionale dhe forum electivum.

Kur kompetenca e gjykatës është e përcaktuar shprehimisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me dispozita imperative ligjore, fjala është për forum legale.<sup>46</sup>

Kur me ligj, parashihet mundësia e përcaktimit të kompetencës së gjykatës me vendim të gjykatës, fjala është për forum iudiciale.<sup>47</sup>

Kur me ligj parashihet mundësia e përcaktimit të kompetencës së gjykatës me marrëveshje midis palëve, fjala është për forum conventionale.<sup>48</sup>

Me ligj, në raste dhe nën kushte të caktuar, është paraparë lejimi i vetëm njëjës palë që të zgjedh gjykatën kompetente, dhe në këtë rast bëhet fjalë për forum electivum.<sup>49</sup>

Kur organi i cili vepron dhe vendos në një çështje të caktuar juridike, nuk është kompetent për një gjë të tillë, bëhet fjalë për jokompetencë. Edhe pse me ligj nuk është përcaktuar shprehimisht që nuk lejohet gjykimi nga gjykata jokompetente, përfundimi i tillë mund të nxiret nga rregulla sipas së cilës gjykata nuk ka mundësi të refuzoj të vendos lidhur me kërkesën për të cilën është kompetente.<sup>50</sup>

Lidhur me jokompetencën dallojmë dy lloje themelore, dhe atë:

- a) **jokompetencën absolute** – e cila ekziston atëherë kur asnjë gjykatë nuk është kompetente për të vepruar e vedosur në çështjen e caktuar juridike, dhe

<sup>45</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 112.

<sup>46</sup> Në përcaktimin e kështillë të kompetencës nuk mund të ndikojnë as gjykata e as palët. Kështu përcaktohet kompetenca lëndore.

<sup>47</sup> Kështu përcaktohet, nën rrethana të caktuara, kompetenca vendore.

<sup>48</sup> Palët, nën kushtë të caktuar me ligj, mundën me marrëveshje të përcaktojnë vetëm kompetencën vendore.

<sup>49</sup> Kështu mund të përcaktohet vetëm kompetenca vendore.

<sup>50</sup> Neni 2, paragraf. 2 i LPK.

**b) jokompetencën relative** – e cila ekziston atëherë kur gjykata e caktuar nuk është kompetente në pikëpamje lëndore dhe vendore që të veproj e vendos për çështjen e caktuar juridike.

Gjykatat mbajnë llogari për (jo)kompetencën varësisht nga lloji i jokompetencës, kështu që disa lloje të jokompetencës përbëjnë pengesë procedurale të pashmangshme për zhvillimin e procedurës, ndërsa disa lloje tjera janë të shmangshme dhe nuk paraqesin kurrëfarë pasojash juridike për zhvillimin e procedurës.

Në rastet kur ekziston mospajtim mes gjykatës dhe organeve tjera lidhur me faktin se cila prej tyre është vërtetë kompetente që të veproj e vendos lidhur me çështjen e caktuar juridike, kemi të bëjmë me konfliktin për kompetencë. Konflikti për kompetencën mund të jetë dy llojesh: pozitiv dhe negativ. Konflikti pozitiv për kompetencë ekziston atëherë kur më shumë organe ose trupa konsiderojnë se janë kompetentë për të vepruar e vendosur lidhur me çështjen e caktuar juridike, ndërsa konflikti negativ për kompetencë ekziston atëherë kur më shumë organe ose trupe konsiderojnë se janë jokompetentë për të vepruar e vendosur në rastin konkret.<sup>51</sup>

Deri në zgjidhjen e konfliktit për kompetencë, gjykata të cilës i është dorëzuar lënda është e obliguar që të ndërmerr vetëm ato veprime në procedurë për të cilat ekziston rreziku i shtyrjes.<sup>52</sup> Kundër aktvendimit me të cilin vendoset për konfliktin për kompetencë nuk është e lejuar ankesa.<sup>53</sup>

Prezumim i rëndësishëm procedural që ka të bëjë me gjykatën është përbërja e gjykatës.

Me LPK është përcaktuar se në procedurën kontestimore të shkallës të parë gjykon gjyqtari individual, nëse me ligj nuk është paraparë se gjykon këshilli. Në shkallë të dytë gjykon këshilli (tre gjyqtarë), nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe, si dhe me rastin e revizionit.<sup>54</sup> Për ankesat kundër aktgjykimeve vendos gjyqtari individual i gjykatës më të lartë.<sup>55</sup>

Kur vendos për revizion kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës gjykon në këshill të përbërë prej pesë gjyqtarëve, nëse me

---

<sup>51</sup> Sipas një ndarje tjetër, e cila bazohet në faktin se midis kujt vjen deri tek konflikti për kompetencë, dallojmë **konfliktin për kompetencën relative** – për konflikte midis gjykatave në kuadër të sistemit gjyqësor të një shteti, dhe **konfliktin për kompetencë absolute ose juridiksion** – për konfliktin midis gjykatave dhe organeve ose trupave të tjera në kuadër të rendit të njejtë juridik. Konfliktin për juridiksion, në Republikën e Kosovës e zgjidh gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ndërsa për zgjidhjen e konfliktit për kompetencë relative vlen rregulla se konfliktet e tilla mes gjykatave të llojit të njejtë i zgjidh gjykata më e lartë e përbashkët, ndërsa midis gjykatave të llojeve të ndryshme Gjykata supreme e Republikës së Kosovës.

<sup>52</sup> Neni 24. paragr.2 i LPK.

<sup>53</sup> Po në këtë nen paragr. 3 i LPK.

<sup>54</sup> Neni 42. i LPK.

<sup>55</sup> Neni 44. paragr. 3 i LPK.

ligj nuk është paraparë ndryshe, ndërkaq, kur Gjykata Supreme vendos për revizion kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të cilat i ka sjellë gjyqtari individual, gjykon në këshill të përbërë prej tre gjyqtarëve.<sup>56</sup>

E drejta e gjykimit nga ana e gjykatës së pavarur dhe të paanshme është një nga të drejtat fundamentale procedurale të njeriut, e cila garantohet në të gjitha dokumentet relevante ndërkombëtare.<sup>57</sup> Andaj, në rastet kur ekziston dyshimi në paanshmërinë e gjyqtarit për shkak të raportit të tij me palët ose me objektin e kontestit, kjo rrethanë mund të shmanget me anë të institucionit të përjashtimit të gjyqtarëve.<sup>58</sup>

### 3.2. Palët dhe përfaqësuesit e tyre

Palë në procedurë kontestimore janë: paditësi – personi i cili nga gjykata kërkon mbrojtjen juridike me përmbajtje të caktuar dhe i padituri – personi kundër të cilit drejtohet kërkesa për mbrojtje juridike. Palë në procedurë kontestimore mund të jetë çdo person fizik dhe juridik, ndërsa me akte të veçanta përcaktohet se kush tjetër përveç personit fizik dhe juridik mund të jetë palë në procedurë.

Gjykata mundet, përjashtimisht, tu njoh zotësinë për të qenë palë edhe atyre formave të bashkimit të cilët nuk kanë zotësinë për të qenë palë, nëse vërteton se duke pasur parasysh objektin e kontestit ato në thelb i plotësojnë kushtet themelore për fitimin e zotësisë për të qenë palë.

Që të mundet personi i caktuar të jetë palë dhe në procedurë të ndërmerr vetë veprime procedurale, është e nevojshme që të plotësoj kushtet e caktuara:

- duhet të ketë zotësinë për të qenë palë,
- duhet të ketë zotësinë procedurale, ndërsa në raste të caktuara përkrah zotësisë procedurale duhet të ketë dhe zotësinë postulative,
- duhet të ketë edhe autorizim për zhvillimin e procesit kontestimor, përkatësisht, legjitimim procedural.

Zotësia për të qenë palë është cilësi e subjektit të caktuar që të mund të jetë bartës i të drejtave dhe detyrimeve procedurale. Zotësia për të qenë palë u pranohet të gjithë atyre të cilët kanë zotësinë juridike. Zotësia për të qenë palë është presupozim i zotësisë juridike.

<sup>56</sup> Po në këtë nen paragr. 4 dhe 5 i LPK.

<sup>57</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 143.

<sup>58</sup> Me LPK janë paraparë kushtet me plotësimin e të cilave vjen deri tek përjashtimi i gjyqtarëve nga gjykimi në procedurën konkrete. Në teori, por edhe në legjisllacione bëhet dallimi midis dy grupe shkaqesh: shkaqet absolute (të theksuara në mënyrë taksative në LPK) – ekzistimi i të cilave e bën të bazuar dyshimin se gjyqtari do të jetë i paanshëm në rastin konkret, pa qenë e nevojshme që të provohet një gjë e tillë, dhe shkaqet relative (në LPK parashihet klauzula gjenerale sipas së cilës gjyqtari nuk ka mundësi që të ushtroj funksionin e gjyqtarit nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e vënë në dyshim paanshmërinë e tij)– ekzistimi i të cilave nuk është bazë e sigurtë për paanshmërinë e gjyqtarit, por është tregues i mjaftueshëm që të dyshohet në paanshmërinë e tij në rastin konkret.

Të gjithë personat fizik kanë zotësinë juridike, andaj dhe zotësinë për të qenë palë, të cilën e fitojnë me lindje, ndërkaq e humbin me vdekje. Edhe personat juridik kanë zotësinë juridike, andaj dhe zotësinë për të qenë palë. Ai i cili nuk ka zotësinë për të qenë palë nuk mundet që të jetë palë në procedurë. Gjykata gjatë tërë rrjedhës së procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset nëse personi i cili paraqitet si palë në procedurë ka zotësinë për të qenë palë. Mungesa e zotësisë për të qenë palë paraqet shkelje esenciale absolute, për të cilat gjykatat në procedurën sipas mjeteve juridike kujdesen ex officio.

Zotësia procedurale paraqet cilësi të personit të caktuar që në mënyrë të plotëfuqishme të ndërmerr veprime procedurale në procedurë.<sup>59</sup> Të gjithë personat që posedojnë zotësinë e veprimit, e drejta procedurale civile u njeh zotësinë procedurale. Zotësia procedurale sipas përmbajtjes është më e ngushtë se zotësia për të qenë palë. Kjo do të thotë se çdo person i cili ka zotësinë që të jëtë palë, nuk ka edhe zotësinë procedurale, ndërkaq çdo person i cili ka zotësinë procedurale ka edhe zotësinë që të jetë palë.

Personat me zotësi të veprimit, pra edhe me zotësi procedurale, janë personat që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, personat të cilët kanë lidhur martesë para se të mbushin 18 vjet, si dhe personat të cilët janë bërë prindër para moshës 18 vjeç.

Personave të cilëve u është marrë në tërësi zotësia e veprimit, nuk kanë zotësi procedurale. Për to, veprimet procedurale i ndërmarrin përfaqësuesit ligjor.

Për zotësinë procedurale gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare gjatë tërë rrjedhës së procedurës. Shkelja e rregullave mbi zotësinë procedurale paraqet shkelje esenciale absolute.

Zotësia postulative është cilësi e personit me zotësi procedurale që vetë, pa ndihmën e askujt, drejtëpërdrejtë të ndërmerr veprime procedurale para gjykatës në mënyrë të plotëfuqishme.<sup>60</sup> Në sistemin procedural kroat pala nuk duhet të ketë përfaqësues profesional me prokurë.

Krahas zotësisë për të qenë palë dhe zotësisë procedural, e në disa raste dhe zotësisë postulative, personi i cili merr pjesë si palë në procedurë duhet të ketë dhe autorizim për zhvillimin e kontestit konkret- legjitimim procedural (legitimatío ad procesum).<sup>61</sup> Legjitimimi procedural është pasqyrim i raportit juridik konkret të palës me objektin e kontestit konkret. LPK nuk përmban rregulla për legjitimim procedural. Për ekzistimin e legjitimimit procedural e drejta procedurale udhëzon në të drejtën materiale. Ekzistimi i legjitimimit procedural do të thotë që palët janë palë të vërteta, se kanë interes juridik për

<sup>59</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 308.

<sup>60</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 311.

<sup>61</sup> Po aty, f. 314.

zhvillimin e kontestit konkret. Nëse paditësi nuk e bën të besueshme ekzistimin e legjitimitetit procedural të palëve, gjykata do ta hedh poshtë padinë.

Për ekzistimin e legjitimitetit procedural për zhvillimin e kontestit konkret mund të konkludohet në dy mënyra:

- në bazë të normës juridike e cila autorizon subjektet e caktuara që të kërkojnë mbrojtje të caktuar, dhe
- në bazë të interesit juridik të dëshmuar për fitimin e aktgjykimit më të volitshëm në procedurë.<sup>62</sup>

Siç theksuam dhe më lartë, personat të cilët nuk kanë zotësinë e veprimit ose ajo në tërësi u është marrë, nuk kanë zotësinë procedurale, andaj veprimet në emër dhe interes të tyre i ndërmarrin përfaqësuesit ligjor të tyre.

Përfaqësuesit ligjor janë persona fizikë me zotësi veprimi dhe zotësi procedurale, të cilët janë të autorizuar që në llogari dhe në emër të palëve të cilat janë pa zotësi procedurale ose për shkaqe të tjera nuk janë në gjendje që të mbrojnë interesat e veta, të ndërmarrin veprime procedurale në procedurë.

Përfaqësuesit ligjor, munden në emër të palës të ndërmarrin të gjitha veprimet në procedurë, mirëpo nëse për paraqitjen ose tërheqjen e padisë, për pranimin ose dorëheqjen nga kërkesëpadija, për lidhjen e pajtimit ose për ndërmarrjen e veprimeve tjera në procedurë është e nevojshme që përfaqësuesi të ketë autorizim të veçantë, atëherë veprimet e tilla mund ti ndërmerr vetëm nëse ka autorizim të tillë.

Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i obliguar që me kërkesë të gjykatës të dëshmojë që është përfaqësues ligjor, përkatësisht se ka autorizimin e nevojshëm. Kur gjykata do të konstatojë se përfaqësuesi ligjor i personit nën kujdestari nuk tregon kujdesin e nevojshëm gjatë përfaqësimit, do ta lajmëroj qendrën për punë sociale, ndërkaq nëse nga pakujdesia e tillë do të mund të paraqiteshin pasoja të dëmshme për personin nën kujdestari, gjykata do të ndal procedurën dhe do të propozojë që të përcaktohet përfaqësues tjetër ligjor.

Gjykata gjatë tërë rrjedhës së procedurës kujdeset sipas detyrës zyrtare nëse personi i cili paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse ka zotësinë procedurale, a e përfaqëson palën pa zotësi procedurale përfaqësuesi i saj ligjor dhe a ka përfaqësuesi ligjor autorizim të veçantë kur ai nevoitet. Në të kundërtën, gjykata do të kërkoj nga paditësi që të bëj ndryshimet e nevojshme në padi, do kërkoj që organi i kujdestarisë të përcaktoj kujdestar personit pa zotësi procedurale ose do të ndërmerr dhe masa të tjera që procedura të mund të

---

<sup>62</sup> Po aty, f. 315.



vazhdohet, përkatësisht, që pala pa zotësi procedurale të përfaqësohet në mënyrë të drejtë. Deri në shmangien e këtyre mangësive, mund të ndërmerren vetëm ato veprime shtyerja e të cilave mund të prodhonte pasoja të dëmshme për palën. Nëse mungesat nuk do të mund të evitoheshin, gjykata me aktvendim do të anuloi veprimet e ndërmarra në procedurë dhe do të hedh poshtë padinë, nëse mangësitë janë të asaj natyre që pamundësojnë zhvillimin e mëtejshëm të procedurës.

Nëse procedura e rregulltë për përcatimin e përfaqësuesit ligjor të të paditurit do të zgjaste shumë, ashtu që në ndërkohë do të mund të shfaqeshin pasoja të dëmshme, gjykata do ti përcaktoj të paditurit të tillë përfaqësues të përkohshëm, veçanërisht në rastet kur:

- i padituri nuk ka zotësi procedurale, e as përfaqësues ligjor;
- nëse ekzistojnë interesa të kundërta midis të paditurit dhe përfaqësuesit ligjor të tij;
- nëse që të dyja palët kanë përfaqësues ligjor të njejtë;
- nëse vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, ndërsa nuk ka përfaqësues me prokurë;
- nëse i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk kanë përfaqësues me prokurë në Republikën e Kosovës, ndërsa ndodhen jashtë shtetit ashtu që dërgesa nuk ka mundur të kryhet.

Për përcaktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, gjykata pa shtyerje do të lajmëroj organin e kujdestarisë, si dhe vetë palët kur kjo është e mundshme. Do të publikohet shpallje në Gazetën zyrtare si dhe në tabelën gjyqësore në gjykatë. Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe obligimet në procedurën për të cilën është përcaktuar njejtë si përfaqësuesi ligjor. Përfaqësues të përkohshëm gjykata mundet ti përcaktoj edhe personit juridik.

Përfaqësuesi i përkohshëm kryen të drejtat dhe obligimet derisa i padituri ose përfaqësuesi i tij me prokurë nuk paraqiten para gjykatës, përkatësisht, derisa organi i kujdestarisë nuk e lajmëron gjykatën se ka përcaktuar kujdestar.

Shtetasi i huaj i cili nuk ka zotësinë procedurale sipas ligjit të shtetit shtetas i të cilit është, por ka zotësinë procedurale sipas ligjit të R. së Kosovës, mundet vetë të ndërmerri veprimet në procedurë.

Pozita e palës në procedurë humbet me vdekjen e personit fizik, përkatësisht humjen e cilësisë së personit juridik.

Palët janë të autorizuar që të emërojnë përfaqësues më prokurë. Përfaqësuesi me prokurë është person i cili në emër dhe për llogari të palës, në kufijtë e autorizimeve të fituar,

ndërmerr veprime procedurale sikur ti kishte ndërmarrë vetë pala. Përfaqësues me prokurë mund të emëroj vetëm pala e cila ka zotësinë procedurale, andaj mundet që të gjitha veprimet ti ndërmerr dhe vetë në procedurë, por vendosë që një gjë të tillë për llogari të saj ti ndërmerr personi tjetër. Pala të cilën e përfaqëson përfaqësuesi me prokurë mundet në çdo kohë të paraqitet para gjykatës dhe të jep deklarata krahas përfaqësuesit me prokurë. Gjykata gjithashtu mund të thërras palën e cila ka përfaqësues me prokurë që para gjykatës personalisht të deklarohet lidhur me faktet të cilat duhet vërtetuar në procedurë.

Palën si përfaqësues më prokurë mund ta përfaqësoj vetëm avokati, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Krahas avokatit, palën mund ta përfaqësoj edhe personi i cili me palën është në marrëdhënie pune, nëse ka zotësinë e plotë të veprimit, si dhe personat që janë në gjini gjaku në vijë të drejtë, motra ose vëllau, bashkëshorti, nëse kanë zotësinë e plotë të veprimit dhe nuk merren me përfaqësim të rejshtëm.

### **3. Veprimet procedurale**

Procedura kontestimore është veprimtari e rregulluar me ligj, përkatësisht proces i cili inicohet, zhvillohet dhe përfundon përmes aktivitetit të subjekteve procedurale – gjykatës, palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, të rregulluara me të drejtën procedurale. Pra, tërësia e veprimeve procedurale të ndërmarra nga subjektet procedurale në procedurë përbën procedurën kontestimore.

Veprim procedural është çdo sjellje e subjekteve procedurale, e cila drejtëpërsëdrejti në procedurë kontestimore prodhon efekte juridiko-procedurale të përcaktuar me ligj.<sup>63</sup> Subjektet procedurale ndërmarrin veprime procedurale në procedurë nën kushte të caktuara, sipas rradhitjes së caktuar, në formë të caktuar dhe me qëllim që të prodhojnë efekte të caktuara juridiko procedurale të përcaktuara me të drejtën procedurale.

Varësisht nga kritere të ndryshme që merren për bazë, dallojmë më tepër ndarje të veprimeve procedurale. Për objektin e interesit tonë, me rëndësi është ndarja e veprimeve procedurale në veprime procedurale të gjykatës dhe veprime procedurale të palëve dhe subjekteve tjera në procedurë. Kjo ndarje bëhet duke pasur parasysh subjektet që i ndërmarrin veprimet procedurale në procedurën kontestimore.

Veprimet procedurale të palëve janë sjelljet, veprimet e palëve në procedurë, forma, mënyra dhe efektet procedurale të të cilave janë të parapara me normat e të drejtës procedurale.

---

<sup>63</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 221.

Palët mund të ndërmarrin veprimeve procedurale relevante në procedurë, nëse kanë zotësinë për të qenë palë dhe zotësinë procedurale. Palët janë të autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, pra ato nuk janë të obliguara, përkatësisht nga vullneti i tyre varet nëse do të ndërmarrin ose jo veprimin e caktuar procedural në procedurën konkrete kontestimore. Përmbajtjen dhe formën e veprimeve procedurale të palëve e përcakton vetë ligji, ndërsa vetë veprimet procedurale të palëve janë të orientuara drejt gjykatës.

Nga ana tjetër, veprimet procedurale të gjykatës janë ato veprime të cilat i ndërmerr vetë gjykata në procedurë kontestimore, në mënyrë, formë, me përmbajtje dhe me efekte procedurale të paraparë me të dejtën procedurale. Veprimet procedurale që i ndërmerr gjykata në procedurë kontestimore përbëhen nga: sjellja e vendimeve, drejtimi i procedurës, pranimi i parashtrësive të palëve, mbajtja e procesverbaleve dhe dërgimi i shkresave. Në vijim do të bëhet fjalë për secilin nga këto veprime procedurale në mënyrë të veçantë.

#### **4.1. Vendimet gjyqësore dhe drejtimi i procedurës**

Veprimi më i rëndësishëm procedural të cilin e ndërmerr gjykata në procedurë kontestimore është sjellja e vendimeve gjyqësore. Vendimi gjyqësor është akt juridik i veçantë nëpërmjet të cilit gjykata në mënyrë autoritative dhe të padyshimtë e shpreh qëndrimin e vet lidhur me çështjet që shtrohen gjatë zhvillimit të procedurës.<sup>64</sup>

Vendimet gjyqësore varësisht nga kriteri që merret për bazë, mund të ndahen në më tepër lloje:

- varësisht nga natyra e çështjes që shtrohet gjatë zhvillimit të procedurës, vendimet gjyqësore mund të jenë:
  - Vendime juridiko procedurale – gjatë sjelljes së të cilave zbatohen rregullat juridiko-procedurale dhe vendoset lidhur për çështjet e natyrës juridiko-procedurale;
  - Vendime juridiko-materiale (vendime meritore) – gjatë sjelljes së të cilave zbatohen rregullat juridiko-materiale dhe vendoset në mënyrë meritore për çështjen e natyrës juridiko-materiale. Vendimet meritore, varësisht nga natyra e dipozitivit, mund të jenë konstitutive, deklarative dhe kondemnatore.
    - vendimet gjyqësore mund të jenë:
      - përgatitore – që kanë për qëllim që të përgatisin sjelljen e vendimit për çështjen kryesore lidhur me të cilën zhvillohet procedura, dhe

---

<sup>64</sup> Po aty, f. 227.

- përfundimtare – me të cilat përfundon procedura kontestimore e shkallës së caktuar ose në përgjithësi.

Vendimet gjyqësore në procedurë kontestimore sillen në formë të aktgjykimeve dhe aktvendimeve. Me aktgjykim gjykata vendos në mënyrë meritore për bazën ose mungesën e bazës së kërkesës për dhënien e mbrojtjes juridike. Ndërkaq, kur nuk vendos me aktgjykim, gjykata në procedurë kontestimore vendos me aktvendim, dhe atë, sipas rregullës, për çështjet e natyrës juridiko-procedurale.

Sjellja e vendimeve gjyqësore paraqet proces të ndërlikuar, gjatë të cilit gjykata ndërmërr një varg veprimesh procedurale, duke filluar nga grumbullimi i materialit procedural të nevojshëm, përmes vërtetimit të gjendjes faktike e deri tek vendosja e saj nën normën juridike përkatëse. Nga ana tjetër, me LPK janë paraparë rregulla për sjelljen e vendimeve nga këshilli gjyqësor. Kështu, sipas LPK, këshilli i sjell vendimet pas mbajtjes paraparake të këshillimit dhe pastaj votimit. Gjatë këshillimit janë prezent të gjithë anëtarët e këshillit dhe ato debatojnë lidhur me të gjitha çështjet relevante nga të cilat varet sjellja e vendimit. Pas kësaj, pason votimi, gjatë të cilit anëtarët e këshillit votojnë “për” ose “kundër” (asnjëherë të përmbajtur) propozimit për vendimin e caktuar. Vendimi gjyqësor sillet me shumicë votash.

Që të mundet të sigurohet zhvillimi i përshtatshëm i procedurës kontestimore, gjykata është e autorizuar që të ndërmerr një varg veprimesh procedurale në procedurë, të cilat me një term të përbashkët njihen si drejtim me procedurën.

Në teorinë procedurale bëhet dallimi midis drejtimit të procedurës në kuptimin material dhe formal.<sup>65</sup> Drejtimi i procedurës në kuptimin material paraqet tërësi të veprimeve procedurale të gjykatës të orientuara kah grumbullimi, selektimi dhe shqyrtimi i materialit të nevojshëm procedural, si bazë për sjelljen e vendimit lidhur me çështjen kontestuese.<sup>66</sup> Ndërkaq, drejtimi i procedurës në kuptimin formal paraqet tërësi të veprimeve procedurale të gjykatës të cilat kanë për qëllim sigurimin e përshtatshëm dhe të rregullt të rrjedhës së procedurës dhe zhvillimit të saj kohor.<sup>67</sup>

Veprimet lidhur me drejtimin me procedurën, gjykata i ndërmerr sipas detyrës zyrtare, dhe për të vendosën me aktvendim të cilin dhe e zbaton. Gjkata nuk është e lidhur për aktvendimet për drejtimin e procedurës.

<sup>65</sup> Shih: Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 354.

<sup>66</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 230.

<sup>67</sup> Gjykata drejton me procedurën ashtu që ndërmerr veprime të shumta e të ndryshme në procedurë dhe atë: përcaktimin dhe vazhdimin e afatave, caktimin dhe anulimin e seancave, mbajtja e rregullit në seancë, vendosja lidhur me mënyrën e dërgimit të shkresave, bashkimi dhe ndarja e procedurave kontestimore, vendosja për ekzaminimin e provave, zgjedhja e çështjeve incidentale, etj.

## 4.2. Parashtrësas dhe procesverbalet

Parashtrësas paraqesin formën me shkrim të veprimeve procedurale të ndërmarra nga palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë. Ashtu, padia, përgjigja në padi, mjetet juridike si dhe deklaratat tjera, propozimet dhe njoftimet të cilat jepen jashtë seancës parashtrohen në formë me shkrim, pra si parashtrësas.<sup>68</sup>

Varësisht nga përmbajtja dhe qëllimi për të cilin parashtrohen, parashtrësas ndahen në përgatitore, përfundimtare (dispozitive) ose të zakonshme.

Në parashtrësas përgatitore paraqiten faktet mbi të cilat bazohet kërkesa dhe propozohen prova, në masën që është e nevojshme për orientimin dhe përgatitjen e gjykatës dhe palës kundërshtarë për shqyrtimin gojor të kërkesës së paraqitur.

Parashtrësas përfundimtare përbëjnë thelbin definitiv për sjelljen e vendimit, pra, ato përmbajnë gjithë atë që është e nevojshme për vendosje nga ana e gjykatës pa mbajtjen e shqyrtimit gojor.

Me parashtrësas të zakonshme, pala njofton gjykatën lidhur me faktet të cilat mund të jenë relevante për zhvillimin e procedurës.

Lloj të veçantë të veprimeve procedurale të gjykatës, paraqet mbajtja e procesverbaleve në seancë, përkatësisht, regjistrimi i veprimeve procedurale në seancë të procedurës kontestimore.

Procesverbalet janë dokumente publike të cilat i përpilon gjykata lidhur me veprimet të cilat i ndërmarrin palët dhe përfaqësuesit tjerë në procedurë para gjykatës, gojarisht në seancë ose jashtë seancës.<sup>69</sup> Qëllimi kryesor i mbajtjes së procesverbaleve ka të bëjë me natyrën provuese të tyre, përkatësisht, procesverbalet paraqesin prova të përmbajtjes së veprimeve procedurale.

Për deklaratat dhe njoftimet më pak të rëndësishme nuk mbahet procesverbal, por vetëm vendoset shënim zyrtar në shkresë.

Në procesverbalin për shqyrtim kryesor shënohet veçanërisht: se a ka qenë shqyrtimi publik ose jo, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që i kanë propozuar, provat që janë ekzaminuar, duke theksuar përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe ekspertëve, si dhe vendimeve të gjykatës të sjellura në seancë.

Procesverballi duhet të mbahet në rregull, ashtu që në të nuk duhet asgjë të fshihet, të shtohet ose të ndryshohet. Vendet e shlyera duhet të mbeten të lexueshme. Procesverbalin e nënshkruan kryetari i këshillit, procesmbajtësi, palët, përkatësisht përfaqësuesit e tyre ligjorë

---

<sup>68</sup> Neni 106, paragr. 1 i LPK.

<sup>69</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 364.

ose përfaqësuesit me prokurë dhe përkthyesi. Dëshmitari dhe eksperti e nënshkruajnë deklaratën e tyre në procesverbal atëherë kur ata degjohen para gjyqtarit të lutur ose kryetarit të këshillit.

Nëse ndonjëra nga palët, përfaqësuesi i saj ligjor ose me prokurë, dëshmitari ose eksperti largohet para se të nënshkruaj procesverbalin ose nuk dëshiron që të nënshkruhet, kjo do të shënohet në procesverbal dhe do të theksohet arsyeja për këtë. Për këshillim dhe votim përpilohet procesverbal i veçantë.

### **4.3. Dërgimi i shkresave**

Dërgimi është aktivitet i caktuar i paraparë me ligj i organeve dhe personave kompetent i drejtuar nga ajo që adresantëve tu jep mundësi të njoftohen me përmbajtjen e shkresave të cilat ju dërgohen.<sup>70</sup> Pra, dërgimi i shkresave është veprim procedural qëllimi i të cilit është që shkresa ti dërgohet personit të cilit i është adresuar. Kështu me LPK është paraparë që dërgimi i shkresave mund të bëhet: nëpërmjet postës ose dërguesit gjyqësor, nëpërmjet organit kompetent administrativ, nëpërmjet noterit ose drejtpërsëdrejti në gjykatë.

Dërgimi i shkresave bëhet çdo ditë pune, dhe atë nga 7h deri 20h, në banesën ose vendin e punës së personit të cilit shkresa duhet ti dërgohet ose në gjykatë nëse personi takohet aty. Dërgesa mund të bëhet edhe në kohë dhe vend tjetër, nëse me këtë gjë pajtohet personi të cilit shkresa i dërgohet.

Varësisht nga lloji i shkresës që dërgohet, si edhe nga fakti se shkresa që dërgohet a ka mundësi ti dorëzohet edhe personit tjetër, dërgimi mund të jetë: dërgim i zakonshëm, dërgim personal dhe dërgim me shpallje.<sup>71</sup>

Dëftesa e dërgimit paraqet dokument publik i cili shërben si provë për dërgimin e kryer. Dëftesën për dërgimin e kryer e nënshkruajnë pranuesi dhe dërguesi.

Nëse me mosdërgim ndonjëra nga palët i është pamundësuar që të shqyrtoj para gjykatës, kjo paraqet shkelje esenciale absolute të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të së cilës mund të paraqiten dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

### **4.4. Afatet dhe seancat**

Afati është periudhë e caktuar kohore brenda së cilës mund të ndërmerret ndonjë veprim procedural, përkatësisht para skadimit të të cilit nuk mund të ndërmerret ai.<sup>72</sup> Afatet

<sup>70</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 367.

<sup>71</sup> Per dërgim të zakonshëm behet fjale atehere kur pervec personit të cilit duhet ti dorëzohet shkresa, nese ai nuk gjendet ne vendin ku behet dorezimi, shkresa mund ti dorezohet edhe personit tjetër i cili takohet ne kete vend. Dergimi personal parashih qe shkresat ti dorezohen personalisht personit te cilit i jane adresur. Dergim me shpallje kemi atehere kur dorezimi konsiderohet i kryer atehere kur shkresa eshte shpallur ne tabelen e shpalljeve te gjykates, me kalimin e afatit te caktuar.

mund ti ndajmë në: afate ligjore dhe gjyqësore; afate të vazhdueshme dhe të pavazhdueshme; afate objektive dhe subjektive.

Afateve ligjore kohëzgjatja u është përcaktuar me ligj, ashtu që ato nuk mund të ndryshohen me vendimin e gjykatës. Ndërkaq, kohëzgjatjen e afateve gjyqësore, në bazë të autorizimit ligjor, e përcakton gjykata sipas mendimit të vet në rastin konkret, në mënyrë që ndonjëherë është e lidhur me kufijtë maksimal ose minimal të kohëzgjatjes së tyre.

Afatet ligjore janë afate të pavazhdueshme, ndërsa afatet gjyqësore janë afate të vazhdueshme, ngase për zgjatjen e tyre vendos gjykata, por vetëm me kërkesë të palëve.

Afate subjektive janë ato afate, fillimi të cilëve varet nga marrja në dijeni e personit për ngjarjen që është relevante për llogaritjen e afatit. Ndërkaq, afatet objektive llogariten nga shfaqja e faktit relevant, pavarësisht nga dijenia e personave të autorizuar për atë fakt.

Afatet llogariten në ditë, muaj dhe vite.<sup>73</sup>

Me ndërprerjen e procedurës ndalen së rrjedhuri të gjitha afatet ligjore dhe gjyqësore, përderisa tek ndalimi i procedurës vetëm afatet gjyqësore. Afatet që nuk rrjedhin, me vazhdimin e procedurës fillojnë të rrjedhin prej fillimi.

Seanca është periudhë e caktuar kohore (moment) kur gjykata ndërmerr ndonjë veprim procedural me pjesëmarrjen e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë.<sup>74</sup> Seancën e cakton gjykata kur kjo është e paraparë me ligj ose kur këtë e kërkojnë nevojat e procedurës. Kundër aktvendimit për caktimin e seancës nuk është e lejuar ankesa.

Gjykata me kohë do të thërret në seancë palët dhe personat e tjerë prezenca e të cilëve konsiderohet e nevojshme. Përkrah thirrjes, palës do ti dërgohet parashtrësia që përbën shkas për caktimin e seancës, në thirrje do të shënohet vendi, hapësira dhe koha e mbajtjes së seancës. Gjithashtu, gjykata në thirrje veçanërisht do të paralajmëroj për pasojat ligjore të mungesës nga seanca.

Seancat sipas rregullës mbahen në ndërtesën e gjyqit. Mirëpo, gjykata mund të vendos që seanca të mbahet jashtë ndërtesës së gjyqit kur do të konstatoj se kjo është e nevojshme ose se në atë mënyrë do të mund të kursehet në kohë, apo në shpenzimet e procedurës.

#### **4.5. Mosndërmarrja e veprimeve procedurale**

---

<sup>72</sup> Po aty, f.379.

<sup>73</sup> Nëse afati është përcaktuar me ditë, në atë afat nuk llogaritet dita në të cilin bie ngjarja nga e cila duhet të rrjedh kohëzgjatja e afatit, por dita e parë e ardhshme. Afatet e përcaktuara në muaj, përkatësisht vite, mbarojnë me kalimin e asaj dite të muajit të fundit, respektivisht, vitit i cili sipas numrit të vet i përgjigjet ditës së fillimit të afatit. Nëse dita e fundit e afatit bie në festë shtetërore, ose të diel, ose ndonjë ditë tjetër kur gjykata nuk punon, afati do të mbaroj ditën e parë të ardhshme të punës.

<sup>74</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 383.

Më lartë përmendëm që ndërmarrja e veprimeve procedurale të palëve paraqet autorizim për palën, e jo obligim. Pra, pala është ajo që vendos nëse do të ndërmerr ose jo veprimin e caktuar procedural. Megjithatë, nga ana tjetër, ligji përcakton rradhitjen e ndërmarrjes së veprimeve procedurale në procedurë, duke paraparë për ndërmarrjen e veprimeve të caktuara afat të caktuar të ndërmarrjes, seancën, stadiumin ose shkallën deri kur mund të ndërmerren veprimet e caktuara. Andaj, nëse pala, edhe pse e autorizuar për ndërmarrjen e veprimit, lëshon që të njejtin ta ndërmerr në afatin, seancën apo fazën e caktuar të zhvillimit të procedurës, kur kjo është përcaktuar me ligj, humb të drejtën e ndërmarrjes së veprimit të tillë më vonë, pra vetë i bartë pasojat e qëndrimit të vet pasiv në procedurë.

Si pasojë e përgjithshme dhe më e rëndësishme juridiko procedurale e mosndërmarrjes është prekludimi, që paraqet humbjen e të drejtës së palës për të ndërmarrë veprimin e caktuar procedural për shkak të mosndërmarrjes në afatin, seancën ose stadiumin e caktuar me ligj për ndërmarrjen e atij veprimi.

Përveç prekludimit, rregullat procedurale parashohin edhe pasoja tjera nga mosndërmarrja, të cilat shpesh shprehen si fiksione ose prezumime lidhur me vullnetin e palës së shprehur me rastin e mosndërmarrjes.<sup>75</sup>

#### **4. Të provuarit dhe provat**

Të provuarit paraqet një varg veprimesh procedurale të subjekteve procedurale të cilat përbëhen nga të propozuarit, zgjedhja, ekzaminimi dhe vlerësimi i mjeteve provuese me qëllim të ekzaminimit të vërtetësisë së pretendimeve të palëve procedurale dhe supozimeve të gjykatës mbi faktet relevante për zbatimin e së drejtës.<sup>76</sup>

Mjeti provues ose prova është e gjithë ajo që në procedurë i jep bazë gjykatës që të konsideroj se diçka është provuar, përkatësisht jep bazë për vërtetësinë ose pavërtetësinë e një pretendimi faktik.

Objekt i të provuarit janë pretendimet e caktuara të palëve dhe tezat e gjykatës mbi ekzistimin ose mosekzistimin e fakteve nga ekzistimi ose mosekzistimi i të cilave varet zbatimi i rregullës juridike.<sup>77</sup> Të provuarit përfshin vetëm pretendimet mbi faktet juridikisht relevante për sjelljen e vendimit. Në rradhë të parë, pra, provohen vetëm faktet juridikisht relevante – faktet nga të cilat varet krijimi, ndryshimi ose shuarja e marrëdhënies juridik. Gjithashtu, mund të provohen edhe indicjet - faktet të cilat nuk janë drejtëpërdrejtë të

---

<sup>75</sup> Psh. nëse paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore në afat të caktuar ligjor, pas skadimit të atij afati do të konsiderohet se padia është tërhequr; nëse parashtrësja i është kthyer parashtruesit për përmirësim ose plotësim dhe e njëjta nuk kthehet në gjykatë në afatin e caktuar, do të konsiderohet se e njëjta është tërhequr, etj

<sup>76</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 480.

<sup>77</sup> Po aty, f. 482.



rëndësishme, por mundësojnë informimin e gjykatës mbi ekzistimin e drejtëpërdrejtë të fakteve të rëndësishme.

Në parim, provohen vetëm faktet kontestuese. Pra, gjykata nuk është e autorizuar të provoj faktet jokontestuese. Gjithashtu, nuk duhet të provohen as faktet e pranuar - të cilat pala i ka pranuar para gjykatës gjatë procedurës kontestimore. Nuk duhet të provohen as faktet ekzistimin e të cilave e supozon ligji si dhe faktet e ditura botërisht (faktet notore).

Të gjitha faktet juridikisht relevante duhet të provohen, dhe me këtë rast barra e të provuarit bie mbi palët. Palët janë të obliguara që në procedurë të paraqesin të gjitha pretendimet mbi faktet mbi të cilat mbështesin kërkesat dhe të propozojnë provat me të cilat ato fakte mund të provohen. Nëse gjykata nuk mundet me siguri të vërtetoj ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të konkludoj me zbatimin e rregullave mbi barrën e të provuarit.

Secila nga palët është e obliguar të paraqes faktet dhe të propozoj prova mbi të cilat mbështet kërkesën e vet ose me të cilat mohon pretendimet dhe provat e palës kundërshtare. Gjatë procedurës, kur gjykata e konsideron të nevojshme, mund të paralajmëroj palët në obligimin e tyre.

Palët propozojnë provat, mirëpo gjykata vendos me aktvendim se cilat prova do të ekzaminohen, dhe me këtë rast gjykata nuk është e lidhur për vendimin mbi ekzaminimin e provave. Se sipas cilës rradhe do të ekzaminoj provat vendos gjykata.

Gjykata është e autorizuar që të vërtetoj edhe ato fakte si dhe të ekzaminoj edhe ato prova të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse dyshon se palët shkojnë nga ajo që të disponojnë me kërkesa me të cilat nuk mund të disponojnë.

Në mesin e mjeteve provuese ligji numëron: shikimin, dokumentet, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimin e palëve.

Shikimi ndërmerret atëherë kur për vërtetimin e ndonjë fakti ose sqarimin e ndonjë rrethane është i nevojshme vështrimi i drejtëpërdrejtë nga ana e gjykatës. Shikimi mund të kryhet edhe me pjesëmarrje të ekspertit, nëse gjykata nuk posedon dije e nevojshme profesionale.

Shikimin, sipas rregullës, e bën gjykata kontestimore (ekzaminimi i drejtëpërdrejtë i provave), por atë mund ta bëj edhe gjykata e lutur (ekzamini i tërthortë i provave).

Dokument është çdo send në të cilin është shënuar me shenja të shkruara ndonjë mendim. Dokumenti është mjet provues real i nxjerrë në formën e caktuar me të cilin vërtetohet ekzistimi ose mosekzistimi i fakteve të caktuara.

Dëshmitar është personi i thirrur para gjykatës që të jep deklaratë lidhur me vërejtjet e tija të kaluara të cilat do të mund të ishin të rëndësishme për përcaktimin e vërtetësisë së

pretendimeve të cilat janë objekt i të provuarit.<sup>78</sup> Si dëshmitarë mund të ndëgjoen vetëm personat të cilët janë të aftë të japin informacion për faktet të cilat provohen. Dëshmitarë mund të jetë çdo person fizik, përveç palëve në procedurë dhe përfaqësuesve të tyre ligjor, si dhe gjykatësit në rastin konkret, të cilët, po që se do të dëgjoeshin si dëshmitarë do duhej përjashtuar nga gjykimi në atë rast.

Secili person i cili thirret si dëshmitar është i obliguar që ti përgjigjet thirrjes, e nëse nuk është përcaktuar ndryshe, është i obliguar edhe të dëshmoj. Me LPK janë paraparë parakushtet me plotësimin e të cilave, dëshmitari nuk është i obliguar që të dëshmoj në rastin konkret.

Ekspert është personi i ndryshëm nga palët dhe gjykata, i thirrur para gjykatës që duke shfrytëzuar dijeninë e tij profesionale, me të cilën gjykata nuk disponon, të paraqesë vëzhgimet e tanishme, përkatësisht, konstatimin dhe mendimin lidhur me faktet të cilat do mund të ishin të rëndësishme për vërtetimin e vërtetësisë së pretendimeve të cilat janë objekt i të provuarit.

Ekspert mund të jetë personi fizik i cili mund të jetë dhe dëshmitar, nëse disponon me dijeni profesionale të nevojshme për zgjedhjen e fakteve të caktuara. Ekspertizën e kryejnë ekspertët e përcaktuar nga gjykata kontestimore.

Gjykata mund të vendos që të ekzaminoj provën me dëgjimin e palëve në rastet kur nuk ka prova të tjera ose kur përpos ekzaminimit të provave tjera konstaton se kjo është e nevojshme për vërtetimin e fakteve relevante. Në këtë rast, gjykata i dëgjon që të dyja palët, natyrisht, nëse pala nuk e refuzon dhënien e deklaratës ose pa shkak të arsyeshëm nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës. Për palën pa zotësi procedurale dëgjoet përfaqësuesi i saj ligjor, ndërsa gjykata mundet që në vend ose krahas tij të dëgjoj edhe vetë palën, nëse kjo është e mundur.

Për personin juridik do të dëgjoet personi i cili sipas ligjit ose statutit është përcaktuar që ta përfaqësoj.

Asnjëra nga palët nuk është e obliguar që kundër vetes të shpalos rrethana të cilat do të mund ti shkaktonin dëm. Prandaj nuk mund të ndërmerren masa të dhunshme kundër palës e cila nuk i është përgjigjur thirrjes së gjykatës për tu dëgjuar, e as që pala mund të detyrohet që të jap deklaratë. Por, megjithatë, gjykata do të vlerësoj se çfarë rëndësie paraqet mosarrdhja e palës në dëgjim ose refuzimi i saj që të jep deklaratë.

---

<sup>78</sup> Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 518.

## 5. Shpenzimet e procedurës kontestimore

Shpenzimet e procedurës kontestimore ose shpenzimet procedurale paraqesin shpenzimet e shkaktuara gjatë ose për shkak të procedurës kontestimore. Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimin për punën e avokatit dhe personave tjerë të cilëve ligji u njeh të drejtën në shpërblim.<sup>79</sup>

Secila nga palët, paraprakisht i paguan vetë shpenzimet që i ka shkaktuar me veprimin e vet.<sup>80</sup> Pagimi paraprak i shpenzimeve të procedurës do të thotë pagim i shpenzimeve në momentin kur ndërmerret veprimi i caktuar procedural.<sup>81</sup>

Përveç obligimit të pagimit paraprak të shpenzimeve procedurale, me LPK është rregulluar edhe çështja e pagimit përfundimtar të shpenzimeve të procedurës. Kështu, lidhur me pagimin përfundimtar të shpenzimeve të procedurës dallojmë dy parime themelore, dhe atë:

- Parimin e kauzës – në bazë të të cilit pagimi përfundimtar i shpenzimeve procedurale varet nga sukcesi i palëve në procedurë, përkatësisht, pala e cila humb kontestin është e obliguar që palës kundërshtare dhe ndërhyrësit të saj, tua kompenzoj shpenzimet e procedurës.<sup>82</sup>
- Parimin e fajit – në bazë të të cilit, pavarësisht nga sukcesi i palëve në procedurë, pala obligohet që kundërshtarit ti kompenzoj shpenzimet që i ka shkaktuar me fajin e vet ose të rastit që i ka ndodhur asaj.<sup>83</sup>

Nëse procedura ka përfunduar me pajtim gjyqësor, secila nga palët i paguan shpenzimet e veta, përveç nëse me pajtim nuk është kontraktuar diçka tjetër.<sup>84</sup>

Bashkëndërgjyqësit i paguajnë shpenzimet procedurale në pjesë të barabarta.<sup>85</sup>

Për kompenzimin e shpenzimeve të procedurës, vendos gjykata vetëm sipas kërkesës së palëve, të cilën ato duhet ta paraqesin më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit i cili i paraprin vendosjes lidhur me shpenzimet, pa mbajtur shqyrtim. Për kërkesën për kompenzimin e shpenzimeve procedurale gjykata do të vendos në aktgjykimin (dhe me atë

<sup>79</sup> Neni 151. paragr. 1 dhe 2 i LPK.

<sup>80</sup> Neni 152. i LPK. LPK, përjashtimisht, njeh edhe institucionin e lirit nga pagimi paraprak i shpenzimeve procedurale, i cili mund të jetë i pjesërishëm dhe i plotë, varësisht nëse gjykata liron palën tërësisht nga pagimi paraprak i shpenzimeve procedurale apo vetëm pjesërisht, nëse me pagimin e tillë do të dëmtohej mbajtja e palës dhe anëtarëve të familjes së saj. Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin pranohet propozimi i palës për lirim nga pagimi i shpenzimeve paraprake nuk është e lejuar ankesa.

<sup>81</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 309. Kështu psh. paditësi paraprakisht i paguan shpenzimet për parashtrimin e padisë, ndërsa i padituri, shpenzimet për përgjigjen në padi, kundërpadi, etj.

<sup>82</sup> Neni 154. paragr. 1 i LPK.

<sup>83</sup> Neni 156. paragr. 1 i LPK. Me LPK rregullohen edhe disa raste të vecanta të obligimit të pagimit të shpenzimeve sipas parimit të fajti, dhe atë: mosdhënia e shkakut për padi, tërheqja e padisë dhe heqja dorë nga mjeti juridik (neni 157. dhe 158. i LPK).

<sup>84</sup> Neni 159. i LPK.

<sup>85</sup> Neni 161. paragr. 1 i LPK.

rast vendimi për kompenzimin e shpenzimeve ka karakter të aktvendimit) ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura para asaj gjykate.<sup>86</sup>

## A. Procedura para gjykatës së shkallës së parë

### 1. Inicimi i procedurës kontestimore

Procedura kontestimore inicohet me padi.<sup>87</sup> Padia paraqet veprim procedural me të cilin inicohet procedura kontestimore për mbrojtjen e ndonjë të drejte subjektive civile të shkelur ose të rrezikuar. Padinë e paraqet personi, paditësi, i cili pretendon se e drejta e tij subjektive civile është shkelur ose rrezikuar, dhe me këtë rast kërkon nga gjykata mbrojtje juridike për atë të drejtë. Se a do të paraqesë padinë ose jo, varet nga dispozicioni i paditësit. Nëse paditësi paraqet padinë, me këtë inicon procedurën kontestimore.

Nocioni padi, në teorinë procedurale përcaktohet në kuptimin material dhe në kuptimin formal (procedural).<sup>88</sup> Në kuptimin material, padia nënkupton të drejtë (kërkesë) për mbrojtjen e të drejtave subjektive civile. Në kuptimin formal me nocionin padi nënkuptohet parashtresa e shkruar, në të cilën paditësi paraqet kërkesën për mbrojtje juridike të së drejtës së tij të shkelur ose rrezikuar. Përveç se me parashtresë, padia mund të paraqitet edhe me gojë në procesverbal në gjykatë, megjithatë në të shumtën e rasteve padia paraqitet si parashtresë.

Padia paraqet veprimin e parë procedural për iniciimin e procedurës kontestimore. Padinë e paraqet pala, paditësi, dhe vetëm nga dispozicioni i palës varet nëse do inicohet procedura kontestimore, që do të thotë se padia paraqitet si prezumim procedural jo vetëm për iniciimin e procedurës por edhe për zhvillimin dhe përfundimin meritator të procedurës kontestimore.

Padia, siç përmendëm më lartë, mund të ndërmerret me shkrim, si parashtresë ose me gojë në procesverbal në gjykatë. Me LPK është paraparë përmbajtja e padisë si parashtresë dhe me atë rast dallojmë përmbajtjen e detyrueshme dhe fakultative të padisë. Përmbajtjen e detyrueshme të padisë e përbëjnë elementet e detyrueshme të saj, dhe atë: kërkesëpadia (petitum), baza faktike e padisë (causa remota actionis), provat dhe të dhënat që duhet ti ketë çdo parashtresë. Përmbajtjen fakultative të padisë e përbëjnë elementet të cilat paditësi nuk është i detyrueshëm ti theksoj në padi, por një gjë të tillë mund ta bëj vetëm nëse dëshiron, si psh. baza juridike e kërkesëpadiës, kërkesa dytësore, etj.

<sup>86</sup> Kundër vendimit mbi shpenzimet e procedurës, pala mund të paraqesë ankesë.

<sup>87</sup> Neni 185. i LPK-së.

<sup>88</sup> Shih Triva, S., Dika, M.: "Graxhansko parnično procesno pravo", Zagreb, 2004, f. 394.

Varësisht nga kriteri që merret për bazë, në të drejtën civile bëhet ndarja e padive në më tepër lloje. Megjithatë, në teorinë procedurale me rëndësi të veçantë është ndarja e padive sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike që kërkohet me padi, dhe me atë rast dallojmë padinë deklaratore, konstitutive dhe kondemnatore.

Padia deklaratore (padia për vërtetim) paraqet lloj të tillë të padisë përmes së cilës paditësi kërkon nga gjykata që ti ofroj mbrojtje juridike, ashtu që të vërtetohet ekzistimin, përkatësisht mos ekzistimin e ndonjë të drejtë ose marrëdhënie juridike, ose të vërtetohet vërtetësinë ose jovërtetësinë e ndonjë dokumenti.<sup>89</sup>

Padia konstitutive paraqet lloj të padisë ku paditësi kërkon nga gjykata që ti ofroj mbrojtje juridike, ashtu që me vendimin e vetë të bëjë ndryshime të caktuara në marrëdhëniet juridiko civile.

Padia kondemnatore paraqet lloj të tillë të padisë me të cilën paditësi kërkon nga gjykata që ti ofroj mbrojtje juridike, ashtu që me vendimin e vetë ta dënoj të paditurin në bërje, mosbërje ose pësim në dobi të paditësit.

## **2. Përgatitja e shqyrtimit kryesor**

Procedura para gjykatës së shkallës së parë përbëhet nga tre stadiume, dhe atë: përgatitja e shqyrtimit kryesor, shqyrtimi kryesor dhe sjellja e vendimit.

Stadiumin e parë të procedurës së shkallës së parë e përbën përgatitja e shqyrtimit kryesor. Ky stadium fillon me pranimin e padisë në gjykatë dhe ka për qëllim që çështjen e cila paraqet objekt të procedurës ta sjell në atë gjendje që do të mundësojë zhvillimin e shpejtë e të papenguar në stadiumin e shqyrtimit kryesor. Në këtë stadium, palët kanë mundësi të paraqesin të gjitha faktet dhe të propozojnë provat që kanë për qëllim të parashtrajnë në shqyrtimin kryesor.<sup>90</sup> Me përgatitjen e shqyrtimit kryesor udhëheq kryetari i këshillit ose gjyqtari individual, varësisht se në kompetencë të kujt bie çështja juridike konkrete. Në këtë stadium, gjykata sipas rregullit, nuk vendos për meritumin e kontestit, por përjashtimisht ajo mund të sjell edhe disa vendime meritore.<sup>91</sup>

---

<sup>89</sup> Neni 187. paragrafi 1. i LPK-së.

<sup>90</sup> Neni 277. paragr. 4 i LPK-së.

<sup>91</sup> Kështu gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor kryetari i këshillit mund të sjell aktgjykim për shkak të mosdhënies së përgjigjes në padi, aktgjykim në bazë të pranimin, aktgjykim në bazë të heqjes dorë, aktgjykim për shkak të mungesës dhe aktgjykim pa mbajtjen e shqyrtimit, si dhe mund të pranojë në procesverbal edhe pajtimin e palëve.

Përgatitja e shqyrtimit kryesor në vete përfshin disa faza, dhe atë: shqyrtimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë deri tek i padituri, mbajtjen e seancës përgatitore, përfundimi i procedurës paraprake dhe caktimin e shqyrtimit kryesor.<sup>92</sup>

Shqyrtimi paraprak i padisë përbën fazën e parë dhe të detyrueshme të përgatitjes së shqyrtimit kryesor. Shqyrtimin paraprak të padisë e bën gjykata me qëllim që të vërtetojë se a janë përmbushur prezumimet procedurale nga të cilat varet lejimi i procedimit dhe vendosjes sipas padisë së parashtruar dhe të evitohet pengesat eventuale për këtë. Në këtë fazë, gjykata i zgjidh edhe çështjet incidentale me natyrë procedurale që mund të paraqiten në këtë fazë të procedurës.<sup>93</sup>

Dërgimi i padisë të paditurit për përgjigje paraqet fazën e dytë të përgatitjes së shqyrtimit kryesor. Në këtë fazë, të paditurit padia për përgjigje i dërgohet me thirrje, në të cilën ceket afati ligjor brenda të cilit duhet të jepet përgjigja në padi, si dhe paralajmërohet i padituri për pasojat e dëmshme në rast të mospërgjigjes në padi brenda këtij afati. Dërgimi i padisë të paditurit për përgjigje ka për qëllim që të përshejtoj, koncentroj e grumbulloj materialin procedural gjatë procedimit të kontestit konkret.

Seanca përgatitore është fazë fakultative e përgatitjes së shqyrtimit kryesor, mbajtja e të cilit varet nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e mbajtjes së të njejtës. Seanca përgatitore ka për qëllim që të lehtësoj zhvillimin e mëtutjeshëm të procedurës përmes evitimit të pengesave procedurale, nëse të njejtat nuk janë evituar në ndonjë fazë të mëhershme të përgatitjes së shqyrtimit kryesor, si dhe të bëjë definimin dhe kumulimin e materialit procedural.

Caktimi i seancës për shqyrtim kryesor është faza obligueshme dhe e fundit e përgatitjes së shqyrtimit kryesor. Në rast se procedura kontestimore nuk ka përfunduar në ndonjërin nga fazat e mëhershme të përgatitjes së shqyrtimit kryesor, atëherë gjykata, në aktvendimin për përfundimin e procedurës paraprake, do përcaktoj mbajtjen e seancës për shqyrtim kryesor.<sup>94</sup>

### **3. Shqyrtimi kryesor**

Shqyrtimi kryesor paraqet stadiumin qendror të procedurës kontestimore, në të cilën gjykata dhe palët ndërmarrin një varg veprimesh procedurale në një ose më tepër seanca, me qëllim të përfundimit të kontestit në mënyrë meritore. Përkatësisht, sipas rregullit, në procedurë kontestimore gjykata vendos për kërkesëpadinë në bazë të shqyrtimit gojor, të

<sup>92</sup> Neni 277. paragr. 2 i LPK-së.

<sup>93</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 354.

<sup>94</sup> Neni 293. paragr. 1 i LPK-së.

drejtëpërdrejtë dhe publik. Gjykata mund ta bazojë vendimin e vetë vetëm mbi ato fakte që kanë qenë objekt shqyrtimi në shqyrtimin kryesor. Pra, gjatë shqyrtimit kryesor grumbullohet materiali procedural dhe shqyrtohen të gjitha faktet relevante, ekzaminohen prova në bazë të të cilave më në fund gjykata vendos për bazën e kërkesëpadisë.

Gjatë shqyrtimit kryesor vjen në shprehje parimi i barabarësisë së palëve, kontradiktorialitetit, publicitetit si dhe parimi i shqyrtimit sa i përket grumbullimit të materialit procedural, e vetëm përjashtimisht edhe parimi i hetimit.

Në shqyrtim kryesor marrin pjesë palët dhe të gjithë personat e tjerë, të thirrur në shqyrtim kryesor. Shqyrtimin kryesor e hap gjyqtari individual, përkatësisht kryetari i këshillit dhe parashton objektin e shqyrtimit.<sup>95</sup> Gjyqtari individual, përkatësisht kryetari i këshillit udhëheq me shqyrtimin kryesor, u parashton pyetje palëve dhe ekzaminon provat. Gjyqtari individual, përkatësisht kryetari i këshillit është i obliguar që të kujdeset që objekti i kontestit të shqyrtohet në mënyrë gjithpërfshirëse, por gjatë kësaj të mos lejoj që procedura të zvarritet dhe sipas mundësisë ajo të përfundoj brenda një seance.<sup>96</sup>

Sipas rregullit, palët janë të obliguara që në padi dhe në përgjigjen në padi, e më së voni në seancën përgatitore, t'i paraqesin të gjitha faktet e nevojshme dhe të propozojnë të gjitha provat për vërtetimin e pretendimeve të veta, si dhe të deklarohen lidhur me pretendimet e palës kundërshtare. Pas kësaj prekludohet e drejta e tyre për paraqitjen e fakteve dhe provave të reja. Vetëm përjashtimisht lejohet paraqitja e fakteve e provave të reja në shqyrtim kryesor, nëse pala e bën të besueshme se pa fajin e vet nuk ka mundur që të njejtat ti paraqesë para përfundimit të procedurës paraprake. Gjykata, pas grumbullimit të materialit procedural, do të vendos se cilat prova do të ekzaminohen, e më pas shqyrtohen rezultatet nga ekzaminimi i provave.

Pas ekzaminimit të të gjitha provave dhe atëherë kur gjykata do të konsideroj se objekti është shqyrtuar mjaft që të mund të vendoset për çështjen juridike konkrete, gjyqtari individual, përkatësisht kryetari i këshillit njofton për përfundimin e shqyrtimit kryesor, pas së cilit këshilli tërhiqet për këshillim dhe votim mbi sjelljen e vendimit.<sup>97</sup>

#### **4. Pajtimi gjyqësor**

Para se të kalojmë në stadiumin e fundit të procedurës kontestimore të shkallës së parë, është me rëndësi të përmendim dhe një mënyrë të veçantë të përfundimit të procedurës,

---

<sup>95</sup> Neni 294. paragr. 1 i LPK-së.

<sup>96</sup> Neni 311. paragrafi 1 dhe 2 i LPK-së.

<sup>97</sup> Neni 304. i LPK-së.

deri tek e cila mund të vij në të gjitha stadiumet dhe fazat e procedurës, madje edhe para inicimit të procedurës kontestimore. Fjala është për pajtimin gjyqësor, si mënyrë e zgjidhjes paqësore të kontesteve përmes veprimeve procedurale dispozitive të palëve, të cilat mes veti pajtohen që të zgjedhin kontestin pa pasur nevojë që për të njejtin të silltet vendim gjyqësor. Pajtim gjyqësor, palët mund të lidhin gjatë tërë procedurës para gjykatës kontestimore deri në përfundimin e plotfuqishëm të saj, si edhe gjatë rrjedhës së procedurës së shkallës së dytë deri në sjelljen e vendimit sipas ankesës.<sup>98</sup>

Pajtimi gjyqësor (*res iudicialiter transacta*) paraqet kontratë, me të cilën palët i rregullojnë marrëdhëniet e tyre juridiko-civile me të cilat mund të disponojnë lirisht, e lidhur në formë të shkruar para gjykatës kompetente, brenda procedurës ose jashtë saj, e cila ka cilësi të dokumentit përmbarues.<sup>99</sup> Marrëveshja mbi pajtimin e palëve shënohet në procesverbal, dhe konsiderohet e lidhur kur palët pas leximit të parashtresës të njejtën e nënshkruajnë.

Duke u nisur nga definimi i këtillë i pajtimit gjyqësor shihet qartë dallimi i pajtimit gjyqësor nga pajtimi jashtëgjyqësor. Pra, pajtimi jashtëgjyqësor paraqet kontratë të pastër juridiko-materiale, e cila nuk lidhet para gjykatës dhe nuk prodhon efekte juridiko-procedurale, megjithëse në të mund të përfshihen edhe disa veprime procedurale.<sup>100</sup>

## **5. Sjellja e vendimit përfundimtar**

Procedura kontestimore para gjykatës së shkallës së parë përfundon me sjelljen e vendimit përfundimtar, si stadium i fundit i saj. Natyrisht, kjo vlen nëse e njehta procedurë nuk ka përfunduar në ndonjërin nga stadiumet e mëhershme të procedurës.

Sjellja e vendimit përfundimtar nënkupton përfundimin meritore të çështjes juridike konkrete duke u bazuar në rezultatet e shqyrtimit kryesor. Në procedurën kontestimore të shkallës së parë vendimet përfundimtare dhe meritore sillen në formë të aktgjykimit dhe aktvendimit.

Më poshtë bëjmë fjalë ndaras për secilin nga këto vendime përfundimtare gjyqësore.

### **5.1. Aktgjykimi**

---

<sup>98</sup> Neni 321. paragr. 1 i LPK-së.

<sup>99</sup> Janevski, A., Zoroska-Kamilovska, T. "E drejta procedurale civile. L.1, E drjeta kontestimore", Shkup, 2009, f. 300.

<sup>100</sup> P.sh. obligimi që të tërhiqet padia, dhe në këtë rast pajtimi jashtëgjyqësor në procedurë kontestimore paraqitet si kundërshtim juridiko-material.



Aktgjykimi paraqet lloj të vendimit gjyqësor me anë të të cilit vendoset për bazën e kërkesëpadisë. Sipas rregullit, aktgjykimi paraqet vendim përfundimtarë me të cilin përfundon procedura kontestimore e shkallës së parë. Aktgjykimi paraqet akt individual me të cilin zgjidhet kontesti konkret midis palëve konkrete, ashtu që jo rastësisht thuhet se aktgjykimi paraqet ligj individual për palët. Vetë sjellja e aktgjykimit paraqet proces të ndërlikuar mendor të gjykatës, ku aktgjykimi paraqitet si përfundim i dy premisave, nga të cilat premisën e poshtme e përbën gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata, nderkaq premisën e lartë e përbën norma juridike nën të cilën është vendosur gjendja faktike e vërtetuar.

Përmbajtja me shkrim e aktgjykimit përbëhet nga tre elemente të detyrueshme, pavarësisht llojit të aktgjykimit, dhe atë: hyrjes, urdhërit (dispozitivit) dhe arsytimit

Varësisht nga kriteret që merren për bazë, aktgjykimet ndahen në më tepër lloje.

Kështu, sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim dallojmë: aktgjykimet deklaratore, konstitutive dhe kondemnatore.

Sipas vëllimit të mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim dallojmë aktgjykimet e plota dhe jo të plota. Tek aktgjykimet jo të plota dallojmë aktgjykimet e pjeshme, aktgjykimet plotësuese dhe aktgjykimet e ndërmjetshme.

Sipas mënyrës së krijimit aktgjykimet ndahen në aktgjykime kontradiktore dhe aktgjykime jokontradiktore

Sipas qëndrimit të gjykatës ndaj kërkesëpadisë dallojmë aktgjykime me anë të të cilave pranohet në tërësi kërkesëpadia, aktgjykime me anë të të cilave refuzohet në tërësi kërkesëpadia dhe aktgjykime të përziera, ku pjesërisht pranohet e pjesërisht refuzohet kërkesëpadia.

## **5.2. Aktvendimi**

Aktvendimi paraqet lloj të vendimit gjyqësor të cilin gjykata e sjell në të gjitha rastet kur nuk vendos me aktgjykim. Gjykata mund të sjell aktvendime në të gjitha stadiumet dhe fazat e ndryshme të procedurës kontestimore, dhe atë si në seancë ashtu edhe jashtë seance. Aktvendimet të cilat në procedurë kontestimore i sjell gjykata mund të ndahen në disa grupe: aktvendime për drejtimin e procedurës, aktvendime me të cilat vendoset për prezumimet procedurale, aktvendime me të cilat vendoset për autorizimet procedurale të palëve, aktvendime me të cilat ndalet procedura, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime për shkak të keqpërdorimit të autorizimeve procedurale, aktvendime me të cilat vendoset për kompenzimin e shpenzimeve procedurale, aktvendime me të cilat shqiptohen dënime për

shkak të mungesës së disiplinës procedurale dhe aktvendime me të cilt vendoset në mënyrë meritore.

Për dallim nga aktgjykimi, përmbajtja me shkrim e aktvendimit duhet të përmbajë vetëm hyrjen dhe urdhërin. Aktvendimi do të arsyetohet nëse me anë të tij refuzohet propozimi i palës ose nëse me të vendoset për propozime të palëve të cilat ndërmjet veti janë në kundërshtim, si dhe në të gjitha rastet e tjera kur kjo është e nevojshme.<sup>101</sup>

## **B. Procedura sipas mjeteve juridike**

### **1. Mjetet juridike**

Mjetet juridike paraqesin mjete të rëndësishme, veprime procedurale dispozitive, në duart e personave të cilët janë të autorizuar që nga gjykata kompetente të kërkojnë hetimin (anulimin ose ndryshimin) e vendimeve gjyqësore për të cilat pretendojnë se janë sjellur në dëm të tyre, se janë të parregullta dhe të paligjshme. E drejta në mjet juridik paraqet të drejtë fundamentale të njeriut dhe si e tillë garantohet në të gjitha dokumentet ndërkombëtare si dhe me dispozitat nacionale të shteteve demokratike.

Duke pasur parasysh se sjellja e vendimeve gjyqësore është pasojë e procesit të ndërlikur mendor të gjykatës, nuk është e pamundur që gjatë kësaj të ndodhin dhe gabime, qoftë si gabime që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të procedurës kontestimore ose si gabime në vendosje. Që të mund të evitohen gabimet, të cilat eventualisht mund të paraqiten gjatë vendosjes në procedurë kontestimore, palëve, si dhe personave të tjerë të autorizuar, u qëndrojnë në dispozicion mjetet juridike. Mjetet juridike kanë për qëllim që të hetojnë, kontrollojnë dhe evitojnë paligjshmërinë dhe parregullsinë e vendimeve gjyqësore.

Varësisht nga kriteret që merren për bazë, dallojmë më tepër lloje të mjeteve juridike.

Kështu, kur si kriter merret (jo)plotfuqishmëria e vendimeve kundër të cilave paraqitet mjeti juridik, dallojmë mjetet juridike të rregullta dhe mjetet juridike të jashtëzakonshme.

Sipas asaj se cilës gjykatë i lehet në kompetencë që të vendos për mjetin juridik, dallojmë mjetet juridike devolutive (kur vendos gjykata më e lartë nga gjykata që ka sjell vendimin i cili goditet) dhe remonstrative (gjykata e njëjtë që e ka sjell vendimin që goditet).

Sipas asaj se a e shtyn paraqitjen e plotfuqishmërisë së vendimit që goditet, mjetet juridike ndahen në suspensive dhe jo suspensive.

---

<sup>101</sup> Neni 345. i LPK-së.

Sipas asaj se a duhet palës kundërshtare të parashtruesit të mjetit juridik ti jepet mundësia që të deklarohet lidhur me të ose jo, dallojmë mjetet juridike të njëanshme dhe të dyanshme.

Dhe në fund, mjetet juridike mund të jenë të pavarura, kur mund të parashtrohen në mënyrë të pavarur, dhe të varura, kur mjeti juridik paraqitet vetëm me mjetin juridik kundër ndonjë vendimi tjetër.

Ne në vazhdim do bëjmë fjalë më gjërësisht për mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

### **1.1. Mjetet e rregullta juridike**

Mjetet e rregullta juridike paraqiten kundër vendimeve gjyqësore jo të plotfuqishme. Këto mjete pamundësojnë paraqitjen e plotfuqishmërisë së vendimit në pjesën në të cilën ai goditet. Mjetet e rregullta juridike paraqiten kur procedura është akoma në rrjedhë andaj dhe paraqesin stadium të veçantë të procedurës së inicuar me padi. Me LPK parashihen më tepër mjete të rregullta juridike, dhe atë: ankesa kundër aktgjykimit, ankesa kundër aktvendimit dhe kundërshtimi kundër urdhërpagesës.

Ankesa kundër aktgjykimit paraqet mjet të rregullt juridik i cili parashtohet kundër vendimeve jo të plotfuqishme. Ankesa është mjet univerzal, devolutiv, prekluziv, suspensiv dhe i dyanshëm. Sipas LPK ankesa kundër aktgjykimit paraqitet kundër vendimeve të shkallës së parë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur palës i dërgohet përshkrimi i aktgjykimit, nëse me ligj nuk është paraparë afat tjetër.<sup>102</sup> Pala mund të heqë dorë nga e drejta në ankesë prej momentit të shpalljes së aktgjykimit, e nëse aktgjykimi nuk është shpallur, prej momentit kur i është dërguar përshkrimi i aktgjykimit.<sup>103</sup> Për ankesën kundër aktgjykimit vendos gjykata e shkallës së dytë. Deri në sjelljen e vendimit të shkallës së dytë, pala mund ta tërheq ankesën e paraqitur. Heqja dorë dhe tërheqja e ankësës nuk mund të revokohen.<sup>104</sup>

Ankesa mund të parashtrohet në formë të parashtrësës, por edhe me gojë në procesverbal para gjykatës. Përveç të dhenave që janë të obligueshme për çdo parashtrësë, ankesa duhet të përbajë dhe të dhënat e tjera të parapara me ligj, dhe atë: shënimin e aktgjykimit i cili goditet, deklaratën se a goditet aktgjykimi në tërësi apo një pjesë e tij, shkakun e ankesës dhe nënshkrimin e parashtruesit të ankesës.<sup>105</sup>

---

<sup>102</sup> Neni 348. paragrafi 1 i LPK-së.

<sup>103</sup> Neni 349. paragrafi 1 i LPK-së.

<sup>104</sup> Neni injejtë paragrafi 2 i LPK-së.

<sup>105</sup> Neni 350. i LPK-së.

Në ankesën kundër aktgjykimit nuk mund të parashtrohen fakte të reja dhe as të propozohen prova të reja (ndalimi i beneficium novorum), përveç nëse ato fakte dhe prova të reja kanë të bëjnë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave mund të paraqitet ankesa.<sup>106</sup>

Ankesa kundër aktgjykimit është mjet juridik me anë të cilit goditet aktgjykimi i sjellë nga gjykata e shkallës së parë. Me LPK është paraparë se për cilat shkaqe mund të paraqitet ankesa. Ato shkaqe janë: shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i së drejtës materiale.

Ankesa kundër aktgjykimit parashtohet në gjykatën e shkallës së parë e cila e ka sjell vendimin i cili goditet. Për ankesën vendos gjykata e shkallës së dytë, në këshill dhe, sipas rregullit pa mbajtjen e shqyrtimit. Kur vendos për ankesën gjykata e shkallës së dytë mund të sjell këto vendime: aktvendim me të cilin hidhet poshta ankesa e cila nuk është paraqitur me kohë, është jo e plotë ose e palejuar; aktgjykim me të cilin do ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe do ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë; aktvendim me të cilin do ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta kthej lëndën në gjykatën e njëjtë të shkallës së parë ose do t'ia dërgoj lëndën gjykatës kompetente të shkallës së parë; aktvendim me të cilin do ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe do ta hedh poshtë padinë; aktgjykim me të cilin do ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.<sup>107</sup>

Ankesa kundër aktvendimit është mjet juridik i rregullt, prekluziv, i pakufizuar, devolutiv, i njëanshëm, dhe sipas rregullës, suspensiv. Ankesa kundër aktvendimit të sjellë në shkallë të parë është i lejuar në të gjitha rastet, përveç kur me LPK është paraparë se ankesa nuk lejohet.<sup>108</sup> Me paraqitjen e ankesës ndalohet përmbarimi i aktvendimit të goditur, përveç nëse me ligj është paraparë ndryshe.

Ankesa kundër aktvendimit, në rastet kur është e lejuar, mund të paraqitet si e pavarur (e veçantë) ose e varur, varësisht nga fakti se a lejohet që të paraqitet ankesa menjëherë pas publikimit të aktvendimit i cili dëshirohet të goditet, apo një gjë e tillë lejohet vetëm pas sjelljes së vendimit meritor përfundimtarë, ku njëherëah ankesa kundër aktvendimit paraqet dhe shkak për goditjen e vendimit meritor.

Kur gjykata e shkallës së dytë vendos sipas ankesës kundër aktvendimit, ajo mund: ta hedh poshtë ankesën e cila nuk është paraqitur me kohë, është jo e plotë ose e palejuar; ta refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetojë aktvendimin e shkallës së parë; ta pranoj

---

<sup>106</sup> Neni 352. paragrafi 1 i LPK-së.

<sup>107</sup> Neni 366. paragrafi 1 i LPK-së.

<sup>108</sup> Neni 378. paragrafi 1 i LPK-së.

ankesën dhe aktvendimin ta ndryshoj ose anuloj dhe sipas nevojës lëndën ta kthej në gjykim të përsëritur.<sup>109</sup>

E gjithë ajo që u tha përmend për procedurën sipas ankesës kundër aktgjykimit vlen edhe në procedurën sipas ankesës kundër aktvendimit, natyrisht, me përjashtime të caktuara.<sup>110</sup>

## **1.2. Mjetet e jashtëzakonshme juridike**

Mjetet e jashtëzakonshme juridike paraqiten kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, pas përfundimit të litispëndencës. Me LPK janë paraparë këto mjete të jashtëzakonshme juridike: revizioni kundër aktgjykimit, revizioni kundër aktvendimit dhe përsëritja e procedurës.

Revizioni kundër aktgjykimit është mjet juridik i jashtëzakonshëm, devolutiv, josuspensiv, prekluziv, i dyanshëm dhe i kufizuar.

Revizionin kundër aktgjykimit palët mund ta paraqesin vetëm kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të sjell nga gjykata e shkallës së dytë, dhe atë:

1. nëse vlera e objektit të kontestit të pjesës së aktgjykimit i cili goditet tejkalon shumë prej 200.000 kn, ndërsa në procedurën para gjykatës tregtare 500.000 kuna;
2. Nëse aktgjykimi është sjellur në kontestin lidhur me ekzistimin e kontratës, përkatësisht lidhur me pushimin e marrëdhënies së punës ose për shkak të vërtetimit lidhur me ekzistimin e marrëdhënies së punës;
3. në rastet tjera palët mund të paraqesin revizionin kundër vendimeve të shkallës së dytë nëse gjykata e shkallës së dytë në urdhërin e aktgjykimit ka paraparë që kundër saj është i lejuar revizioni, dhe kështu do veproj nëse vlerëson se vendimi mbi kontestin varet nga zgjidhja e ndonjë çështje juridiko-materiale ose juridiko-procedurale e cila është e rëndësishme për zbatimin unik të ligjit.

Kjo që u përmend, nuk vlen në rastet kur me ligj parashihet ndalimi i parashtrimit të revizionit.<sup>111</sup>

Revizioni mund të parashtrohet në afat prej 30 ditëve nga dërgimi i aktgjykimit të shkallës së dytë. Revizioni nuk e ndalon përmbarimin e aktgjykimit që goditet.<sup>112</sup>

---

<sup>109</sup> Neni 380. i LPK-së.

<sup>110</sup> Kështu, ankesa kundër aktvendimit nuk i dërgohet për përgjigje palës kundërshtare, pra paraqet mjet të njëanshëm juridik, dhe para gjykatës së shkallës së parë nuk mbahet shqyrtim.

<sup>111</sup> Kështu, me LPK është paraparë ndalimi i revizionit në rastet kur për ankesën kundër vendimit të shkallës së parë vendos Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (neni 382.a i LPK-së.).

<sup>112</sup> Neni 384. i LPK-së.

Me LPK janë paraparë shkaqet për parashtrimin e revizionit, dhe atë: nëse ekzistojnë disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore; për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë; për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.<sup>113</sup>

Për revizionin, pa mbajtjen e shqyrtimit, vendos Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në këshill të përbërë prej pesë gjyqtarëve.

Parashtruesi i revizionit është i obliguar që në revizion t'i theksoj saktë shkaqet për të cilat e parashtron revizionin.<sup>114</sup> Gjykata e revizionit e heton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën në të cilën ai goditet me revizion dhe në kufijtë e shkaqeve të cilat janë theksuar në revizion.

Palët në revizion mund të parashtrojnë fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja, vetëm nëse ato paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave mund të paraqitet revizioni.<sup>115</sup>

Revizioni i parashtrohet gjykatës e cila e ka sjell aktgjykimin e shkallës së parë, e cila pasi ta hetoj revizionin vetëm nga aspekti formal, të njejtin (nëse i plotëson kushtet për procedim të mëtejshëm), së bashku me të gjitha shkrest e lëndës i dërgon gjykatës së revizionit përmes gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata e revizionit vendos mbi bazën e revizionit dhe me këtë rast ajo mund të sjell disa lloje vendimesh: aktvendim me të cilin e hedh poshtë revizionin i cili është nuk është paraqitur në kohë, është jo i plotë ose i palejuar; aktgjykim me të cilin do ta refuzoj revizionin si të pabazuar<sup>116</sup>; aktvendim me të cilin do ta anuloj në tërësi apo pjesërisht aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të gjykatës së shkallës së parë, ose vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë dhe lëndën do ta kthej në gjykim të përsëritur gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht gjykatës së shkallës së dytë; aktvendim me të cilin do ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe lëndën do t'ia kthej gjykatës së shkallës së dytë në rast se bëhet fjalë për tejkalimin e kërkesëpadisë extra petitum; aktvendim me të cilin do ta anuloj vendimin e shkallës së parë dhe vendimin e shkallës së dytë dhe do ta hedh poshtë padinë; aktgjykim me të cilin do ta pranoj revizionin dhe do ta ndryshoj aktgjykimin e goditur, kur vërteton se është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

---

<sup>113</sup> Neni 385. i LPK-së.

<sup>114</sup> Neni 386. i LPK-së.

<sup>115</sup> Neni 387. i LPK-së.

<sup>116</sup> Me këtë rast, duke pasur parasysh se aktgjykimin i cili goditet me revizion është i plogfuqishëm, gjykata e revizionit nuk e vërteton aktgjykimin e shkallës së dytë.

Vendimi i gjykatës së revizionit drejtpërdrejtë i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, ndërsa një shembull i vendimit gjykata e revizionit i dërgon dhe gjykatës së shkallës së dytë.<sup>117</sup>

Revizioni kundër aktvendimit është mjet juridik i jahtëzakonshëm të cilin palët mund ta paraqesin kundër aktvendimit të plotfuqishëm të gjykatës së shkallës së dytë. Ai është mjet juridik devolutiv, i kufizuar, josuspenziv dhe i dyanshëm.

Palët mund të paraqesin revizion kundër aktvendimeve të shkallës së dytë me të cilat procedura ka përfunduar në mënyrë të plotfuqishme në kontestet në të cilat është i lejuar revizioni kundër aktgjykimit të sjell në shkallë të dytë.

Revizioni është çdoherë i lejuar kundër aktvendimeve të gjykatës së shkallës së dytë me të cilat hidhet poshtë ankesa, përkatësisht me të cilat vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për hedhjen poshtë të revizionit. Revizioni kundër aktvendimit nuk është i lejuar kundër aktvendimit të sjell në kontestet për shkak të pengimit të posedimit, në kontestet me vlerë të vogël si dhe kundër aktvendimit të plotfuqishëm të shkallës së dytë mbi masat e përkohshme. Në procedurën përmbaruese lejohet revizioni.

Në procedurën sipas revizionit kundër aktvendimit në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e LPK-së që kanë të bëjnë me revizionin kundër aktgjykimit.<sup>118</sup>

Përsëritja e procedurës është mjet juridik i jashtëzakonshëm të cilin mund ta paraqesin palët kundër vendimeve me të cilat procedura përfundon në mënyrë të plotfuqishme. Ajo paraqet mjet juridik josuspenziv, sipas rregullës, remonstrativ, të kufizuar dhe të dyanshëm.

Me LPK janë paraparë shkaqet për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës dhe atë: nëse ekzistojnë disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, veprimet antijuridike (veprat penale) të pjesëmarrësve në procedurë kontestimore, faktet e reja dhe provat e reja dhe shkeljet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të vërtetuara me aktgjykim nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg.

Propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet dhe për të, sipas rregullës, vendos gjykata e cila e ka sjellë vendimin në shkallë të parë. Propozimi përveç elementeve të cilat janë të obligueshme për çdo parashtrësë, duhet të përmbajë dhe: bazën ligjore sipas së cilës kërkohet përsëritja, rrethanat nga të cilat del se propozimi është paraqitur brenda afatit ligjor dhe provat me të cilat vërtetohen pretendimet e propozuesit.<sup>119</sup>

---

<sup>117</sup> Neni 398. paragrafi 1 dhe 2 i LPK-së.

<sup>118</sup> Neni 400. paragrafi 3 i LPK-së.

<sup>119</sup> Neni 424. paragrafi 1 dhe 2 i LPK-së.

Propozimi mund të paraqitet në afat subjektiv prej 30 ditëve dhe afat objektiv prej 5vjet duke llogaritur nga dita kur vendimi është bërë i plotfuqishëm<sup>120</sup>.

Procedura sipas propozimit për përsëritjen e procedurës paraqet proces të ndërlikuar, ku kërkohet që fillimisht aktvendimi i plotfuqishëm i cili goditet të anulohet, që të mundet pastaj të mbahet gjykim i ri. Procedura sipas propozimit kalon nëpër disa faza, dhe atë: faza në të cilën hetohet lejimi i propozimit, faza në të cilën hetohet baza e propozimit dhe faza në të cilën shqyrtohet çështja në mënyrë të përsëritur.

Gjykata e shkallës së parë, përkatësisht gjyqtari individual ose kryetari i këshillit vendos në dy fazat e para, ndërkaq në fazën e tretë vendos vetëm nëse shkak për përsëritjen e procedurës nuk ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën përpara gjykatës së shkallës së lartë (me çrast lënda i dërgohet gjykatës së shkallës së lartë që ajo të sjellë vendim). Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës dhe anulohet vendimi i sjellë në procedurën e mëparshme, gjykata cakton mbajtjen e shqyrtimit për çështjen kryesore i cili zhvillohet sipas rregullave që vlejné për procedurën kontestimore të caktuar dhe varësisht nga fakti se para cilës gjykatë, të shkallës së parë apo të shkallës së dytë, zhvillohet procedura.

Me këtë rast, vendimi i cili do sillet si rezultat i procedurës së përsëritur paraqet vendim të shkallës së parë.

---

<sup>120</sup> Afati prej 5 vjet nuk vlen në rastet kur përsëritja e procedurës kërkohet për shkak se në sjelljen e vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk ka vetinë e gjyqtarit ose për shkak të shkeljeve të rregullave mbi dëgjimin e palëve, ose të rregullave mbi zotësinë e paëvë dhe të përfaqësimit të palëve.



## **B. ZGJIDHJA JASHTËGJYQËSORE E KONTESTEVE**

### **I. Në përgjithësi mbi ndërmjetësimin (mediacionin)**

#### **1. Kuptimi**

Ngarkimi i gjykatave shtetërore me lëndë të pazgjidhura, derdhja e lëndëve të reja dhe ngadalësimi në zgjidhjen e të njejtave kanë sjellë deri tek nevoja që kontestet, veçanërisht kontestet tregtare, të zgjidhen në rrugë alternative përkrah rrugës gjyqësore. Efikasiteti dhe shpejtësi paraqesin kërkesa të rëndësishme të kohës në të cilën jetojmë, të cilat gjykatat shtetërore vështirë mund t'i plotësojnë në masën e duhur. Andaj, si përgjigje ndaj gjendjes së këtillë, parashihen zgjidhje të ndryshme të cilat me një term të përbashkët njihen si mënyra alternative të zgjidhjes së kontesteve.

Njëra nga mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve midis palëve është ndërmjetësimi ose mediacioni. Ndërmjetësimi paraqet mënyrë jo të obligueshme të zgjidhjes

së kontesteve, në të cilin personi i tretë nxit negociatat dhe mundohet t'ju ndihmoj palëve në arritjen e marrëveshjes lidhur me kontestin ekzistues.

Ndërmjetësimi është formë specifike ndërmjetëse në të cilin palët zgjidhin kontestet e tyre nën udhëheqjen dhe ndihmën e ndërmjetësit, personit të tretë të paanshëm. Gjatë ndërmjetësimit kërkohet zgjidhje e cila është në interes të të dyja palëve. Pra, qëllimi i ndërmjetësimit nuk është që të vërtetohet se cila nga palët ka të drejtë, por të gjendet zgjidhje e pranueshme e cila do ti kënaqë interesat e çdonjërës nga palët në kontest.

Në Republikën e Kosovës mediacioni është i rregulluar me Ligji për ndërmjetësimin.

LN rregullon ndërmjetësimin në kontestet juridiko civile, përkatësisht, kontestet që dalin nga marrëdhëniet tregtare, të punës dhe marrëdhënieve të tjera juridiko pronësore me të cilat palët mundën lirisht të disponojnë, nëse për disa nga këto konteste me akt të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

Sipas LN ndërmjetësimi paraqet çdo procedurë, pavarësisht nëse zbatohet para gjykatës, institucionit për ndërmjetësim ose jashtë tyre, në të cilën palët mundohen të zgjidhin kontestin me marrëveshje me ndihmën e një ose më tepër ndërmjetësve të cilët u ndihmojnë palëve që të arrijnë pajtim, pa autorizime që t'u imponojnë zgjidhje të obligueshme.

Nga definimi i këtillë i ndërmjetësimit dalin tre pjesë përbërëse të rëndësishme. Së pari, ndërmjetësimi zbatohet nëse midis palëve ekziston kontest të cilin palët mundohen ta zgjidhin me marrëveshje. Së dyti, palëve në zgjidhjen e kontestit duhet t'ju ndihmoj personi i tretë ose disa persona të tillë. Së treti, autorizimet e personit të tretë kufizohen vetëm në ofrimin e ndihmës, pra palët janë ata që me veprimet e veta-me marrëveshje, duhet të përfundojnë kontestin ekzistues. Duke pasur parasysh këto tre elemente mundemi qartë të bëjmë kufizimin e ndërmjetësimit nga mënyrat e tjera të zgjidhjes së kontesteve. Kështu, për dallim nga negociatat e drejtëpërdrejta, në procedurën e ndërmjetësimit përkrah palëve marrin pjesë edhe personat e tretë, të cilët si persona neutral janë njëjtë sa palët të interesuar për zgjidhjen me marrëveshje të kontestit midis palëve. Për dallim nga gjykimi para gjykatave shtetërore ose zbatimi i procedurës së arbitrazhit, ndërmjetësi nuk ka autorizime që të imponoj zgjidhje të obligueshme, përkatësisht, ai nuk mundet që lidhur me kontestin të sjell vendim i cili do ishte objekt i përmbartimit të dhunshëm.

Ndërmjetësimi është mënyrë e vullnetshme, joformale, konfidenciale, kreative, e shpejtë dhe pa pagesë e zgjidhjes së kontesteve midis palëve. Nga vullneti dhe interesi i palëve varet fillimi, zhvillimi, zgjatja dhe përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit. Pra, procedura e ndërmjetësimit zbatohet me qëllim të realizimit të interesit të palëve në të cilin ata mes veti rregullojnë marrëdhëniet përmes vendimit të përbashkët. Nga ana tjetër, parimi i

konfidencialitetit përbën një nga parimet themelore të procedurës së ndërmjetësimit. E gjithë ajo që është thënë dhe shqyrtuar në procedurën e ndërmjetësimit palët dhe ndërmjetësi janë të obliguar që ta ruajnë si fshehtësi në raport me personat e tretë, përveç nëse me ligj nuk është paraparë ndryshe.

Ndërmjetësimi është i mundshëm pavarësisht nëse për objektin e kontestit zhvillohet procedurë gjyqësore, e arbitrazhit ose procedurë tjetër. Palët mund të vendosin që kontestin ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit para ose gjatë rrjedhës së procedurës kontestimore. Ndërmjetësimi është i mundur edhe pas përfundimit të procedurës kontestimore, nëse palët dëshirojnë që marrëdhëniet e veta t'i rregullojnë ndryshe nga ajo që është përcaktuar në vendimin gjyqësor.

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë dy lloje të ndërmjetësimit dhe atë: ndërmjetësim pranë gjykatës dhe ndërmjetësim pranë organizatave për ndërmjetësim.

Ndërmjetësimi pranë gjykatave, siç del nga vetë emërimi, është ndërmjetësim i cili zhvillohet pranë gjykatave dhe i cili u është në dispozicion palëve midis të cilave zhvillohet procedura kontestimore. Në rastet kur gjyqtari do të vlerësoj se lënda e caktuar është e përshtatshme për ndërmjetësim do ti njoftoj palët për këtë. Nëse palët vetë propozojnë ndërmjetësimin ose pajtohen që të zbatohet ndërmjetësimi, gjyqtari do ti udhëzoj tek ndërmjetësi i cili do të zhvilloj procedurën e ndërmjetësimit. Këtë lloj të ndërmjetësimit e zhvillon gjyqtari ndërmjetës i përcaktuar nga lista e gjyqtarëve ndërmjetës të cilën e vërteton kryetari i gjykatës. Marrëveshja e lidhur para gjyqtarit ndërmjetës është pajtim gjyqësor. Në rastet kur marrëveshja nuk lidhet, palët e vazhdojnë procedurën kontestimore.

Ndërmjetësimi para organizatave për ndërmjetësim zhvillohet në pajtim me rregullat e organizatës për ndërmjetësim e cila është person juridik ose organ i personit juridik e cila organizon procedurat e ndërmjetësimit.

Në Republikën e Kosovës deri në sjelljen e LN nuk kanë ekzistuar organizata të specializuara të cilat do të merreshin vetëm me organizimin e ndërmjetësimit, megjithëse ndërmjetësimi ka qenë pjesë e shërbimeve të cilat cilat i kanë ofruar disa institucione. Përcaktimi me ligj i organizatave për ndërmjetësim ka mundësuar themelimin e institucioneve për ndërmjetësim në kuptimin e gjërë. Institucioni për ndërmjetësim është person juridik, organ i personit juridik ose njësi organizative e personit juridik e cila organizon procedurat e ndërmjetësimit. Kështu institucioni i cili merret me ndërmjetësim mund të jetë person juridik më vete i cili merret me ndërmjetësim si veprimtari të vetme dhe kryesore, por mund të jetë dhe organ brenda personave juridik (psh. Në Kroaci Qendra për

ndërmjetësim në përbërje të Odës ekonomike të Kosovës, e cila paraqet organizatën e parë për ndërmjetësim në Kroaci të themeluar më vitin 2002).

Lidhur me përshtatshmërinë e kontesteve të cilat zgjidhen përmes ndërmjetësit, pa dyshim që si më të përshtatshme dallojmë kontestet tregtare, e në mesin e tyre veçmas kontestet nga e drejta e ndërtimtarisë, kontestet lidhur me pronësinë intelektuale, të drejtat e autorit, menaxhmentin, kompenzimin e dëmit, etj. Kjo është kështu për shkak se përfaqësuesit e shoqërive tregtare, sikur edhe të personave tjerë juridik, në të shumtën e rasteve nuk janë të lidhur personalisht dhe emocionalisht drejtëpërdrejtë në kontest, andaj dhe hyjnë në ndërmjetësim me më pak emocione dhe me më shumë gatishmëri për arritjen e zgjidhjes së përbashkët.

## **2. Ndërmjetësit**

Krahas ndërmjetësit, LN jep definicionin edhe për ndërmjetësin. Kështu, ndërmjetësi është personi i cili në bazë të marrëveshjes së palëve zbaton ndërmjetësimin. Nga kjo del natyra konsenzuale e ndërmjetësit, si procedurë e cila mund të zgjas aq gjatë sa zgjat dhe vullneti i palëve për pjesëmarrje. Pra, palët kanë autonomi të plotë si kur përcaktohen për ndërmjetësimin, si mëyrë për zgjidhjen e kontestit të tyre, ashtu edhe kur përcaktojnë ndërmjetësin. Në rastet kur palët janë dakorduar për ndërmjetësim, ndërmjetësi në rastin konkret do të veproj vetëm nëse ekziston marrëveshja e palëve, e dhënë shprehimisht apo në mënyrë konkludente (me lëshimin në ndërmjetësim), që ai në atë procedurë të marrë pjesë.

Ndërmjetësit u ndihmojnë palëve gjatë negociatave (bisedimeve) në mbledhjet e përbashkëta ose në mbledhjet e veçanta me secilën nga palët, përmbajtja e të cilave mbetet e fshehtë, sekrete në raport me personat e tretë, përkatësisht ndaj njërit nga palët kundërshtarë pa lejen e palës tjetër gjatë mbledhjeve të veçanta. Ata u ndihmojnë palëve që të kuptojnë pozitën e tyre, të përcaktojnë interesat e tyre, të gjejnë zgjidhje të mundshme dhe të shqyrtojnë të gjitha mundësitë dhe alternativat lidhur me arritjen e marrëveshjes. Gjithashtu, ndërmjetësi mund të merr pjesë në përpilimin e marrëveshjes si dhe të propozoj përmbajtjen e saj,<sup>121</sup> mirëpo palët në marrëveshjen mes tyre mundën që të kufizojnë këtë autorizim të ndërmjetësit.

### **2.1. Emërimi dhe numri i ndërmjetësve**

---

<sup>121</sup> Neni 11. i LP-së.

Palët të cilat janë dakorduar që kontestin e tyre ta zgjidhin me ndërmjetësim, mundën të përcaktojnë personin konkret i cili do të veproj si ndërmjetës në zgjidhjen e kontestit konkret. Nëse palët nuk mundën të përcaktojnë në marrëveshjen e tyre numrin ose personin/personat e ndërmjetësit, palët duhet të merren vesh lidhur me atë që përcaktimin ose emërimin ta kryej ndonjë person i tretë ose institucion si organ për emërim. Në praktikë palët rrallë disponojnë me informacione dhe përvojë të mjaftueshme e cila do tu mundësonte të zgjedhnin ndërmjetësin e duhur. Andaj, në të shumtën e rasteve emërimi i ndërmjetësit bëhet me ndihmën e organit të caktuar ose institucionit i cili mund të propozoj persona me aftësi, kualifikime, specializim dhe përvojë të nevojshme që të veproj në rastin konkret.

Nëse palët vendosin që ndërmjetësimi të zhvillohet para organizatës së posaçme për ndërmjetësim, vetë organizata rregullisht ka rregulla për ndërmjetësim, ku bëjnë pjesë dhe rregullat mbi emërimin e ndërmjetësit, sipas të cilave organizata e njejtë ose ndonjë organ i saj propozojnë ndërmjetësit, dhe eventualisht, në mungesë të marrëveshjes së palëve, veprojnë si organ për emërim.

Pra, me LN është pranuar plotësisht parimi i autonomisë së vullnetit të palëve, si dhe parimi i fleksibilitetit dhe joformalitetit të procedurës së ndërmjetësimit. Kështu, palët me marrëveshje përcaktojnë personin konkret ndërmjetës ose organin i cili do ta emëroj personin e tillë, rregullat e tjera mbi emërimin e ndërmjetësit, numrin e ndërmjetësve. Madje, palët përcaktojnë dhe rregullat mbi konstituimin e organit para të cilit zhvillohet procedura e ndërmjetësimit dhe atë qoftë drejtëpërdrejtë, me marrëveshje, qoftë në mënyrë të tërthortë, sipas marrëveshjes mbi zbatimin e rregullave të caktuara mbi ndërmjetësimin.

Përcaktimi me marrëveshje i ndërmjetësit ose i organit për emërimin e ndërmjetësit, nuk është çdoherë i mjaftueshëm. Nëse palët përcaktojnë organin për emërim, ai organ duhet të ketë vullnet dhe aftësi për të ndërmarrë atë detyrë. Marrëdhënia midis palëve dhe organit për emërim në parim ka natyrë kontraktuese. Nga ana tjetër ligji nuk parasheh detyrim për asnjë organ ose person që të pranoj detyrën të cilën u përcaktojnë palët në marrëveshjen e vetë.

Kufizime normative nuk ekzistojnë as lidhur me posedimin e aftësive të veçanta apo kualifikimeve të ndërmjetësve të cilët i emërojnë vetë palët. Për ndërmjetës, ashtu si edhe për arbitër, palët mund të emërojnë cilindo person fizik. Edhe pse LN nuk e parasheh, është e padyshimtë që ndërmjetësi së paku duhet të jetë i moshës madhore dhe të ketë zotësinë e veprimit. Megjithatë, edhe pse palët nuk janë të kufizuara kur zgjedhin ndërmjetësin, kur emërimin i'a besojnë personit të tretë, organizatës për ndërmjetësim ose ndonjë organi tjetër

për emërim, ai person është i detyruar që të mbajë llogari për marrëveshjen e palëve dhe dispozitat ligjore.

Kështu, organi për emërim është i detyruar që me rastin e emërimit të ndërmjetësit të mbajë llogari për rrethanat e kontestit, e veçanërisht për: përmbajtjen e marrëveshjes së palëve (respektimin e kërkesave eventuale që përmban marrëveshja lidhur me personin e ndërmjetësit, p.sh. lidhur me kualifikimet, me profesionin e caktuar, me njohuritë profesionale etj); natyrën e vetë kontestit (kërkesa që ndërmjetësi të ketë njohuri të caktuara profesionale ose teknike, etj); nevojën që ndërmjetësi të jetë i pavarur dhe i paanshëm; vetitë tjera të cilat për kontestin konkret do ishin të nevojshme me rastin e ndërmjetësimit; si dhe në kontestet me element të huaj, kur zbatohet ndërmjetësimi, të emëroj ndërmjetës i cili ka nënshtetësinë ndryshe nga nënshtetësia e palëve në kontest.

Lidhur me numrin e ndërmjetësve, në praktikë, në të shumtën e rasteve dominojnë procedurat të cilat udhëhiqen nga një ndërmjetës. Poashtu, edhe vetë LN parasheh që, në rastet kur palët nuk mundën të merren vesh lidhur me numrin e ndërmjetësve, do të emërohet vetëm një ndërmjetës. Jemi të mendimit që qëndrimi i tillë është plotësisht me vend, nëse kemi parasysh faktin se ndërmjetësi nuk ka autorizim që të sjell vendime të detyrueshme, andaj, prania e vetëm një ndërmjetësi është e mjaftueshme. Megjithatë, në mungesë të kufizimeve normative, palët kanë mundësi me marrëveshje të parashohin praninë e më tepër ndërmjetësve.

## **2.2. Autorizimet dhe detyrimet e ndërmjetësit**

Nga definicioni i LN mbi ndërmjetësin duket qartë se autorizimet e ndërmjetësit kanë të bëjnë vetëm me ofrimin e ndihmës. Pra, në procedurën e ndërmjetësimit, ndërmjetësi është personi i tretë, neutral i cili u ndihmon palëve në gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për përfundimin e kontestit mes tyre. Ndërmjetësi është nxitës, ndërkaq palët janë ata të cilët me veprimet e veta, me marrëveshje, zgjidhin kontestin ekzistues. Aq më tepër, LN shprehimisht përcakton se ndërmjetësi nuk është i autorizuar që të sjell vendime të obligueshme në procedurën e ndërmjetësimit. Nga kjo del qartë dallimi i ndërmjetësimit nga mënyrat tjera të zgjidhjes së kontesteve, qoftë gjyqësore apo jashtëgjyqësore.

Gjatë kryerjes së funksionit të vet, ndërmjetësi ka detyrim absolut që të sigurojë marrëdhënie të ndershme ndaj/mes palëve, duke i'u shmangur çfarëdo favorimi ose disfavorimi ndaj ndonjëres nga palët.

Barazia e palëve dhe paanshmëria gjatë veprimit janë veti të cilat duhet ti përmbajë çdo procedurë e cila udhëhiqet nga personi i tretë në raport me palët me interesa të kundërt.

Pasi që ndërmjetësimi paraqet një nga procedurat e tilla, këto veti patjetër ti posedoj dhe ndërmjetësi.

Përderisa paanshmëria gjatë veprimit paraqet detyrim absolute, në LN nuk parashihet detyrimi absolut i ndërmjetësit që të jetë i pavarur nga palët. Kështu me marrëveshjen e palëve, si ndërmjetës mund të veproj edhe personi i cili është në marrëdhënie të caktuar me palët, bile edhe i punësuar ose familjari i njërit nga palët.

Nëse palët nuk kanë paraparë ndryshe në marrëveshjen e tyre, ndërmjetës nuk mund të jetë gjyqtari ose arbitri në kontestin në të cilin ka qenë ose është object i procedurës së ndërmjetësimit, ose në ndonjë kontest tjetër i cili rrjedh nga ajo marrëdhënie juridike ose është në lidhje me të. Përrjashtimisht, palët mund ta autorizojnë ndërmjetësin që si arbitër të sjell vendim në bazë të marrëveshjes.

Për shkak të integritetit të procedurës, personi të cilit i ofrohet pozita e ndërmjetësit, para se të pranoj ofertën, është i detyruar që të zbuloj të gjitha rrethanat të cilat do të mund të paraqitnin shkak të dyshimit të arsyeshëm në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në procedurë. Në këtë mënyrë, ndërmjetësi është i detyruar që të zbuloj jo vetëm animet eventuale subjektive, por edhe ato rrethana të cilat – edhe pse ai konsideron veten si të paanshëm dhe të pavarur - mund të shkaktojnë dyshim të arsyeshëm tek të tjerët.

Detyrimi i dhënies së deklaratës nuk ndalon në fazën e procedurës para emërimit të ndërmjetësit. Aq më tepër, edhe pas emërimit, ndërmjetësi duhet menjëherë pas marrjes në dijeni për ndonjë rrethanë relevante, të njejtën t'ju bëj me dije palëve. Nëse ndërmjetësi nuk vepron në këtë mënyrë, ai mund të përgjigjet për dëmin e shkaktuar sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës detyrimore.

Nëse asnjëra nga palët, menjëherë pas marrjes në dijeni të rrethanave të caktuara nuk kërkon emërimin e ndërmjetësit tjetër, ajo e humb të drejtën që këtë ta kërkoj më vonë, si dhe të drejtën që për shkak të rrethanave të tilla të kontestoj vlefshmërinë juridike të veprimeve të cilat i ka ndërmarrë ndërmjetësi, përkatësisht të veprimeve të cilat me ndërmjetësimin e tij i kanë ndërmarrë palët.

Krahas gatishmërisë së palëve për ndërmjetësim, kusht të rëndësishëm për suksesin e ndërmjetësimit paraqet dhe kualiteti i ndërmjetësit. Nga ndërmjetësi kërkohet posedimi i përvojës në punën me palët në rrethana kontestuese, njohja e procedurës gjyqësore dhe aftësia e vlerësimit se si procedura gjyqësore do të mund të ndikonte në palët dhe kontestin mes tyre, posedimi i aftësisë për përpilimin e pajtimit në të cilën përcaktohet se çfarë zgjidhje e kontestit është arritur, të jetë komunikativ, dhe ç'është më e rëndësishme, të jetë i pranuar nga palët. Nga këto veti që përmendëm mund të përfundojmë se gjatë kryerjes së punëve të

ndërmjetësimi si më të përshtatshëm janë juristët, dhe vërtetë, në gjithë botën dominojnë ndërmjetësit të përfaqësuar nga juristët.

Megjithatë, konfidencialiteti, objektiviteti dhe paanshmëria me të cilat udhëhiqet ndërmjetësi gjatë procedurës së ndërmjetësimi paraqesin mjetet më të fuqishme për arritjen e suksesit në ndërmjetësim.

### **3. Procedura e ndërmjetësimi**

#### **3.1. Inicimi i procedurës**

Për iniciimin e procedurës së ndërmjetësimi nuk është e nevojshme që paraprakisht të lidhet marrëveshje me të cilën palët detyrohen që kontestet në të ardhmen ti zgjidhin me ndërmjetësim. Por, me paraqitjen e kontestit mes palëve, nëse ata vendosin që kontestin ta zgjidhin përmes ndërmjetësimi, për iniciimin e procedurës së ndërmjetësimi palët paraprakisht lidhin marrëveshjen për ndërmjetësim, në të cilën i rregullojnë të gjitha çështjet për të cilat mund të vendosin lirshëm.

Procedura e ndërmjetësimi inicohet me propozimin e përbashkët të palëve, me propozim nga vetëm njëra palë ose me propozimin e gjyqtarit. Në dy rastet e fundit kjo është kështu vetëm nëse propozimi për iniciimin e ndërmjetësimi pranohet nga pala kundërshtare. Përkatësisht, sipas LN ndërmjetësimi nuk fillon në momentin kur e inicon njëra nga palët ose personi i tretë, por atëherë kur iniciativa e tillë pranohet, përkatësisht kur pala tjetër pranon propozimin për fillimin e procedurës së ndërmjetësimi. Në këtë mënyrë pranohet plotësisht parimi i autonomisë së vullnetit të palëve dhe parimi i konsenzualitetit të procedurës së ndërmjetësimi. Pra, pa pajtimin e vullnetit të palëve procedura e ndërmjetësimi nuk mund të filloj.

Për iniciimin e procedurës së ndërmjetësimi është e nevojshme që të lidhet marrëveshje për ndërmjetësim. Palët me marrëveshje përcaktojnë se ndërmjetësimin do ta zhvilloj një ose më tepër ndërmjetës. Nëse palët nuk mund të merren vesh lidhur me këtë, ata mund të kërkojnë që në vend të tyre të vendos institucioni për ndërmjetësim ose ndonjë person i tretë.

Nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, ndërmjetësimi fillon me pranimin e propozimit për iniciimin e procedurës së ndërmjetësimi, i parashtruar në formë me shkrim. Konsiderohet se propozimi për ndërmjetësim është refuzuar nëse pala tjetër në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit për iniciimin e ndërmjetësimi, ose në afat tjetër të përcaktuar në propozim, nuk deklarohe lidhur me propozimin.



Në procedurën e ndërmjetësimit marrin pjesë palët në kontest, ndërmjetësi dhe të autorizuarit e palëve ose këshilltarët, dhe sipas nevojës edhe ekspertët. Në praktikë është treguar se pjesëmarrja e numrit më të vogël të personave në ndërmjetësim, rrit gjasat për zgjidhjen më të shpejtë dhe më të përshtatshme të kontestit.

Procedura e ndërmjetësimit zhvillohet në mbledhjet e përbashkëta të palëve dhe ndërmjetësve dhe në dhoma të veçanta për ndërmjetësim, e jo në gjyqtore. Me pajtimin e palëve mbledhjet mund të shtyhen. Procedurën e ndërmjetësimit e udheheq ndërmjetësi në një ambient joformal në dhomë me tavolinë të rrumbullakët ku palët ulen përballë njëra tjetrës.

Në procedurën e ndërmjetësimit vendoset për interesin e palëve, e jo për të drejtën e tyre. Gjatë ndërmjetësimit palët kanë nën kontrollë procedurën ashtu që ata mund nga e njejta edhe të heqin dorë sipas dëshirës së vet në çdo moment.

Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit bien mbi palët në pjesë të barabarta, në pajtim me ligjin e veçantë ose rregullat e institucionit për ndërmjetësim.

### **3.2. Zhvillimi i procedurës**

Ndërmjetësimi mund të zhvillohet në hapësirat e gjykatës ose të ndonjë institucioni tjetër i cili merret me ndërmjetësim, por gjithashtu edhe në ndonjë vend tjetër neutral. Me LN është paraparë që ndërmjetësimi zhvillohet në mënyrën që e kanë përcaktuar palët në marrëveshje, për të cilën munden të lidhin marrëveshje me shkrim. Në rastet kur palët nuk janë marrë vesh lidhur me mënyrën e ndërmjetësimit, atëherë mënyrën e përcakton ndërmjetësi duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret.

Për ndërmjetësimin është karakteristike se vëmendja e ndërmjetësit duhet drejtuar në rindërtimin e sërishëm të marrëdhënies midis palëve, pra ndërmjetësi duhet të rifilloj komunikim e ndërprerë midis palëve në kontest. Rol të rëndësishëm për suksesin e ndërmjetësimit luan përvoja e mëparshme e palëve me procedurën e ndërmjetësimit si dhe fakti se palët janë në dijeni për mundësinë që të arrihet marrëveshja me palën tjetër.

Ndërmjetësi organizon procedurën në disa faza: përgatitja, njohja e palëve me procedurën e ndërmjetësimit, prezantimi i pozitës së palëve në kontest dhe analizimi i fakteve, përcaktimi i opsioneve dhe alternativave, negocimi dhe faza përfundimtare – lidhja e marrëveshjes.

Faza përgatitore paraqet fazën e cila i paraprinë ndërmjetësimit. Pra, pas zgjedhjes së ndërmjetësit, i njejti i kontakton palët dhe sipas mundësisë përcaktohet mbledhja e përbashkët

hyrëse me qëllim që ndërmjetësi tu prezantohet palëve, të krijoj marrëdhënie të afërta me ta dhe të fitoj besimin e tyre.

Pas njohjes së ndërmjetësit me palët vendoset për mbajtjen e mbledhjes së re, ose mbledhja hyrëse vetëm vazhdohet. Në mbledhjet e përbashkëta në të shumtën e rasteve marrin pjesë pesë persona: dy palë, të autorizuarit e palëve – avokatët dhe ndërmjetësi. Avokatët e palëve në procedurën e ndërmjetësimit kanë rolin e këshilltarëve juridik të cilët kujdesen që procedura dhe marrëveshja përfundimtare të sillen brenda kornizave ligjore. Në rastet kur vetëm njëra nga palët është e përfaqësuar nga i autorizuari, ndërmjetësi duhet ta pyes palën tjetër se a dëshiron të angazhoj përfaqësues ose pajtohet që të vazhdoj procedurën pa të.

Në këtë fazë bëhet njohja e palëve me procedurën e ndërmjetësimit, ku ndërmjetësi fillimisht duhet të kontrolloj nëse palët, përkatësisht përfaqësuesit e tyre, kanë autorizimet e duhura për lidhjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Kjo është me rëndësi ngase në të kundërtën i tërë mundi shkon kot, sepse rezultatet e arritura nuk janë miratur nga personat e autorizuar. Më tej ndërmjetësi i njofton palët me rolin dhe kufizimet e tij në procedurë, me rolin e vetë palëve në procedurë, përkatësisht ju bën me dije se zgjidhja e kontestit është në duart e tyre njëjtë si edhe përgjegjësia për dështimin e zgjidhjes. Ndërmjetësi i njofton palët me rregullat e konfidencialitetit, me mundësinë e takimeve në mbledhje të veçanta me secilën nga palët, me detyrimin e tyre për respektimin dhe dëgjimin e qëndrimeve të njëra tjetrës gjatë procedurës, etj. Gjatë ndërmjetësimit, ndërmjetësi duhet t'ju kushtoj vëmendje të njëjtë secilës nga palët.

Në fazën e prezentimit të pozitës së palëve dhe analizimit të fakteve secila nga palët, si edhe përfaqësuesit e tyre eventual, paraqesin këndvështrimin e vet lidhur me shkakun e kontestit, këmbehen të dhëna, parashtrohen pyetje e jepen sqarime, përcaktohet baza e kontestit, etj. Të gjitha këto veprime ndërmerren me ndihmën dhe rolin aktiv të ndërmjetësit.

Gjatë fazës së përcaktimit të opsioneve dhe alternativave zbulohen interesat e palëve dhe përcaktohen interesat e përbashkëta, përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat hyjnë në marrëveshje, përcaktohen prioritetet, jepen alternativa të ndryshme të zgjidhjes së kontestit, etj. Gjatë kësaj faze ndërmjetësi mban mbledhje të përbashkëta si edhe mbledhje të veçanta me secilën palë ndaras. Mbledhjet e veçanta janë mbledhjet në të cilat ndërmjetësi bisedon ndaras me secilën nga palët. Pikërisht në mbledhjet e veçanta fitohet njohuri për shkaqet e vërteta për të cilat palët ndodhen në konflikt, natyrisht nëse ndërmjetësi fiton besim e palës. Andaj, ndërmjetësi duhet të luaj rolin e ndërgjuesit aktiv duke parashtruar nënpyetje, duhet t'i bëj me dije palës se tani ajo mund të ndaj me të të gjitha të dhënat të cilat nuk

dëshiron ti ndaj me palën tjetër. Me këtë rast është me rëndësi që ndërmjetësi vetëm ti ndëgjoj qëndrimet e palës, bile dhe në rastet kur ato janë joracionale, duke mos dhënë gjykimin e vet lidhur me ato qëndrime, sepse qëllimi i ndërmjetësimit është arritja e marrëveshjes dhe jo imponimi i saj. Pas mbarimit të mbledhjes, ndërmjetësi duhet ta përgëzoj palën për përparimin e bërë dhe ta pyes se çfarë mundet ti përcjell palës tjetër. Si tek mbledhjet e përbashkëta, e veçmas tek mbledhjet e veçanta me palët, ndërmjetësi duhet të ketë kujdes që gjithë kohës të mbaj qëndrim neutral ndaj palëve ashtu që të mos sjell në pyetje konfidencialitetin e palëve e me këtë dhe suksesin e ndërmjetësimit. Numri i përgjithshëm i mbledhjeve varet nga gatishmëria e palëve që të lidhin marrëveshje, edhe pse në të shumtën e rasteve zgjidhja arrihet gjatë një dite pune. Megjithatë me LN është paraparë që nesë marrëveshja nuk arrihet në afatin prej 60 ditëve nga dita e pranimit të propozimit për ndërmjetësim, i cili mund të shtyhet maksimalisht edhe 60 ditë, ai përfundon.

Në fazën e negociimit ndërmjetësi sqaron pozitën dhe qëndrimet e palëve, nxit që propozimet e palëve hap pas hapi të shtyhen drejt zgjidhjes përfundimtare, shtjellohen të gjitha qëndrimet jofleksibile të palëve, i përkujton palët përse kanë zgjedhur ndërmjetësimin si dhe bën me dije përqindjen e suksesit të palëve, shpenzimet, kohëzgjatjen e zgjidhjes së kontestit në procedurë gjyqësore (në rast se ndërmjetësimi do të përfundonte pa sukses) me qëllim që ti motivoj palët për zgjidhjen përfundimtare me ndërmjetësim.

Në fazën e lidhjes së marrëveshjes, fazën përfundimtare, përmbledhet e gjithë ajo që është jokontestuese midis palëve, bëhet qartësimi i krejt asaj që është e paqartë, propozohet hartimi i marrëveshjes dhe përfundimisht, përpilohet dhe nënshkruhet marrëveshja me shkrim.

Nëse vjen deri tek marrëveshja mes palëve, nuk sugjerohet që ndërmjetësi personalisht të përpiloj tekstin e marrëveshjes, por atë duhet që t'ja diktoj në palët, përveç kur palët shprehimisht e kanë lutur për një gjë të tillë. Ndërmjetësi duhet të siguroj që marrëveshja të jetë e kuptueshme, e drejtë, e mundshme, e zbatueshme dhe në pajtim me ligjin. Marrëveshjen do ta nënshkruajnë vetëm palët që kanë marrë pjesë në procedurë.

Në rastet kur palët nuk e përfundojnë procedurën e ndërmjetësimit me lidhjen e marrëveshjes, të gjitha të dhënat dhe rezultatet konfidenciale nga ndërmjetësimi nuk mund të shrytëzohen në procedurë gjyqësore, të arbitrazhit ose tjetër.

Palët të cilat kanë marrë pjesë në procedurën e ndërmjetësimit, nuk mund të detyrohen që të dëshmojnë në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit ose në çfarëdo procedure tjetër lidhur me të dhënat dhe informacionet të cilat kanë të bëjnë ose janë të lidhura me procedurën e ndërmjetësimit. Nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, kjo ndalesë vlen edhe për

ndërmjetësin dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurën e ndërmjetësimit. Përjashtimisht, të dhënat dhe informacionet lidhur me procedurën e ndërmjetësimit mund të përdoren si mjete provuese para arbitrazhit, gjykatës ose organit tjetër shtetëror vetëm nën kushtet dhe vëllimin e përcaktuar me ligj për shkak të mbrojtjes së rendit publik ose nëse kjo është e nevojshme për zbatimin ose përmbarimin e marrëveshjes.

Nga ana tjetër, palët të cilat e kanë zgjedhur ndërmjetësimin si mënyrë të zgjidhjes së konfliktit mes tyre nuk e humbin mundësinë e inicimit të procedurës gjyqësore, të arbitrazhit ose të ndonjë procedure tjetër për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit ose atij prekluziv. Me inicimin e procedurës së ndërmjetësimit parashkrimi ndalon.

Andaj, nëse procedura e ndërmjetësimit përfundon pa sukses, kjo nuk sjell pasoja të dëmshme për palët që kanë tentuar kontestin e tyre ta zgjidhin me ndërmjetësim.

### **3.3. Përfundimi i procedurës**

Ndërmjetësimi mund të përfundoj në më tepër mënyra dhe atë:

- a) me lidhjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit;
- b) me vendimin e ndërmjetësit për ndalimin e procedurës së ndërmjetësimit, të sjellë, sipas rregullit, pasi që palëve u është mundësuar të deklarohen lidhur me të, për shkak se tentimi i mëtejshëm që të arrihet zgjidhja e kontestit me ndërmjetësim nuk është i arsyeshme;
- c) me deklaratën me shkrim për përfundimin e procedurës të cilën palët i drejtojnë ndërmjetësit;
- d) me deklaratën me shkrim për heqjen dorë nga procedura e ndërmjetësimit të cilën njëra palë u drejton palëve tjera dhe ndërmjetësit, përveç nëse në procedurë edhe pas heqjes dorë të njëres palë marrin pjesë dy ose më tepër palë të cilat kanë dëshirë të vazhdojnë me ndërmjetësimin;
- e) nëse marrëveshja nuk lidhet në afatin prej 60 ditëve nga fillimi i ndërmjetësimit, ose në afat tjetër të përcaktuar me marrëveshjen e palëve.

Me kërkesën e palëve ndërmjetësi do të merr pjesë në formësimin dhe përpilimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Praktika e ndërmjetësimit ka treguar se ndërmjetësi duhet sa më pak të merr pjesë personalisht në përpilimin e tekstit të marrëveshjes, mbase në të kundërtën ekziston mundësia e madhe se së paku tek njëra palë do të sjell në dyshim paanshmërinë e vet. Andaj ndërmjetësit i sugjerohet që vetëm tu ndihmoj palëve dhe ti nxis në arritjen e marrëveshjes së tyre të përbashkët, që njëherit paraqet dhe rolin kryesor të tij.

#### **4. Marrëveshja përfundimtare në procedurën e ndërmjetësimit**

Marrëveshja përfundimtare e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit i obligon palët të cilat e kanë lidhur ashtu që ato janë të detyruara që obligimet e pranuar ti kryejnë në kohë. Edhe pse palët janë të kënaqura që kanë lidhur marrëveshjen ato sërisht mund të dëshirojnë që të njejtës ti sigurojnë përmbaueshmërinë. Ekzistojnë më tepër mënyra për tu siguruar kjo cilësi e marrëveshjes.

Kështu, me LN është paraparë që nëse me marrëveshje është përcaktuar detyrim i caktuar në bërje për të cilën palët mund të vendosin lirshëm dhe nëse përmban deklaratën e obliguesit për lejimin e përmbaimit (klauzulën për përmbaimit), ajo marrëveshje ka cilësinë e dokumentit përmbaues. Klauzula për përmbaimit nënkupton lejimin e përmbaimit të dhunshëm drejtëpërdrejtë në bazë të marrëveshjes në të cilën është përmbajtur detyrimi i bërjes së caktuar pas arritjes së detyrimit të cilin në mënyrë shprehimore e lejon i obliguari. Klauzula për përmbaimit mund të jetë e përmbajtur në tekstin e marrëveshjes, por edhe në dokument të veçantë.

Gjithashtu, palët mund të merren vesh që marrëveshja të lidhet në formë të aktit noterial, pajtimit gjyqësor ose vendimit të arbitrazhit.

Kështu, palët mund të lidhin marrëveshje në formë të aktit noterial para noterit në të cilën njëra ose të dyja palët obligohen në bërje për të cilën mund të lidhin marrëveshje, e cila do të jetë e përmbaueshme nëse përmban deklaratën e të obliguarit se pas arritjes në bazë të atij akti mund të zbatohet përmbaimit i dhunshëm.

Palët pas lidhjes së marrëveshjes mund ti drejtohen gjykatës kompetente që ti jap cilësinë e pajtimit gjyqësor. Në këtë rast gjykata do të kontrollojë nëse marrëveshja është në kundërshtim me dispozitat imperative dhe me rregullat e moralit si dhe lejimin e dispozicionit të palëve.

Marrëveshja e palëve e sjellë në procedurën e ndërmjetësimit mund të fitoj përmbaueshmërinë edhe me vendimin e arbitrazhit në bazë të marrëveshjes e cila është sjellë në procedurën e mëhershme të arbitrazhit dhe ka cilësinë e vendimit të arbitrazhit.

## **B. NE PERGJITHESI PER ARBITRAZHIN**

### **1. Kuptimi**

Arbitrazhi është organ me karakter joshtetëror, i cili paraqet mënyrë jashtëgjyqësore për zgjidhjen e kontesteve nga një ose më tepër persona, të zgjedhur me pajtimin e palëve, të

cilëve palët me marrëveshje dhe vullnetarisht i besojnë sjelljen e vendimit meritor në kontestin e tyre, ndërsa ligji atë vendim e barazon me vendimin e plotfuqishëm gjyqësor.

Kur bëhet fjalë për historikun e gjykimit nga ana e arbitrazhit, është e njohur se mënyra e zgjidhjes së kontesteve nga arbitrazhi është përdorur në histori edhe para se të krijohen ligjet e shkruara ose të formohen gjykatat formale. Arbitrazhet si institucione jo-shtetërore që zgjidhin konteste që ua besojnë palët, janë të njohura që nga koha antike, dhe u paraprijnë gjykatave, mirëpo me paraqitjen e gjykatave shtetërore, ato nuk pushojnë të funksionojnë por veprojnë paralelisht me gjykatat.<sup>122</sup>

Nocioni i arbitrazhit përcaktohet nga legjislacioni nacional i çdo shteti, por edhe përmes konventave ndërkombëtare të caktuara. Kështu, sipas Konventës Evropiane për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, me arbitrazhë nënkuptohet “zgjidhja e kontesteve jo vetëm nga arbitrat e emëruar për rastet e caktuara (arbitrazha e përkohshme) por edhe nga arbitrat e përhershëm”. Ky definicion thekson aspektet formale dhe procedurale të arbitrazhës. Zgjidhje të ngjajshme pranohen edhe në legjislacionet nacionale. Duke u nisur nga funksioni i arbitrazhit ndërkombëtar, UNCITRAL Model ligji për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, më së tepërmi insiston në kuptimin më të gjërë të punëve tregtare. Kështu, sipas parimit të numërimit taksativ -*numerus clausus*, numërohen transankcionet themelore tek punët juridike tregtare të cilat rekomandohet kontraktimi i arbitrazhit. Këto janë: shitja ose blerja e mallrave dhe shërbimeve, kontratat për distribuim, përfaqësimi tregtar, lizingu, faktoringu, inzhinjeringu, sipërmarrjet investive, financat, punët bankare, sigurimi, koncesionet, joint venture, të gjitha format e transportit si dhe të gjitha format e bashkëpunimit ekonomik industrial ose/dhe biznesor.<sup>123</sup>

Përcaktimi i tillë i gjërë i rrethit të punëve juridike për të cilat rekomandohet kontraktimi i arbitrazhit, e bën arbitrazhin të dëshirueshme praktikisht në të gjitha marrëdhëniet juridike tregtare. Kjo ka qenë dhe një nga arsyet se pse zgjidhjet nacionale gati në mënyrë të unifikuar përcaktojnë nocionin e kontestit i cili mund të zgjidhet para arbitrazhit me karakter nacional.

## 2. Llojet e arbitrazhit

---

<sup>122</sup> Bilalli, A.: “Zgjidhja e kontesteve afariste nëpërmjet arbitrazheve tregtare ndërkombëtare”, I drejta – Law, Prishtinë 2011, f. 7.

<sup>123</sup> UNCITRAL model ligji për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar (dokumentin i KB A/40/17, aneksi I), 1985, kreu i parë, paragrafi 1 në fusnotë.

Varësisht nga kriteret që merren për bazë, dallojmë më tepër lloje të arbitrazhit. Kështu, sipas mënyrës së organizimit, dallojmë: arbitrazhet institucionale dhe ad hoc arbitrazhet.

Arbitrazhet institucionale janë ato gjykata të arbitrazhit të cilat në kornizat e organizatave ekzistuese të cilat i kanë formuar zgjidhin kontestet midis palëve. Këto arbitrazhe kanë organet e veta, dhe atë sipas rregullit, listën e arbitrave, kryesinë, sekretarin e arbitrazhit, aparatit administrativ. Pranë këtyre arbitrazheve krijohet dhe formohet praktika e caktuar e arbitrazhit nga vendimet që i sjell ajo gjykatë, ashtu që palët e ardhshme në procedurën e arbitrazhit mundën që në njëfarë mënyre të jenë të njoftuara me praktikën e asaj gjykate në raport me kontestin i cili zgjidhet para arbitrazhit.

Ad hoc arbitrazhet janë arbitrazhe të përkohshme të cilat krijohen për zgjidhjen e kontestit të caktuar dhe në momentin kur vendoset për kontestin i cili është paraqitur para tyre ato pushojnë të funksionojnë. Me qëllim që edhe para këtyre gjykatave të arbitrazhit të mund të unifikohen rregullat sipas të cilave udhëhiqen procedurat e arbitrazhit, Këshilli i Përgjithshëm i KB më 1986. sjell rezolutën për rregullat e arbitrazhit me titull: Rregullat e arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën tregtare ndërkombëtare – UNCITRAL Rregullat për arbitrazhin.

Sipas llojit të kontesteve, dallojmë: arbitrazhet e përgjithshme dhe të specializuara. Arbitrazhet e përgjithshme zgjidhin të gjitha llojet e kontesteve. Për këtë lloj të arbitrazheve është e mjaftueshme të thuhet se para tyre zgjidhen të gjitha llojet e kontesteve pavarësisht nga specifikat dhe objekti i kontestit.

Arbitrazhet e specializuara zgjidhin kontestet e përcaktuara nga fusha tregtare. Ato janë të zhvilluara në lëmi të caktuar tregtarë, në të shumtën janë të organizuara si arbitrazhe institucionale pranë odave të ndryshme tregtare. Përparësitë e arbitrazheve të specializuara qëndrojnë në faktin se si arbitra në ta, marrin pjesë persona të specializuar për konteste të caktuara.

Sipas asaj se kontestet e kujt i zgjidhin, dallojmë: arbitrazhet ndërkombëtare dhe nacionale ose kombëtare.

Arbitrazhet ndërkombëtare janë ato në të cilat zgjidhen kontestet ndërkombëtare, pra në procedurë marrin pjesë palët të cilat kanë vendbanimin ose selinë në shtete të ndryshme në momentin e lidhjes së marrëveshjes për arbitrazhin. Me qëllim të unifikimit të rregullave sipas të cilave udhëhiqet procedura, në rradhë të parë para arbitrazhës institucionale ndërkombëtare, Komisioni i KB-së për të drejtën tregtare ndërkombëtare më 1985. ka sjell Model-Ligjin UNCITRAL për arbitrazhin tregtar ndërkombëtare.

Arbitrazhet nacionale (kombëtare, të vendit) janë ato të cilat në procedurën e arbitrazhit zgjidhin kontestet midis palëve të cilat i takojnë të njejtit shtet, përkatësisht kanë selinë në shtetin e njejtë në të cilin zhvillohet arbitrazhi. Sipas rregullit formohen pranë odave ekonomike të shteteve të veçanta, kanë arbitra nga vendi, zbatojnë të drejtën materiale dhe procedurale të vendit.

### **3. Karakteristikat kryesore të arbitrazhit**

Njëra ndër karakteristikat kryesore të arbitrazhit është mundësia e zgjedhjes së arbitrit (arbitrave) nga vetë palët. Palët i zgjedhin vetë arbitrat dhe atë qoftë drejtëpërdrejtë, qoftë përmes emërimit të të autorizuarit për emërimin e arbitrave. Në këtë mënyrë vjen në shprehje ndikimi i rëndësishëm i palëve lidhur me atë se kush do jetë arbitër/arbitra në kontestin e tyre, të cilët gëzojnë besimin e palëve dhe paraqesin persona të specializuar për lëndën e kontestit që është shtruar për zgjidhje.

Karakteristikë tjetër e rëndësishme e arbitrazhit është mundësia e zgjedhjes së të drejtës materiale nga vetë palët. Pra, palët vetë përcaktojnë se cila e drejtë materiale do të zbatohet në zgjidhjen e kontestit të tyre, mbase dhe kjo paraqet një nga shkaqet e zgjedhjes së arbitrazhit, si mënyrë për zgjidhjen e kontesteve, e jo rrugës gjyqësore.

Me rëndësi është të theksojmë që palët mundën të vendosin edhe për të drejtën procedurale e cila do të shfrytëzohet në procedurën e arbitrazhit.<sup>124</sup>

Njëra ndër karakteristikat e rëndësishme të arbitrazhit është gjithsesi njëshkallshmëria, dhe vetëm përjashtimisht, dhe pse shumë rrallë, për procedurën e arbitrazhit parashihet dyshkallshmëria.

Jopubliciteti i gjykimit gjithsesi paraqet një nga shkaqet mjaft të rëndësishme pse palët i drejtohen arbitrazhit kur zgjidhin kontestet mes tyre. Aq më tepër, edhe vetë shpallja e vendimeve të gjykatës së arbitrazhit, në rradhë të parë kur është fjala për arbitrazhet e institucionalizuara, mund të realizohet vetëm me pajtimin shprehimor të palëve dhe me lejen e kryetarit të asaj gjykate të arbitrazhit.

Procedura e arbitrazhit zhvillohet pa ndërhyrjen e organeve shtetërore dhe gjykatës shtetërore, ose së paku ndërhyrja e tyre është minimale. Andaj, palët duke dashur që ti ikin intervenimit të organeve shtetëror ose gjykatës shtetërore zgjedhin arbitrazhën. Mundësitë e ndërhyrjes së gjykatës në procedurën e arbitrazhit janë sjellë në minimum, dhe kanë të bëjnë

---

<sup>124</sup> Pra, edhe në këtë drejtim vjen në shprehje autonomia e vullnetit të palëve të cilat p.sh. mund të përcaktohen për rregullore të caktuara të cilat zbatohen në procedurat para arbitrazheve të caktuara dhe atë para se gjithash para arbitrazhave institucionale, etj.



kryesisht me ndëgjimin e palëve, anulimin e vendimit të arbitrazhit, shumë rrallë emërimin e gjyqtarit të gjykatës shtetërore për arbitër, etj.

Karakteristikë tjetër e arbitrazhit është ekzistimi i raportit të kooperimit midis palëve. Nuk ka arbitrazhë pa marrëveshjen e palëve, e cila patjetër të jetë me shkrim. Palët kur zgjedhin arbitrazhën si mënyrë për zgjidhjen e kontestit mes tyre, ata janë të vetëdijshëm se ‘‘secila nga palët nuk do të humb gjithçka, por as që do të fitoj gjithçka’’. Nga ana tjetër, kur zgjedhin arbitrazhën palët janë të sigurt që kontesti mes tyre do të zgjidhet nga gjyqtarë të specializuar, të besuar, që vendimi do të silltet shpejtë, e sipas rregullit, kundër këtij vendimi nuk mund të ngrihet ankesë, që procedura do jetë e fshehtë, etj.

Siç përmendëm dhe më lartë, njëra ndër karakteristikat e rëndësishme të arbitrazhës padyshim është shpejtësia e procedimit. Pikërisht ngadalësia e gjykatave shtetërore, e cila është karakteristike dhe e përbashkët për shumë sisteme juridike botërore, ka sjellë nevojën për shmangien e të njejtave dhe zgjedhjen e mënyrave tjera alternative të zgjidhjes së kontesteve, pra dhe të arbitrazhit. Arbitrazhi ofron mënyrë të shpejtë të zgjidhjes së kontesteve, pa formalitete të shumta me çka dhe shpenzimet janë më të vogla.

Në procedurën e arbitrazhit, marrin pjesë gjyqtarë të cilët posedojnë njohuri më të mëdha profesionale për zgjidhjen e kontesteve të caktuara. Specializimi i gjyqtarëve për zgjidhjen e kontesteve të veçanta paraqet garancion që vendimi do jetë i drejtë, gjë që gjithsesi ndikon në respektimin e vendimit të tillë nga palët të cilët dhe paraprakisht pranojnë që vendimi i tillë të njihet si aktgjykim plotfuqishëm gjyqësor.

## **I.ARBITRAZHI NE REPUBLIKEN E KOSOVES**

### **1. Kornizat ligjore të rregullimit të arbitrazhit në Republikën e Kosoves**

E drejta kroate e arbitrazhit deri në sjelljen e Ligjit përi arbitrazhin (LA) është përmbajtuar pjesërisht në Ligjin për procedurën kontestimore, pjesërisht në Ligjin për zgjidhjen e koalicionit të ligjeve me rregullat e shteteve të tjera në marrëdhëniet e caktuara të vitit, si dhe në aktet normative të Gjykatës së Përhershme të arbitrazhit.

Me sjelljen e LA për here të parë bëhet kodifikimi i tërësishëm dhe i pavarur i materies e cila ka të bëjë me arbitrazhin. LA është hartuar sipas shembullit të Model ligjit UNCITRAL (Komisioni i KB për të drejtën ndërkombëtare tregtare) dhe Konventës së Nju jorkut mbi

njohjen dhe përmbarimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit nga viti 1958. Në këtë mënyrë dispozitat e LA janë harmonizuar me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Burimet të së drejtës së arbitrazhit i përbëjnë ligjet e brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që janë në fuqi. Kështu, rregullimi juridik i arbitrazhit bazohet në:

1. Aktet ligjore:

- Ligji për arbitrazhin
- Ligji për ndërmjetësimin .

2. Rregulloret:

- Rregullorja e Gjykatës së përhershme të arbitrazhit pranë Odës ekonomike
- Rregullorja për arbitrazhin pranë Gjykatës së Përhershme të arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës.

3. Vendimet:

- Vendimi mbi shpenzimet në procedurën e arbitrazhit dhe ndërmjetësimin

4. Marrëveshjet ndërkombëtare:

- Konventa për njohjen dhe përmbarimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit
  - Konventa e Njujorkut, e vitit 1958,
- Konventa Evropiane për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, e vitit 1961,
- Konventa për zgjidhjen e kontesteve investive ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve tjera - Konventa e Vashingtonit, e vitit 1965,
- UNCITRAL Model ligji për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, i viti 1985.

5. Marrëveshjet për bashkëpunim (bilaterale)

## **2. Nocionet themelore dhe llojet e arbitrazhit**

Me LA rregullohet: arbitrazhi i vendit, njohja dhe përmbarimi i vendimeve të arbitrazhit, kompetenca dhe veprimet e gjykatës në lidhje me arbitrazhin e vendit si dhe në rastet e tjera të parapara me ligj. LA përcaktohet: nocioni dhe llojet e arbitrazhit, marrëveshja për arbitrazhin, kompetenca e gjykatës së arbitrazhit, gjykata e arbitrazhit, procedura e arbitrazhit, vendimi i arbitrazhit, mjetet juridike kundër vendimit të arbitrazhit, njohja dhe përmbarimi i vendimit, çështjet e përcaktimit dhe kufijve të arbitrabilitetit, çështjet e përcatimit të së drejtës e cila do zbatohet lidhur me lëndën e kontestit.

LA përcakton nocionet themelore mbi arbitrazhin<sup>125</sup> sipas nocioneve ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar. Ashtu, në kuptimin e LA “arbitrazhi” është gjykim para gjykatës së arbitrazhit, pavarësisht nëse ajo organizohet nga institucioni për arbitrazhë ose jo. Pra, LA i përcakton rregullat e veprimit të arbitrazhit, pavarësisht nëse ajo është e organizuar si institucion i përhershëm ose jo, dhe vetëm nga palët do varet nëse do zgjedhin arbitrazhin e institucionalizuar apo do të vendosin të formojnë ad hoc arbitrazhin për zgjidhjen e kontesteve të tyre.

Arbitrazhi i vendit (nacional, kombëtar) është arbitrazhi i cili e ka selinë në R. e Kosovës. Gjykata e arbitrazhit është gjykatë joshtetërore e cila kompetencën për arbitrazhë e nxjerr nga marrëveshja e palëve.

Institucioni për arbitrazhë është person juridik ose organ i personit juridik i cili organizon dhe siguron veprimtarinë e gjykatave të arbitrazhit. Arbitri është arbitër i vetëm (individual) ose anëtar, përkatësisht kryetar i këshillit të arbitrazhit.

Kontesti pa element ndërkombëtar (të huaj) është kontest në të cilin palët janë persona fizik me vendbanim ose vendqëndrim të përhershëm në vend, respektivisht persona juridik të cilët janë themeluar sipas të drejtës së R. së Kosovës.

Kontesti me element ndërkombëtar (të huaj) është kontest në të cilin së paku njëra nga palët është person fizik me vendbanim ose vendqëndrim të përhershëm në shtetin e huaj, respektivisht person juridik i cili është themeluar sipas së drejtës së huaj. Me këtë, LA pranon metodën e “identitetit (nacionalitetit) të palëve”, për përcaktimin e nocionit të elementit ndërkombëtar.

Vendimi i arbitrazhit është vendim i gjykatës së arbitrazhit për meritumin e kontestit. Vendimi përfundimtar i arbitrazhit është vendim me të cilin vendoset për bazën dhe lartësinë e kërkesës.

Gjykata është organ shtetëror i pushtetit gjyqësor. Ndërmjetësues është personi i cili në bazë të marrëveshjes së shkruar të palëve zbaton procedurën e veçantë të ndërmjetësimit.

Siç shihet, LA i pranon udhëzimet e përgjithshme për arbitrazhin karakteristike sipas të drejtës ndërkombëtare.

### **3. Arbitrabiliteti**

Me arbitrabilitet nënkuptojmë përshtatshmërinë e kontestit të caktuar për tu zgjidhur përmes arbitrazhit. Arbitrabiliteti i ndonjë kontesti ka kuptimin e mundësisë që palët me

---

<sup>125</sup> Neni 2. paragraf. 1-3. i LA.

vullnetin e vet ta përjashtojnë atë nga sfera e jurisdikcionit shtetëror. Lidhur me arbitrabilitetin, në doktrinën juridike dallohen më tepër lloje të tij, dhe atë:

-arbitrabiliteti *ratione materiae*- i cili jep përgjigje në pyetjen se cilat konteste mund të paraqiten para arbitrazhit;

-arbitrabiliteti *ratione personae*- i cili jep përgjigje në pyetjen se cilat palë mund të paraqesin kontestet e tyre para arbitrazhit;

-arbitrabiliteti *ratione territorii*- i cili jep përgjigjen në pyetjen se para cilës gjykatë të arbitrazhit, asaj të vendit apo dhe asaj ndërkombëtare, mund të parashtohet kontesti i caktuar;

-arbitrabiliteti *ratione institutionis*- i cili i përgjigjet pyetjes nëse kontesti i caktuar mund të paraqitet vetëm para arbitrazhit institucional (dhe nën cilat kushte), apo dhe para ad hoc arbitrazhit.<sup>126</sup>

Sipas LA, palët mund të kontraktjnë arbitrazhën e vendit për zgjidhjen e kontesteve lidhur me të drejtat me të cilat munden lirisht të disponojnë, pavarësisht nëse bëhet fjalë për arbitrazhin e institucionalizuar ose ad hoc arbitrazhin. Në kontestet me element të huaj, palët mund të kontraktjnë edhe arbitrazhin, vendi i të cilës ndodhet jashtë territorit të Republikës së Kosovës, përveç nëse me ligj të veçantë është përcaktuar se kontesti i tillë mund të zgjidhet vetëm përpara gjykatës në Republikën e Kosovës.

Nga këto dispozita del se arbitrazhi mund të zgjedhet nëse lënda e kontestit është disponibile, përkatësisht, nëse bëhet fjalë për konteste lidhur me të drejtat me të cilat palët munden lirisht të disponojnë. Pra, sipas LA, disponibiliteti i kontestit është presupozim për arbitrabilitetin si në kontestet me element të huaj ashtu edhe në ato pa element të huaj,

Për kontraktimin e arbitrazhit në territorin e R. së Kosovës, përveç disponibilitetit të kontestit nuk kërkohet përmbushja e ndonjë kushti tjetër. Mirëpo, për kontraktimin e arbitrazhit të huaj, LA parasheh parakushte shtesë. Kështu, sipas LA, arbitrazhi, vendi i së cilës gjendet jashtë territorit të R. së Kosovës, mund të kontraktohet vetëm nëse, krahas disponibilitetit të kontestit, përmbushen dhe dy kushte: kontesti të ketë element të huaj në vete, dhe kontesti nuk duhet të bjerrë në kompetencën ekskluzive të gjykatave në R. e Kosovës.

Si konkluzion mund të thuhet që me LA është pranuar parimi themelor sipas të cilit objekte të arbitrazhit mund të jenë vetëm ato marrëveshje dispozitive të palëve, lidhur me të

---

<sup>126</sup> Uzelac, A. "Nove granice arbitrabilnosti prema Zakonu o arbitrazhi", Deveti hrvatski arbitrazhni dani: "Harmonizacija arbitrazhnog prava i prakse: svjetski, regionalni i nacionalni izazovi", Zagreb, 2001.

cilit shteti nuk ka rezervuar kompetencën ekskluzive (psh. kontestet nga marrëdhëniet familjare nuk mund të jenë objekt i gjykimit nga arbitrazhi).

#### **4. Marrëveshja për arbitrazhin**

Marrëveshja për arbitrazhin është marrëveshje me të cilën palët i nënshtrojnë arbitrazhit të gjitha ose vetëm konteste të caktuara të cilët janë paraqitur, ose mund të paraqiten midis tyre nga marrëdhënia e caktuar juridike, kontraktuese ose jokontraktuese.<sup>127</sup> Pra, marrëveshja për arbitrazhin paraqet marrëveshje midis palëve të cilat pajtohen që kontestet eventuale mes tyre, apo kontestet të cilat tashmë ekzistojnë midis tyre t'i zgjidhin përmes arbitrazhës institucionale ose ad hoc arbitrazhës.

Kompetenca e arbitrazhit për zgjidhjen e kontestit mund të kontraktohet menjëherë gjatë lidhjes së marrëdhënies së caktuar juridike, pra, para lindjes së kontestit, ose dhe pasi lind kontesti.<sup>128</sup>

Me marrëveshjen për arbitrazhin përjashtohet kompetenca e gjykatës shtetërore, ndërkaq kontesti i cili mund të paraqitet ose i cili tanimë është paraqitur i jepet për zgjidhje arbitrit ose arbitrave të cilët sjellin vendim në procedurën e arbitrazhit.

Lidhja e marrëveshjes për arbitrazhin mund të bëhet në dy mënyra: me marrëveshje (kontratë) për arbitrazhin dhe si klauzolë për arbitrazhin. Marrëveshja për arbitrazhin lidhet pas lindjes së kontestit dhe paraqet kontratë të pavarur për gjykim përmes arbitrazhit. Klauzola për arbitrazhin, lidhet para paraqitjes së kontestit, qoftë si kontratë e pavarur qoftë si pjesë përbërëse e ndonjë kontrate kryesore juridike.

Marrëveshja (kontrata) për arbitrazhin dhe klauzola për arbitrazhin domosdo të lidhen në formë të shkruar, sepse vetëm forma e tillë siguron vlefshmërinë e marrëveshjes për arbitrazhin. Sipas LA, marrëveshja për arbitrazhin është e lidhur në formë të shkruar nëse është futur në dokumentet të cilat i kanë nënshkruar palët ose nëse është lidhur përmes letërkëmbimin midis palëve, telefaks, ose çfarëdo mjeti tjetër komunikues i cili dëshmon ekzistimin e tij pavarësisht nëse i kanë nënshkruar palët. Aq më tepër, LA në mënyrë shprehimore parasheh dhe rastet tjera kur konsiderohet që marrëveshja për arbitrazhin është lidhur në formë me shkrim.

Zotësia e personave fizik, juridik dhe personave të tjerë për të lidhur marrëveshjen për arbitrazhin si dhe për të qenë palë në kontestin para gjykatës së arbitrazhit, vlerësohet sipas të drejtës kompetente e cila zbatohet ndaj tyre. Sipas LA, përveç personave fizik dhe juridik,

---

<sup>127</sup> Neni 6. paragraf. 1 i LA.

<sup>128</sup> Para lidhjes së marrëveshjes për arbitrazhin është me rëndësi që të përcaktohet zotësia e palëve për lidhjen e marrëveshjes për arbitrazhin, autorizimet e përfaqësuesve dhe çështja e arbitrabilitetit të kontestit.

marrëveshje për arbitrazhin mund të lidhin dhe mund të jenë palë në kontestin para gjykatës së arbitrazhit edhe Republika e Kosovës, si dhe njësitë e vetqeverisjes lokale dhe rajonale.

Marrëveshja për arbitrazhin përbëhet prej dy pjesëve: pjesës së obligueshme dhe pjesës fakultative. Në pjesën e obligueshme të marrëveshjes për arbitrazhin duhet shprehur qartë vullnetin e palëve që përmes gjykatës së caktuar të arbitrazhit të zgjidhin një ose më tepër konteste të cilat mund të lindin në të ardhmen ose të cilat tanimë janë paraqitur nga marrëdhënia juridike e caktuar.

Në pjesën fakultative të marrëveshjes për arbitrazhin përfshihen rregullat lidhur me procedurën e arbitrazhit, veçanërisht për zbatimin e të drejtës së huaj materiale, rregullat lidhur me selinë e këshillit të arbitrazhës, rregullat lidhur me emërimin e gjyqtarëve të arbitrazhit, rregullat lidhur me avansimin e shpenzimeve, etj.

Shumë nga këto elemente të cilat, në rast të arbitrazhit institucional, konsiderohen si fakultative në marrëveshjen për arbitrazhin, bëhen të obligueshme kur flitet për ad hoc arbitrazhën. Kjo është e kuptueshme, nëse merret parasysh fakti që arbitrazhet institucionale kanë të rregulluara një sërë elementesh me vetë krijimin institucional të tyre, pastaj ata sipas rregullit përmbajnë dhe klauzola të gatshme për arbitrazhin të cilat inkorporohen lehtë në kontratat që i lidhin palët, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kompetencën e asaj gjykate të arbitrazhit.

Marrëveshja për arbitrazhin mund të përfundoj në më tepër mënyra varësisht nga shkakut i përfundimit. Kështu, palët në çdo moment mund të merren vesh për përfundimin e marrëveshjes për arbitrazhin dhe atë si para procedurës, gjatë zhvillimit të procedurës së arbitrazhit, pas kërimit të anulimit të vendimit të arbitrazhit, pra gjithnjë derisa vendimi i arbitrazhit nuk bëhet i plotfuqishëm.

Marrëveshja për arbitrazhin do të pushoj kur të përmbushet qëllimi i saj, pra, kur të sillet vendimi, vendimi i pjesshëm, etj.

Marrëveshja për arbitrazhin do të përfundoj edhe atëherë kur ekziston ndonjë mangësi e caktuar gjatë procedurës së arbitrazhit (psh. nëse në kohë nuk emërohet arbitri, nëse ekzistojnë rrethana të cilat e pamundësojnë arbitrin të udhëheq me procedurën, nëse gjatë procedurës së arbitrazhit për objektin e kontestit tanimë është sjellë vendim nga gjykata shtetërore, etj).

## **5. Gjykata e arbitrazhit**

### **a) Emërimi, të drejtat dhe detyrat e arbitrave**

Në qoftë se nuk ekziston marrëveshja midis palëve lidhur me numrin e arbitrave, atëherë emërohen tre arbitra. Edhe këtu vjen në shprehje parimi i autonomisë së vullnetit të palëve, ashtu që vetëm në mungesë të marrëveshjes së palëve vijnë në shprehje rregullat e parapara me këtë ligj.

Veçori specifike e cila parashihet me LA, është mundësia e zgjedhjes së gjyqtarëve të gjykatave të R. së Kosoves si arbitra, por vetëm si kryetarë të këshillit të arbitrazhit ose si arbitra të vetëm. Por, zgjedhja e gjyqtarëve si arbitra në praktikë është e rrallë.

Palët mund të merren vesh lidhur me procedurën e emërimit të arbitrave, e nëse nuk arrihet marrëveshje atëherë LA përcakton procedurën e emërimit. Kështu, tek arbitrazhi i cili përbëhet prej tre arbitrave, secila nga palët emëron nga një, ndërkaq këta dy emërojnë të tretin i cili do jetë kryetar i këshillit të arbitrazhit. Në qoftë se palët, ose dhe dy arbitrat brenda afatit prej 30 ditëve nga thirrja që të emërojnë arbitra nuk e bëjnë një emërim të tillë, atëherë emërimin me kërkesën e palëve do ta kryej i autorizuari për emërim. Kur arbitrazhin e udhëheq arbitri i vetëm, nëse palët nuk arrijnë të merren vesh, arbitrin e vetëm me kërkesë të palëve e emëron i autorizuari për emërim, i cili gjatë emërimit duhet të mbajë llogari për kualifikimet e arbitrave të cilat kërkohen në bazë të marrëveshjes së palëve, si dhe për gjithë atë që ka të bëjë me sigurimin e emërimit të arbitrit të pavarur dhe paanshëm, ndërsa në kontestet me element të huaj është e dëshirueshme që për arbitër të vetëm ose kryetar të këshillit të arbitrazhit të emërohet personi i cili ka shtetësi tjetër nga palët në kontest. Lidhur me vendimin e të autorizuarit për emërim, nuk lejohet ankesa.

Arbitri i emëruar jep deklaratën me shkrim për pranimin e detyrës, të cilën mund ta kryej edhe me nënshkrimin e marrëveshjes së palëve për arbitrazhin. Arbitrat duhet të zhvillojnë arbitrazhën me shpejtësi të përshtatshme duke iu shmangur çfarëdo zgjatjeje të panevojshme të procedurës, përndryshe, palët kanë mundësi që me marrëveshje të revokojnë arbitrin i cili lëshon ose zvarrit kryerjen e detyrave të veta.

Arbitrat kanë të drejtë në kompenzimin e shpenzimeve dhe shpërblim për punën e kryer, përveç nëse shprehimisht kanë hequr dorë nga këto të drejta.

Arbitrat mundën edhe të përjashtohen. Kështu, sipas LA, përjashtimi i arbitrit mund të kërkohet nëse ekzistojnë rrethana të cilat e bëjnë të arsyeshëm dyshimin për pavarësinë dhe paanshmërinë ose nëse arbitri nuk posedon kualifikimet e nevojshme për të cilat palët janë marrë vesh. Nëse arbitri, përjashtimi i të cilit kërkohet, nuk tërhiqet, ose nëse pala tjetër nuk pajtohet me kërkesën për përjashtimin e tij, vendimin për përjashtimin e tij pa vonesë e sjell gjykata e arbitrazhit, në përbërjen e të cilit merr pjesë dhe arbitri, përjashtimi i të cilit kërkohet. Në rast se kërkesa për përjashtim të arbitrit nuk ka sukses, palës i mbetet që në afat

të caktuar të kërkoj nga i autorizuari për emërim të sjell vendimin për përjashtim, dhe kjo nuk e ndalon zhvillimin e procedurës së arbitrazhit, e aq më tepër mund të sillet edhe vendimi i arbitrazhit pavarësisht se akoma nuk ka është sjell vendimi për përjashtimin e arbitrit.

Nëse për shkaqe juridike ose fizike, arbitrit i pamundësohet të kryej detyrat e veta, ai mund të tërhiqet vetë ose palët me marrëveshje të kërkojnë përfundimin e mandatit të tij. Në raste të tilla, arbitrin e zëvendëson zëvendësuesi i arbitrit.

#### **b) Kompetenca e gjykatës së arbitrazhit**

Gjykata e arbitrazhit mund të vendos për kompetencën e vetë, si dhe për çdo kundërshtim lidhur me ekzistimin ose vlefshmërinë e kontratës për arbitrazhin.

Kundërshtimin se gjykata e arbitrazhit nuk është kompetente, i padituri më së voni e paraqet kur paraqet përgjigjen në padi. Kundërshtimi se gjykata e arbitrazhit tejkalon kufirin e autorizimeve të veta, duhet të paraqitet menjëherë kur lënda, për të cilën pretendohet se e tejkalon kufirin e autorizimeve të gjykatës, paraqitet në procedurën e arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit, në të dyja rastet mund të lejoj paraqitjen e kundërshtimit edhe më vonë, nëse konsideron se vonesa është e arsyeshme. Kur vendos lidhur me kundërshtimet e lartpërmendura, gjykata e arbitrazhit mund të vendos si për çështjen paraprake ose në vendimin për meritumin e kontestit. Nëse gjykata e arbitrazhit vendos si për çështjen paraprake se është kompetente, palët mundën në afat prej 30 ditëve të kërkojnë nga gjykata kompetente të vendos lidhur me këtë çështje në procedurë të shpejtë.

#### **6. Procedura e arbitrazhit**

Procedura e arbitrazhit paraqet stadin qendror të institutit të arbitrazhit si tërësi. Procedura e arbitrazhit është paraparë në kreu e katërt, nenet 17-26, të LA.

Zgjidhja e procedurës së arbitrazhit varet nga dy faktorë, dhe atë: vullnetit të palëve dhe llojit të arbitrazhit i cili do zgjidh kontestin konkret. Parimi i autonomisë së vullnetit të palëve është faktor dominues. Vetëm nëse palët me vullnetin e tyre nuk i rregullojnë, përkatësisht, përcaktojnë rregullat e procedurës, procedura do të varet nga lloji i arbitrazhit. Në rast të ad hoc arbitrazhit, arbitrat janë ata të cilët do të përcaktojnë rregullat e procedurës së arbitrazhit, dhe atë në mënyrën të cilën e konsiderojnë më të përshtatshme për zgjidhjen e kontestit konkret. Kur bëhet fjalë për arbitrazhën institucionale, kontesti do të zgjidhet sipas



rregullave paraprakisht të përcaktuara, më së shpeshti në rregulloren e punës, të gjykatës së arbitrazhit kompetent.<sup>129</sup>

Përveç parimit të autonomisë së vullnetit të palëve, parime të tjera të rëndësishme të arbitrazhit janë: parimi i kontradiktorialitetit, parimi i konfidencialitetit, parimi i ekonomisë së procedurës, etj.

Palët në procedurën e arbitrazhit janë të barabarta. Palët mund të merren vesh për vendin e arbitrazhit, e nëse nuk merren vesh, atëherë vendin e arbitrazhit e përcakton gjykata e arbitrazhit duke mbajtur llogari për rrethanat e kontestit dhe përshtatshmërisë së vendit për palët. Nëse vendi i arbitrazhit nuk përcaktohet në asnjërën nga mënyrat e përmendura, merret që vendi i arbitrazhit është ai vend i cili është shënuar në vendimin e arbitrazhit si vend i sjelljes së tij.

Sipas rregullit, palët vetë vendosin se cila e drejtë materiale do të zbatohet në zgjidhjen e kontestit të tyre. Nëse palët nuk vendosin, atëherë arbitrazhi vendos se cila e drejtë materiale do të zbatohet në rastin konkret.

Veçori specifike e zgjidhjes së kontesteve nga arbitrazhi gjithsesi paraqet e drejta e palëve të kontraktajnë që zgjidhja e kontestit të tyre të bëhet sipas parimit të drejtshmërisë (ex aequo et bono). Kjo rregull nuk do të thotë ndarje totale nga e drejta, pra, rregullat të cilat kanë të bëjnë me rendin publik si dhe ato imperative këtu paraqiten si një lloj faktori korrektues.

Procedura e arbitrazhit fillon ose kur institucioni i arbitrazhit pranon padinë, ose, në rast të ad hoc arbitrazhës, me ditën kur i padituri pranon njoftimin se pala kundërshtarë ka emëruar arbitrin ose ka propozuar arbitrin e vetëm, ose në thirrjen e saj që të emëroj arbitrin tjetër, ose të deklarohet lidhur me arbitrin e vetëm të propozuar, si dhe me padinë me të cilën kontesti parashtrohet para gjykatës së arbitrazhit.

Palët mund të merren vesh për gjuhën ose gjuhët në të cilën do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Nëse një marrëveshje të tillë nuk ka, gjykata e arbitrazhit do të vendos se në cilën ose cilat gjuhë do të zhvillohet procedura. Deri në zgjedhjen e gjuhës, të gjitha shkresat (padija, përgjigja në padi dhe shkresat e tjera), mund të dorëzohen në gjuhën e kontratës kryesore, gjuhën e marrëveshjes për arbitrazhin.

Nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, gjykata do të vendos nëse do të caktoj dhe mbajë shqyrtimin për nxjerrjen e provave ose për shkak të shqyrtimit gojor, ose procedura do të zhvillohet në bazë të dokumenteve.

---

<sup>129</sup> Supozohet që palët të cilat i'a besojnë kontestin për zgjidhje gjykatës së caktuar institucionale, pajtohen me rregullat procedurale të cilat i ka përcaktuar ai arbitrazhi.

Palët duhet të njoftohen me kohë për çdo seancë ose takim të gjykatës së arbitrazhit. Secila nga palët duhet të njoftohet për veprimet e palës tjetër, si dhe tu dërgohet çdo raport i ekspertit ose dokument provues mbi të cilin gjykata e arbitrazhit do mund të bazonte vendimin. Dëshmitarët, sipas rregullit, dëgjohe në shqyrtimin kryesor, dhe atë pa betim, por, nëse ata pajtohen, mund të dëgjohe edhe jashtë shqyrtimit kryesor, ndërsa gjykata e arbitrazhit mund të kërkoj që dëshmitarët në afatin e caktuar të deklarohen me shkrim lidhur me pyetjet e caktuara.

Gjykata e arbitrazhit mund të angazhoj ekspertë. Ekspertët janë të detyruar, nëse kjo është e nevojshme, të marrin pjesë edhe në seancë të procedurës së arbitrazhit.

Ndaj dëshmitarëve, palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, gjykata e arbitrazhit nuk mund të përdor mjetet detyruese dhe as të shqiptoj dënime.

Në procedurën e arbitrazhit pala mund të kërkoj përcaktimin e masave të përkohshme për sigurimin e kërkesave dhe kërkesa e tillë nuk është në kundërshtim me marrëveshjen për arbitrazhin.

Në qoftë se palët nuk merren vesh ndryshe, procedura e arbitrazhit nuk është publike.

## **7. Vendimi i arbitrazhit dhe përfundimi i procedurës**

Vendimi i arbitrazhit ka fuqinë e aktgjykimit të plotfuqishëm gjyqësor midis palëve, nëse me marrëveshje nuk është paraparë mundësia e goditjes së tij.

Në të shumtën e rasteve procedura e arbitrazhit përfundon me sjelljen e vendimit të arbitrazhit. Pasi ky vendim i arbitrazhit prodhon efekte të vendimit të plotfuqishëm midis palëve, sipas rregullit, kundër tij nuk lejohet ankesa. Në fund të procedurës së arbitrazhit mund të sillen edhe vendimi i pjesshëm, i ndërmjetshëm, i përkohshëm e sigurisht dhe vendimi përfundimtar.

Nëse palët gjatë procedurës së arbitrazhin merren vesh të lidhin pajtim për kontestin, gjykata e arbitrazhit me kërkesën e tyre do ndal procedurën, përveç nëse palët kërkojnë që në bazë të pajtimit të sillen vendimi i arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit do pranoj të sjell vendim në bazë të pajtimit, vetëm nëse përmbajtja e pajtimit nuk është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Kosovës. Vendimi i sjellë në bazë të pajtimit ka fuqinë juridike dhe efektet e vendimit të arbitrazhit.

Procedura e arbitrazhit, përveç se me vendimin përfundimtar, mund të përfundoj edhe me sjelljen e urdhërit të gjykatës së arbitrazhit, edhe atë në rastet kur: paditësi tërheq padinë, përveç nëse i padituri e kundërshton këtë, ndërkaq gjykata e arbitrazhit konsideron se është i arsyeshëm interesi juridik i të paditurit të sillen vendimi përfundimtar lidhur me kontestin; kur

palët merren vesh për përfundimin e procedurës; kur gjykata e arbitrazhit gjen që vazhdimi i procedurës për shkaqe të tjera është i panevojshëm ose i pamundshëm.

Vendimi i arbitrazhit patjetër të jetë në formë të shkruar. Vendimi duhet të arsyetohet, përveç nëse palët janë marrë vesh që arsyetimi nuk është i nevojshëm. Arsyetimi i vendimit është i rëndësishëm për arsye të praktikës gjyqësore të gjykatës së caktuar institucionale të arbitrazhit, por dhe për shumë arsye të tjera, pasi zgjidhjet e ndryshme të një gjykate institucionale mund të jenë shkak për vendosjen e palëve potenciale në procedura të ngjajshme, për zgjidhjen e kontestit të tyre pikërisht pranë asaj arbitrazhe. Në vendimin e arbitrazhit duhet të shënohet dita dhe vendi i sjelljes.

Vendimi i arbitrazhit sillet me shumicë të votave, nëse me marrëveshjen për arbitrazhin nuk është paraparë ndryshe. Nëse arbitrat nuk kanë mundur të sjellin vendimin me shumicë votash, atëherë rishtaz do të shqyrtohen shkaqet për çdo mendim veçmas, dhe nëse edhe pas kësaj nuk arrihet shumica e votave, vendimin do ta sjell kryetari i këshillit.

Kryetari i këshillit të arbitrazhit, jashtë seancës së këshillit, mund të vendos për të gjitha çështjet e udhëheqjes së procedurës, nëse kjo nuk është në kundërshtim me marrëveshjen e palëve ose me vendimin e këshillit.

Vendimin e nënshkruan arbitri i vetëm, si dhe të gjithë ose së paku shumica e arbitrave që kanë marrë pjesë në votim, me atë që në rastin e fundit duhet të shënohet mosdhënija e nënshkrimit të arbitrit.

Dërgimin e vendimit të arbitrazhit, kur është fjala për arbitrazhin institucionale, e bën vetë institucioni, ndërsa në rastet tjera vetë gjykata e arbitrazhit. Me marrëveshjen e palëve, dërgimi i vendimit të arbitrazhit mund të bëhet edhe përmes gjykatës shtetërore ose noterit.

Pas pranimit të vendimit, nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, secila nga palët në afat të caktuar mund të kërkojë nga gjykata e arbitrazhit sjelljen e vendimit plotësues për kërkesat të cilat janë paraqitur në procedurën e arbitrazhit, ndërkaq gjykata e arbitrazhit nuk ka vendosur për to në vendimin e saj. Palët, gjithashtu kanë të drejtë, që në afat të caktuar pas pranimit të vendimit të arbitrazhit, të kërkojnë nga gjykata e arbitrazhit që të përmirësohen gabimet në të shkruarit e vendimit, si dhe të kërkojnë nga gjykata e arbitrazhit interpretimin e vendit të caktuar ose të pjesës së vendimit.

Me kërkesën e palës, gjykata e arbitrazhit në vendimin e vet vendos edhe lidhur me atë se cila palë dhe në çfarë vëllimi është e detyruar ti kompenzojë palës tjetër shpenzimet e procedurës, duke përfshirë dhe shpenzimet e përfaqësimit dhe shpërblimet e arbitrave, si dhe shpenzimet e veta. Gjykata e arbitrazhit lidhur me shpenzimet e procedurës vendos sipas

vlerësimit të lirë, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e veçanërisht rezultatin e procedurës së arbitrazhit.

Vendimet e arbitrazhit nuk publikohen, e nëse ndodh që të publikohen kjo bëhet pa shënimin e palëve në procedurë dhe vetëm me lejen e tyre.

Vendimi i arbitrazhit prodhon efekt res iudicata, me kusht që palët në marrëveshjen për arbitrazhin nuk kanë paraparë mundësinë e goditjes së tij. Vendimi i arbitrazhit paraqet dokument përmbarues me vetë faktin se ka veti res iudicata. Arbitrazhet vetë vendosin klauzulën e plotfuqishmërisë në vendimin e vet, e cila me këtë bëhet dokument përmbarues.

### **8. Mjetet juridike kundër vendimit të arbitrazhit**

Mjet juridik kundër vendimeve të arbitrazhit është padia për anulimin (nulitetin) e vendimit. Padia i dorëzohet gjykatës kompetente në afat prej tre muajve nga dita e dërgimit të vendimit të arbitrazhit palës. Nëse palët shprehimisht e parashohin në marrëveshjen për arbitrazhin, vendimi i arbitrazhit mund të goditet me padi edhe nëse pala e cila e godet, pa fajin e vet, më vonë ka marrë në dijeni faktet e reja ose gjen mundësi ti përdor provat e reja në bazë të të cilave do të mund të sillej vendim i volitshëm për të sikur të njejtat të ishin shfrytëzuar para përfundimit të shqyrtimit i cili i paraprinë sjelljes së vendimit i cili goditet. Palët nuk mundën paraprakisht të heqin dorë nga e drejta e goditjes së vendimit me padinë për anulim.

Shkaqet për anulimin e vendimit të arbitrazhit janë të përcaktuara taksativisht - numerus calausus dhe janë mjaft të ashpra. Kështu, gjykata mund të anuloj vendimin nëse:

- a) pala e cila paraqet padinë, dëshmon se:
  - marrëveshja për arbitrazhin nuk është lidhur ose se nuk është e vlefshme,
  - pala në procedurë nuk ka qenë e aftë të lidh marrëveshjen e vlefshme për arbitrazhin ose të jetë palë në kontest, ose nuk ka qenë e përfaqësuar si duhet,
  - pala e cila e ka paraqitur padinë për anulimin e vendimit nuk ka qenë rregullisht e informuar lidhur me inicimin e procedurës së arbitrazhit ose në mënyrë tjetër të paligjshme i është pamundësuar shqyrtimi para gjykatës së arbitrazhit,
  - vendimi ka të bëj me kontestin i cili nuk është i paraparë në marrëveshjen për arbitrazhin, ose i cili nuk është i përfshirë në dispozitat e tij, ose përmban vendime për lëndët të cilat tejkalojnë kufirin e marrëveshjes për arbitrazhin,

- përbërja e gjykatës së arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk kanë qenë në pajtim me Ligjin,
- nëse vendimi nuk është i arsyetuar ose nuk është i nënshkruar ashtu siç e kërkon Ligji,

b) gjykata gjen, edhe kur pala nuk është thirrur në atë shkak, se:

- lënda e kontestit nuk është arbitrabile sipas ligjeve të R. së Kosoves,
- vendimi është në kundërshtim me rendin publik të R. së Kosoves.<sup>130</sup>

Gjykata prej të cilës kërkohet anulimi i vendimit të arbitrazhit mundet, kur e sheh të arsyeshme ose kur këtë e kërkon njëra nga palët, të shtyjë procedurën për padinë për anulim për kohë të cilën e cakton vetë që ti jep mundësi gjykatës së arbitrazhit të vazhdojë procedurën ose të ndërmerr diç tjetër për të hequr shkaqet për anulimin e vendimit.

Kur gjykata vendos për padinë për anulimin e vendimit të arbitrazhit, atëherë ajo vepron sipas rregullave të procedurës kontestimore, ndërsa në të gjitha rastet e tjera ajo vepron sipas rregullave të procedurës jokontestimore.

Kur është kontraktuar arbitrazhi, ndërkaq palët paraqesin padinë në gjykatë, me propozim të të paditurit, gjykata do të shpallet si jokompetente, përveç nëse gjen se marrëveshja për arbitrazhin nuk është e vlefshme, që ka pushur të vlejë ose se nuk mund të përmbushet.

Në rast të anulimit të vendimit të arbitrazhit, kur gjykata së cilës i është paraqitur padia për anulim konsideron se është e mundshme dhe e duhur, me kërkesë të njëjës nga palët, do ta kthejë lëndën në gjykim të përsëritur në gjykatën e arbitrazhit.

Në qoftë se vendimi i arbitrazhit i sjellë në bazë të marrëveshjes së vlefshme për arbitrazhin në të cilin nuk janë përcaktuar emrat e arbitrave, anulohet për shkaqe të cilat nuk kanë të bëjnë me ekzistimin ose vlefshmërinë juridike të marrëveshjes për arbitrazhin, ajo marrëveshje është bazë juridike e vlefshme për arbitrazhën e re në lidhje me kontestin e njejtë. Në të gjitha rastet e tjera, arbitrazhi i ri për të njejtin kontest do të jetë i mundur nëse palët, pas anulimit të vendimit të arbitrazhit, lidhin marrëveshje të re për arbitrazhin.

Për vendosjen mbi kompetencën e gjykatës së arbitrazhit, vendosjen mbi padinë për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit dhe mbi kërkesën për njohjen dhe propozimit për përcaktimin e përmbarimit në lëndët nga kompetenca lëndore e gjykatave tregtare, është kompetente Gjykata Tregtare në Zagreb, ndërsa në leminjtë tjerë Gjykata e Apelit në Zagreb.

---

<sup>130</sup> Neni 36, paragraf. 2, ika 1 dhe 2 i LA.

Për zbatimin e përmbarimit kompetente është gjykata e kompetencës lëndore e përcaktuar me ligj të veçantë.

### **9. Njohja dhe përmbarimi i vendimit të arbitrazhit**

Vendimi i gjykatës së arbitrazhit ka përkatësinë e shtetit ku gjendet vendi i arbitrazhit. Gjykata e vendit përcakton përmbarimin e arbitrazhit të vendit, përveç rasteve kur ekzistojnë shkaqet për anulimin e vendimit. Gjykata, gjithashtu, do të njeh dhe përmbaroj edhe vendimin e huaj të arbitrazhit, përveç nëse me rastin e kundërshtimit të palës kundërshtare gjen se ekzistojnë shkaqet për anulimin e vendimit të përcaktuara me ligj<sup>131</sup> ose nëse gjykata e shtetit në të cilën është ose sipas ligjit të të cilit është sjellë vendimi është anuluar ose e ka shty paraqitjen e efektit të tij.

Gjykata refuzon të njoh dhe përmbaroj vendimin e huaj veçanërisht në rastet kur bëhet fjalë për kontestin i cili nuk është arbitrabil sipas ligjit të R. së Kosoves, ose kur njohja dhe përmbarimi do të ishin në kundërshtim me rendin publik të R. së Kosoves.

Dy janë kushtet formale për njohjen e vendimit të huaj të arbitrazhit: parashtrimi i vendimit të arbitrazhit dhe parashtrimi i marrëveshjes për arbitrazhin.

Krahas këtyre dy parakushteve formale, ekzistojnë dhe kushtet negative. Me përmbarjen komulative të tyre, plotësohen kushtet për njohjen e vendimit të arbitrazhit.

Përmbarimi i vendimit të arbitrazhit bëhet nga gjykata kompetente sipas rregullave të procedurës përmbaruese. Fuqia juridike e vendimeve të arbitrazhit është më e madhe nga fuqia juridike e vendimeve të gjykatave të rregullta për shkak të efektit të tyre të plotfuqishmërisë. Procedura e përmbarimit të vendimeve të arbitrazhit të vendit dhe i vendimeve të gjykatave të rregullta është e njëjtë.

Pala e cila kërkon njohjen ose përmbarimin e vendimit të arbitrazhit duhet që, krahas propozimit me shkrim, të dorëzoj vendimin në origjinal ose kopjen e tij të verifikuar. Nëse bëhet fjalë për vendimin e huaj, pala është e obliguar të dorëzoj origjinalin e marrëveshjes për arbitrazhin ose kopjen e verifikuar siç duhet të asaj marrëveshje.

Nëse bëhet fjalë për gjuhë të huaj, palët janë të obliguara të dorëzojnë përkthimet e verifikuara të atyre dokumenteve në gjuhën kroate.

Gjatë zhvillimit të procedurës për njohjen dhe përmbarimin e vendimit, gjykata është e obliguar ti mundësoj palës kundërshtare që të deklarohet lidhur me propozimet.

---

<sup>131</sup> Nenin 36, paragr.2 i LA.

Aktvendimet për njohje dhe përmbarim duhet të arsyetohen. Kundër aktvendimit të sjellë në procedurën për njohje si për çështjen kryesore, mund ti paraqitet ankesa Gjykatës Supreme në R. e Kosovës mbrenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dërgimit të aktvendimit për njohjen.

## **PËRPARËSITË DHE MANGËSITË E ZGJIDHJES SË KONTESTEVE TREGTARE NË MËNYRË JASHTËGJYQËSORE NË RAPORT ME MËNYRËN GJYQËSORE**

### **1. Përparësitë dhe mangësitë e ndërmjetësimit në raport me procedurën gjyqësore**

Përparësitë e ndërmjetësimit në raport me procedurën gjyqësore janë të shumta. Kështu, përderisa procedura gjyqësore është publike, procedura e ndërmjetësimit është e fshehtë,

përkatësisht e gjithë ajo që shpaloset gjatë zvillimit të procedurës së ndërmjetësimit mbetet konfidenciale dhe nuk mund të përdoret në procedurën gjyqësore ose jashtë saj.

Procedura gjyqësore është tejet formale, përderisa ndërmjetësimi është joformal dhe i përshtatet palëve me qëllim të arritjes së qëllimeve të tyre. Në procedurën gjyqësore, gjyqtari sjell vendimin për kontestin midis palëve, gjersa në procedurën e ndërmjetësimit janë pikërisht palët ata të cilat rregullojnë marrëdhëniet mes veti duke sjell vendimin sipas zgjidhjes që ata kanë pranuar lidhur me kontestin mes tyre.

Suksesi i palëve në procedurë gjyqësore është i pasigurtë, ndërkaq pajtimi gjatë ndërmjetësimit midis palëve përjashton rrezikun e vendimit të pavolitshëm gjyqësor.

Përderisa vendimi gjyqësor krijon humbës dhe fitues, e me këtë edhe palë të pakënaqur, në procedurën e ndërmjetësimit të dyja palët janë fituese pasi kanë arritur pajtim i cili i kënaq interesat e tyre të përbashkëta. Pajtimi të cilin palët e arrijnë në procedurën e ndërmjetësimit u mundëson palëve marrëdhënie të mira dhe njëkohësisht vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm.

Krahas përparësive të ndërmjetësimit në raport me procedurën gjyqësore, ekzistojnë edhe mangësitë. Kështu si mangësi përmenden rastet kur përpjekjet e mëparshme të ndërmjetësimit nuk kanë dhënë rezultate, kur palët kanë lejuar që kontesti të eskaloj tej mase, kur nuk ekziston vullneti i vërtetë i palëve për gjetjen e zgjidhjes jashtëgjyqësore, kur palët dëshirojnë të diktojnë vendim gjyqësor lidhur me çështjen e caktuar juridike ("presedan"), njëra nga palët dëshiron aktgjykim-vendim publik mbi kontestin e tyre (pabarazi e madhe lidhur me pozitën juridike), qëndrimi hakmarrës i njëres nga palët, veprime me keqbesim, etj.

## **2. Përparësitë dhe mangësitë e arbitrazhit në raport me procedurën gjyqësore**

Arbitrazhi si mënyrë e zgjidhjes së kontesteve ofron përparësi të shumta në raport me procedurën gjyqësore. Një ndër përparësitë kryesore, gjithsesi përmendet autonomia e vullnetit të palëve, e cila në procedurën e arbitrazhit është parim dominues. Kështu, palët në procedurën e arbitrazhit kanë mundësi të zgjedhin vetë që lidhur me kontestin e tyre të vendos personi (arbitri ose arbitrat) në të cilin, duke pasur parasysh profesionalitetin e tij, kanë besim që kontestin do ta zgjidh në mënyrën më të mirë të mundshme. Pra, bëhet fjalë



për persona profesional-ekspertë, të cilat kanë njohuri të thukta lidhur me çështjet kontestuese të cilat parashtrihen për zgjidhje.

Palët kanë të drejtë të vendosin lidhur me të drejtën që do zbatohet në procedurën e arbitrazhit, dhe atë si të drejtën materiale, ashtu edhe të drejtën procedurale. Aq më tepër, palët mund të vendosin që procedura e arbitrazhit të zhvillohet sipas rregullave të drejtshmërisë (parimi ex aequo et bono).

Në procedurën e arbitrazhit palët mund të vendosin lidhur me gjuhën e procedurës, vendin e arbitrazhit, etj.

Shpejtësia e zgjidhjes së kontestit në procedurën e arbitrazhit, në raport me gjykatat e stërngarkuara me lëndë të pazgjidhura, gjithsesi paraqet shkakun se pse dita ditës rritet numri i subjekteve të cilët zgjidhjen e kontesteve të tyre ua besojnë institucioneve joshtetërore, veçanërisht, arbitrazhit. Ngusht lidhur me shpejtësinë e procedimit janë dhe shpenzimet e procedurës. Në procedurën gjyqësore nuk janë të rralla rastet kur zgjidhja e kontesteve zgjatë me dekada, gjë që rrit shpenzimet e procedurës deri në çmime jashtëzakonisht të larta. Në procedurën e arbitrazhit, shpejtësia e procedimit dhe përfundimit të procedurës gjithsesi kontribuon me shpenzime më të vogla.

Jopubliciteti i arbitrazhit gjithsesi paraqet përparësi në raport me procedurën gjyqësore. Kështu, përderisa procedura gjyqësore është publike, procedura e arbitrazhit, nëse palët nuk merren vesh ndryshe, është e fshehtë.

Procedura e arbitrazhit është më pak formale në krahasim me procedurën gjyqësore.

Njëshkallshmëria e procedurës së arbitrazhit i shkon në disfavor procedurës gjyqësore. Pra, në procedurën e arbitrazhit lidhur me meritumin e kontestit vendoset (sipas rregullit) në një shkallë, ndërkaq vendimi i arbitrazhit midis palëve ka fuqinë e aktgjyqimit të plotfuqishëm gjyqësor. Përrjashtimisht, në qoftë se parashihet mundësia e goditjes së vendimit të arbitrazhit, ajo mund të kryhet vetëm në bazë të padisë për anulim dhe vetëm për shkaqe rreptësisht të parapara me ligj.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që përmendëm, palët me kontraktimin e arbitrazhit kanë mundësi që kontestin e tyre ta zgjidhin në mënyrë të plotfuqishme shpejtë, me efikasitet dhe konfidencialitet.

Nga ana tjetër, arbitrazhi ka dhe anët negative. Kështu si mangësi të zgjidhjes së kontesteve nga arbitrazhit përmenden: mundësia e animit të arbitrave, autorizimet e kufizuara të arbitrave, imponimi i vullnetit të palës ekonomikisht më të fortë në marrëdhënien afariste, njëshkallshmëria e procedurës së arbitrazhit, mundësitë e kufizuara të goditjes së vendimit të arbitrazhit si dhe problemet të cilat mund të lindin në lidhje me njohjen dhe përmbarimin e

vendimeve të arbitrazhit para gjykatave të rregullta shtetërore.<sup>132</sup> Si mangësi të arbitrazhit potencohen edhe vështirësitë e palëve rreth zgjidhjes së arbitrave, ngadalshmëria e procedimit si pasojë e mosnjohjes së mjaftueshme të së drejtës nga arbitrat, rreziku që gjykimi në bazë të drejtshmërisë të shndërrohet në arbitralitet dhe së fundi, vendimi i arbitrazhit i nënshtrohet kontrollit të gjykatës me kërkesën e njëjës nga palët e cila është e pakënaqur me përmbajtjen e vendimit.<sup>133</sup>

---

<sup>132</sup> Këto mangësi të zgjidhjes së kontesteve para gjykatës së arbitrazhit janë karakteristike, në rradhë të parë, për arbitrazhet institucionale ndërkombëtare, ku vlera e kontestit është jashtëzakonisht e madhe dhe me natyrë investive (siç është për shembull Arbitrazhi për zgjidhjen e kontesteve investuese ndërkombëtare me seli në Uashington).

<sup>133</sup> Shimac, S. "Mirenje-Alternativni način rjeshavanja sporova", Zagreb, *Informator* nr. 5404, 2005, f.7.